



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

Raport vjetor i Akademisë së Shkencave

Tiranë, 2024

Mbi veprimtarinë e Akademisë së Shkencave gjatë periudhës 2019-2023 dhe programi kryesor për vitin 2024

I. Rezultatet e fazës së parë të reformës (2019-2023)

Viti 2023 përbën vitin përmbyllës të katërvjeçarit 2019-2023, periudhë të cilën kjo Asamble e kishte përcaktuar si periudhën e realizimit të fazës së parë të reformës, të asaj të vetëreformimit të ASHSH, për të kaluar në fazën e dytë të saj: të reformimit në vazhdimësi të vetë sistemit të kërkimit shkencor tek ne.

Për këtë arsye detyra e synimi kryesor që kjo Asamble i vinte vetes e Kryesisë së ASHSH katër vjet më parë ishte kthimi i saj në institucionin më të lartë të kërkimit, promovimit e koordinimit të vetë sistemit të kërkimit, nëpërmjet rifreskimit të vetë Asamblesë, ngritjes së strukturave të reja ligjore e më tej të vendosjes pranë saj të qendrave e njësive kryesore me ndikim kombëtar, me qëllim vendosjen e balancave të duhura midis arsimit të lartë e shkencës dhe arritjen e standardeve të rajonit në kërkimin shkencor, për të synuar më tej standardet europiane.

Sot mund të pohojmë se kjo fazë u përmbyll e synimet tonat gjatë saj u realizuan.

Katër vjet më parë kërkuam nga Kuvendi miratimin e Ligjit të ri 53/2019, me bindjen se ai do të përbënte bazën e duhur ligjore të reformës së ndërmarrë.

Hartimi i projektligjit nga Asambleja e miratimi i tij nga Kuvendi; mbështetja dhe vlerësimi që ai mori nga institucioni më prestigjioz akademik europian ALLEA - bashkimi i akademive europiane; zgjedhja pa ekuivok e tij nga institucionet e komuniteti shkencor në raport me alternativat që tentonin rithemelim të Akademisë, duke shkelur hapur autonominë e liritë akademike të Asamblesë e të anëtarëve të saj, krijuan bindjen se Akademia i kishte vullnetin e aftësinë për vetëreformim pa ndërhyrje të njëanshme politike; se kjo Asamble nuk qe pjesë e problemit, por e zgjidhjes së tij.

Këtë vullnet kjo Asamble e dëshmoi më tej me hartimin e miratimin e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit të ri, siç janë:

- Statuti i Akademisë së Shkencave;
- Rregullore e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave;
- Rregullore për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të periodikëve shkencorë të Akademisë së Shkencave;
- Rregullore për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkursit të tyre;
- Rregullore Për mënyrën e funksionimit të marrëdhënieve me publikun dhe personat e ngarkuar me to;
- Rregullore e brendshme administrative të Akademisë së Shkencave;
- Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë;
- Statuti i Akademisë së të Rinjve;
- Kontratë-tip për të drejtat e autorit.

Efekti i parë i rëndësishëm i reformës është ndryshimi i imazhit negativ të krijuar padrejtësisht ndaj Akademisë si institucion, nëpërmjet përbaltjes sistematike, që prekte e prek edhe mjediset e tjera arsimore-shkencore.

Në bazë të Ligjit 53/2019 dhe të Statutit të ri:

- U rifreskua përbërja e Asamblesë së Akademisë dhe iu rikthye legjitimiteti i munguar asaj. Kjo u realizua nëpërmjet 18 pranimeve të reja, nga të gjitha fushat, prej të cilave 4 janë gra (nga tre gjithsej që kishte Asambleja që nga fillimi); nëpërmjet vendosjes së statusit të anëtarit emeritus për akademikët mbi 75 vjeç, çka i riktheu të drejtën e mohuar të votës pjesës më të nderuar të Asamblesë dhe vendosi një harmoni midis gjeneratave në Asamble. Kështu, sot Asambleja ka 54 anëtarë, të gjithë me të drejtë vote (sipas neneve 6, 7 dhe 15 të Ligjit 53/2019);

- Përcaktimi në ligj i statusit të anëtarit të jashtëm për shqiptarët e suksesshëm në fushën e dijes dhe shkencës me veprimtari e banim jashtë vendit mundësoi pranimin e 10 anëtarëve të rinj nga diaspora shkencore dhe të 8 anëtarëve nga anëtarësia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës e nga bota akademike arbëreshe.

Krahas tyre janë zgjedhur 8 anëtarë nderi të rinj, kryesisht albanologë të huaj nga më të njohurit; si dhe përfaqësues të akademive simotra me ndikim pozitiv për Shqipërinë, si kryetari i Akademisë Gjermane të Shkencave Leopoldina dhe Presidenti i ALLEA-s (nenet 6, 7 të Ligjit).

- U formuan e funksionojnë 9 komisione të përhershme shkencore sipas fushave a grupfushave kryesore të dijes, me 133 anëtarë, nga të cilët 54 akademikë dhe 80 anëtarë nga profesori i IAL-ve, çka shenjon një hapje të gjerë të Akademisë ndaj botës shkencore në tërësi (neni 18 i Ligjit);

- U krijuan e kanë ushtuar a ushtrojnë aktivitetin e tyre 10 njësi të kërkim-studimit e dy institute virtuale. Njësitë fillimisht u ngritën në bazë të problemeve e çështjeve akute, siç është rasti i njësisë për futjen e eurokodeve për ndërtimet rezistente ndaj tërmeteve dhe i njësisë së biogjenetikës për studimin e imunitetit të fituar ndaj virusit pandemik Covid-19; më tej për çështje të perspektivës, që lidhen me koordinimin e kërkimit shkencor dhe studimin, për të mundësuar e propozuar ngritjen e mundshme të instituteve a qendrave të reja kërkimore, siç janë qendra Nano-Alb dhe ajo e bio-gjenetikës (nenet 4/6, 19);

- U ideuan dhe u mbështetën 31 projekte shkencore e studime. Krahas tre projekteve madhore në albanologji ato u shtrinë në fusha të ndryshme, kryesisht në atë të nanoshkencës dhe bioteknologjisë, në arkeologji, për studime në botën arbëreshe, në energjetikë, duke shërbyer si mjet nxitës për krijimin e fuqizimin e grupeve kërkimore, me synim aplikimin në projekte madhore ndërkombëtare. Deri me tani janë realizuar 14 projekte e janë në proces 17 projekte të mbështetura nga ASHSH ose nga AKKSHI (nenet 4/2, 4/4, 4/5, 4/6 të Ligjit);

- Hapësirat e reja që krijonte ligji i ri mundësuan e konsoliduan rolin e Akademisë si qendra kryesore e organizimit të eventeve madhore shkencore, si kuvende, kongrese, konferenca, simpoziume; dhe si një nga entet e pakta e kryesore të botimit të librit shkencor. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar rreth 100 aktivitete të tilla në vit, me pjesëmarrjen e mijëra kërkuesve e studiusve, ku kanë referuar qindra profesorë e specialistë të vendit e të huaj. Ndër to vlejné të veçohen kuvendi ndërkombëtar i studimeve albanologjike, tri konferenca ndërkombëtare për nanoshkencën; shumë veprimtari të ngjashme në bioshkencë, për pandeminë e tërmetet, për probleme të bujqësisë, tokës e ujërave, si dhe konferenca për 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (nenet 4, 9, 10 të Ligjit);

- Pa dyshim ndërmarrja shkencore strategjike më e rëndësishme dhe më me përgjegjësi ishte ideimi dhe fillimi i punës zbatuese për tre projektet madhore në albanologji (nenet 4/16, 4/17 të Ligjit), për ecurinë e të cilëve ka një raportim të veçantë;

- Janë zgjeruar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me akademitë simotra në ALLEA, kryesisht me ato të rajonit e posaçërisht me vetë ALLEA-n dhe me Akademinë Gjermane të

Shkencave Leopoldina, çka kulmoi me bashkorganizimin në Tiranë të samitit të shtatë të akademive të rajonit të Ballkanit e më gjerë, në kuadër të nismës europiane të Procesit të Berlinit, organizuar në tetor 2023, në prag të Samitit ndërqeveritar të të njëjtit proces, rekomandimet e të cilit u adaptuan edhe nga samiti i qeverive;

- Aktet e reja kanë zgjeruar llojin e çmimeve që jepen nga ASHSH për promovimin dhe nxitjen e kërkimit shkencor, siç janë: çmimi ndërkombëtar për albanologët e huaj i dhënë për herë të parë me rastin e kuvendit të studimeve albanologjike dhe çmimi Aleks Buda për kërkuesit e rinj;

- Tashmë ka rregulla e kritere shumë më të qarta për botimet e ASHSH dhe periodikët e saj, duke mbajtur të njëjtin numër titujsh, por duke përmirësuar cilësinë e rankimin dhe duke ulur shpenzimet. ASHSH ka botuar rreth 30 tituj në vit, çka bën që gjatë kësaj periudhe të jenë botuar rreth 160 tituj, përfshirë dhe dy periodikët, përveç botimeve individuale të akademikëve dhe njërive tona në revistat e tjera jashtë vendit. Ndërkohë, revista për studime albanologjike është avancuar në *Listën A* të botimeve ndërkombëtare akademike dhe universitare;

- Së fundi e më e rëndësishmja: Ligji i ri 53/2019 dhe vetë reforma, faza e dytë e saj, bënë të mundshëm riorganizimin e instituteve të albanologjisë e vazhdimin e veprimtarisë së tyre pranë Akademisë së Shkencave, çka përbën angazhimin e sfidën tonë kryesor në vitin në vijim.

Përmbledhtas, në përmbyllje të kësaj faze, Asambleja e ASHSH ka sot 54 anëtarë, të gjithë me të drejtë vote; 18 anëtarë të jashtëm; 16 anëtarë nderi; 9 komisione të përhershëm me 133 anëtarë, nga të cilët 80 janë joanëtarë të Asamblesë; mbi 160 anëtarë e bashkëpunëtorë njësisht; mbi 200 bashkëpunëtorë aktivë në projektet shkencore e ato albanologjike e së fundi Akademisë iu bashkuan natyrshëm pesë institute e qendra të përhershme me rreth 100 punonjës kërkimorë-shkencorë e ndihmës-tekniko-shkencorë, ndërkohë që 4 vjet më parë kishte vetëm një Asamble me 43 anëtarë, nga të cilët 17 pa të drejtë vote.

II. Respektimi e zbatimi i Ligjit dhe i Statutit nga organet drejtuese e strukturat e ASHSH

Organet drejtuese dhe strukturat e ASHSH, në vazhdimësi, në gjithë veprimtarinë e tyre, kanë vepruar konform Ligjit nr. 53/2019 dhe Statutit, i cili përmban procedura më të detajuara për zbatimin e normës ligjore, si dhe kritere specifike për zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Asambleja, si organi më i lartë, është mbledhur rregullisht 3-4 herë në vit, nga dy herë që është detyrimi statutuor. Mbledhjet më të rëndësishme të saj janë ato të raportimit vjetor, ku është miratur veprimtaria e ASHSH për vitin përmbyllës dhe programi bazë e projektbuxheti për vitin në vijim, mbledhje të cilat janë zhvilluar të hapura ndaj institucioneve bashkëpunuese e politikëbërëse, ashtu siç e parashikon ligji; si dhe ato për zgjedhjen e anëtarëve të rinj e të drejtuesve të rinj të Akademisë.

Zgjedhja e anëtarëve të rinj parasheh një proces gjashtëmujor procedural, në të cilin marrin pjesë edhe senatet akademike dhe departamentet e institucioneve të arsimit të lartë ku ushtrojnë a kanë ushtruar veprimtarinë e tyre kandidatët konkurrues. Procedurat e kriteret ligjore e statutuore janë zbatuar rigorozisht. Pranimet e reja janë mirëpritur e vlerësuar nga institucionet ku ushtronin aktivitetin e tyre anëtarët e rinj.

Asambleja e seksionet kanë dhënë pëlqimin e tyre për çdo njësi të kërkim-studimit të ngritur pranë ASHSH, si dhe kanë miratuar marrëveshjen-kuadër që lidh ajo me institucionet e huaja

homologe. Çdo ndryshim statutor e propozim për ndryshime në ligj është bërë me vendim / gjegjësisht pëlqim të Asamblesë.

Seksionet e komisionet si struktura pranë dhe ndihmëse të tyre kanë kryer funksionet e fuqitë e veta si iniciuese e propozuese në hartimin e programit vjetor e më tej si zbatuese kryesore të tij, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Kryesia ka kryer detyrat e saj dhe ushtruar fuqitë e përcaktuara nga neni 12 i Ligjit nr. 53/2019, nëpërmjet përgatitjes së projekt-akteve kryesore, të programit dhe buxhetit vjetor; ashtu dhe për zbatimin e tyre; nëpërmjet hartimit të rregulloreve të brendshme të përmendura më lart dhe vendimeve të saj, mujore e javore. Veçanërisht ajo ka nxjerrë vendimet e nevojshme për mënyrën e trajtimit të njësive, për procedurat e miratimit, financimit e zbatimit të projekteve.

III. Buxheti ndër vite

Buxheti ASHSH në këtë periudhë ka qenë gjegjësisht, vit pas viti: 104, 126, 148, 189 milion lekë. Shpërndarja e tij sipas zërave kryesorë është sipas tabelës bashkëngjitur. Shihet qartë se ka pasur një rritje modeste të buxhetit në vite. Theksojmë se kjo rritje nuk vjen aspak nga ngritja e mbarëvajtja e komisioneve, njësive të përkohshme apo instituteve virtuale të matematikës e fizikës, pasi për komisionet shpenzohen vetëm 3 milion në vit (paguhen modestisht për kontributin e tyre vetëm anëtarët joakademikë - në masën 5.5 mijë lekë për mbledhje, ndërsa për njësitë, drejtuesit e anëtarët, akademikë ose jo, janë pa pagesë, përveç një koordinatori, që përfiton një honorar prej 20-30 mijë lekë në muaj).

Shtesa ndër vite ka ardhur kryesisht për të mbuluar projektet shkencore të propozuara, mbështetur a drejtuar prej njësive e komisioneve, nën drejtimin e seksioneve e strukturave administrative përkatëse si qendra për koordinimin e kërkimit shkencor dhe QBAE (QBEA), ku peshën kryesore e zënë projektet e albanologjisë: *Historia e shqiptarëve*, *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* dhe *Enciklopedia shqiptare*; si dhe pjesërisht nga shtimi i aktiviteteve, në dimension e numër, si kuvende, kongrese, konferenca etj. Konkretisht, për vitin 2023 për projektet u parashikuan 76 milionë lekë, nga të cilat 52 milionë për albanologjinë e 24 milionë për nanoshkencë e bioshkencë, arkeologji, studime për arbëreshët, pasuritë ujore, bujqësinë etj.; 18 milionë për veprimtaritë shkencore, 10 milionë për botimet e 10 milionë për shpenzime të tjera (ndërsa 10 milionë lekë nuk u shpenzuan).

IV. Faza e dytë e reformës (2023-2027)

Programi për vitin 2024

Realizimi sipas Ligjit nr. 53/2019 dhe Statutit i fazës së parë të reformës krijoi kushtet për kalimin në fazën e dytë në 4 vitet e ardhshme, që është faza e riorganizimit të sistemit tonë shkencor, bazuar kjo në strategjinë kombëtare për shkencën (2023-2030) dhe ligjit të ri për shkencën, që pritet të miratohet; si një masë e domosdoshme për ngritjen në një nivel më të lartë të realizimit të misionit e përgjegjësisë së ASHSH, përcaktuar nga Ligji 53/2019, posaçërisht në nenet 1 e 4, me synimin:

1. Rritjen e mbështetjes e të financimit të kërkimit shkencor në Shqipëri, parë kjo në lidhje e bashkëpunim me atë në Kosovë, me objektiv të qartë atë të përcaktuar në konkluzionet e samitit të shtatë të akademive dhe IAL-ve publike të Ballkanit zhvilluar vjet

në Tiranë në kuadër të *Procesit të Berlinit*, që financimi për kërkimin shkencor të ngrihet në nivelin e 1 për qind të GDP-së, me synim kalimin gradual në 2 për qind.

2. Kthimin e ASHSH dhe të instituteve të reja pranë saj në qendrën kryesore të kërkimit e studimit në shkencat albanologjike (pika 4/17). Ardhja e instituteve të albanologjisë pranë ASHSH nuk është rritje e kompetencës së saj për të kontrolluar apo ushtruar influencë ndaj kërkimit shkencor në albanologji: këtë mision e detyrë ajo e ka në të gjitha pikat e nenit 4 të Ligjit dhe për të gjitha fushat e shkencës. Por ky bashkim rrit mundësitë për ta kryer më me efikasitet e përgjegjshmëri, së bashku, rolin e misionin; që i ngarkon ligji në nenin 4 të tij: *të ndërtojë strategji e të zbatojë politika të suksesshme për zhvillimin e shkencave albanologjike e për promovimin e arritjeve të tyre brenda e jashtë vendit; të bashkëpunojë me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi si IAL dhe institutet, më qëllim koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e specialistëve të rinj.*

3. Zgjerimin e rrjetit të instituteve e qendrave kërkimore afatgjata pranë ASHSH në fushat kryesore të shkencave shoqërore e natyrore-teknike, posaçërisht me *ngritjen e qendrës së bio-gjenetikës dhe të qendrës rajonale Nano-Ballkan*, për t'i dhënë Akademisë rolin e pararendësit dhe koordinuesit të kërkimit në fushat më me ndikim në zhvillimin e zbatimit e kërkimit shkencor (4/4, 4/5, 4/6);

4. Realizimin me sukses të tre projekteve madhore në albanologji: hartimi i *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*, i *Historisë së shqiptarëve* (variant i sintetizuar) dhe i *Enciklopedisë së shqiptarëve*, duke përfshirë krijimin e korpusit të gjuhës shqipe (pika 4/16);

5. 13. Kthimin e QBEA në një *qendër të përhershme mbështetëse për drejtimin e punës për botimet themelore*, për mirëmbajtjen në vazhdimësi të bazave të të dhënave, për pasurimin e përditësimit e veprave madhore, si fjalorët e shqipes, *thesaurus-in* e saj (duke përfshirë krijimin e urave të komunikimit të korpuseve të leksikut të saj në Shqipëri e në disa vende të Botës), për botimet enciklopedike, për të garantuar hartimin në kohë e përditësimin e vijueshëm të tyre (4/16, 4/17);

6. Konsolidimin e praktikës së ngritjes së njësive afatshkurtra të kërkim-studimit për trajtimin e problemeve madhore akute për çështje të veçanta, për ideimin e drejtimin e projekteve me interes shkencor e konceptimin e ngritjes së qendrave të reja të kërkimit (4/5, 4/6, 4/7);

7. Konsolidimin e veprimtarisë së instituteve virtuale në nivel kombëtar si IKF e IKM (4/2, 4/6); me qëllim nxitjen e veprimtarisë shkencore në këto fusha, ngritjen e nivelit shkencor të vetë pedagogëve e specialistëve të rinj;

8. Rritjen e rolit të ASHSH në *vlerësimin e nivelit dhe të cilësisë së transmetimit të shkencës në shkollimin universitar e parauniversitar*, si dhe në hartimin e strategjive për zhvillimin e shkencës dhe arsimit në tërësi veçanërisht në disiplinat bazë matematikë-fizikë e gjuhë-letërsi (4/4);

9. Rritjen aplikimeve e të shkallës së suksesit për projekte shkencore pranë institucioneve vendëse e ndërkombëtare (4/10);

10. Ngritjen e cilësisë së botimeve në tërësi e të nivelit të rankimit të periodikëve (4/2, 4/8);

11. Konsolidimin e rolit tashmë të fituar të ASHSH në qendrën kryesore të organizimit të veprimtarive më me peshë e ndikim: shkencore, historike e celebruese që lidhen me to (4/11);

12. Zgjerimin e konsolidimin e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë *nëpërmjet veprimtarive e projekteve të përbashkëta, pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tyre në komisionet e njësitë tona* (4/9);

13. Forcimin e bashkëpunimit me *Akademinë e të Rinjve*, nëpërmjet riorganizimit të saj sipas Ligjit nr. 53/2019 (4/5); duke u mbështetur në *Kartën themelore* të miratuar nga ALLEA, tashmë të përshtatur si statut të saj, si dhe duke vijuar me konkursin e hapur për ringritjen e saj në një bazë të re, me standarde të njësuara europiane;

14. Kthimin real të ASHSH në qendër të informimit për kërkimin shkencor, nëpërmjet riorganizimit të shërbimit bibliotekar dhe të programeve COBISS dhe ECRIS (4/2, 4/5, 4/7, 4/13), duke përfshirë ngritjen e qendrës kombëtare të katalogimit dhe informacionit shkencor;

15. Zgjerimin e ambienteve të punës për Asamblenë, institutet e qendrat e reja pranë ASHSH, të aseteve e saj, përfshirë ngritjen e një muzeu të ri arkeologjik.

Për sa synohet të realizojmë, për vitin 2024 kësaj Asambleje i është paraqitur *programi i veprimtarive kryesore*, ku propozohen rreth 97 të tilla; *programi i botimeve*, ku propozohen 60 tituj e 17 periodikë; *programi i projekteve*; si dhe programet e veçanta të instituteve të arkeologjisë, historisë, gjuhësisë e studimeve letrare, antropologjisë, qendrës së studimit për artet e të QBEA-së, si dhe zërat kryesorë të buxhetit.

Sigurisht, në veprimtarinë tonë gjatë 2024 duhet të konsolidojmë më tej, të përmirësojmë a të korrigjojmë atje ku duhet si arritjet ashtu dhe praktikatat mangësitë e derimëtanishme. Pa dyshim, puna në ekip është e domosdoshme, aq më tepër për një institucion me drejtim kolegjal si yni, të cilit për këtë qëllim i shtohet dhe bordi i drejtorëve.

Për këtë do të forcohet më tej roli i komisioneve e funksionimi i tyre, duke ripërtërirë përbërjen e tyre në bazë të shkallës së aktivizimit të anëtarëve, duke parë një përfaqësim sa më të mirë nga institucionet e tjera, sidomos duke pasur programe më të qarta pune në nivel komisioni e duke respektuar karakterin e tyre kolegjal. Kjo bëhet më e nevojshme në kushtet e reja, pasi komisionet janë strukturat që mundësojnë drejtpërdrejt bashkëpunimin midis anëtarëve të Asamblesë e të seksioneve me ata njësisë të përhershme, si dhe midis njësive e shkollave të larta, bashkëpunim i cili është i domosdoshëm për organizimin e programeve të ciklit të dytë e të tretë.

Pranimet e reja, cilësia e tyre, është një ndër vendimet më të rëndësishme të Asamblesë, që ndikon si në imazhin e veprimtarinë e Akademisë, ashtu dhe në plotësimin e angazhimeve të saj në këtë mandat. Tërë angazhimi ynë do të jetë që të konsolidohen procedurat statutores e ligjore, të respektohen kriteret e të përditësohen ato kur shihet e nevojshme, me qëllim që i vetmi subjektivizëm në përcaktimin e fushave të reja dhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj të jetë ai që shprehet me votë, pa ndikime e preferenca politike.

Në vazhdimësi lipset të vendosen kriteret më të qarta se ç'nivel e ç'lloj projektesh duhet të mbështesë drejtpërdrejt ASHSH, në ç'masë do të jetë kjo mbështetje dhe se si duhet të kontrollohet efikasiteti i tyre.

Synimi ynë do të jetë që ASHSH të financojë vetëm projekte që lidhen me objektin e punës së çdo njësie a komisioni për studime të mirëfillta shkencore që ndërmerren për herë të parë apo që kërkojnë një koordinim midis disa njësive ose që janë projekte pararendëse të një studimi madhor në të ardhmen.

Sfidë e vëmendje të veçantë përbën *nxitja e mbështetja për një politikë më të mirë shkencore në hartimin e programeve të njësive të përhershme*. Gjatë këtij viti do të punohet për përmirësimin e pjesës statutores përkatëse; plotësimin me rregulloret për rekrutimin, vlerësimin e promovimin e kërkuesit shkencor, për vlerësimin e produktit shkencor e për botimin e tyre. Do të punohet për riorganizimin e ristrukturimin e brendshëm të njësive për një mbulim të duhur të periudhave e tematikave kryesore, për kualifikimin e vijuesve dhe plotësimin e vakuumeve, për evitimin e copëzimit të veprimtarisë në mikroprojekte të paharmonizuara, për dhënie e përparësi të projekteve madhore e për një aktivizim të kërkuesve në përputhje me meritën e aftësitë.

Raport përmbledhës për veprimtarinë vjetore të Akademisë së Shkencave

Mbështetur në raportet e analizës vjetore të seksioneve

I. Për veprimtarinë e SSHSHA

Disa të dhëna përmbledhëse:

I. Projekte madhore në albanologji që zbatohen nga SSHSHA dhe bashkëpunëtorët e tij:

- *Histori e shqiptarëve* (vit përmbyllës);
- *Fjalor i madh i gjuhës shqipe* (vit përmbyllës);
- *Enciklopedia shqiptare* (vit i stabilizimit të redaksive të të tre niveleve);
- Mbi 200 studiuës të përfshirë vetëm në nivel redaksie të tre projekteve së bashku.

II. Veprimtaritë shkencore kryesore të SSHSHA dhe komisioneve e njësive (mbi 90 gjatë vitit, pa tryezat dhe përrurimet):

- Konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri;
- *The Albanian language area and its surroundings during Antiquity to the High Middle Ages* (konferencë shkencore albanologjike ndërkombëtare, Nurenberg 21-22 prill 2023, organizuar nga dega e albanologjisë në LMU dhe ASHSH);
- *Probleme të reja të albanologjisë në kohën e sotme* (bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës, 25-26 maj 2023);
- *Jakov Xoxa shkrimtar dhe studiuës* (Tiranë - Apoloni 7-8 qershor 2023);
- *Nga "Shteti i Arbërit" tek Arbëria në shekujt e humanizmit europian* (Tiranë 9-10 tetor);
- *Letërsitë kombëtare në sistemin universitar* (14 nëntor 2023);
- *Samiti III i Diasporës - Dita arbëreshe* (konferencë shkencore ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, Pallati i Kongreseve, Tiranë 22-23 nëntor 2023);
- *Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë dhe në rajon* (komisioni i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike pranë ASHSH, në bashkëpunim me ASHAK-un, sipas protokollit të përbashkët (Prishtinë 6-7 tetor 2023);
- *Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës dhe të Shqipërisë në kuadër të integritimeve europiane* (ASHSH dhe ASHAK);
- *Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore* (pjesë e protokollit ASHSH-ASHAK, Prishtinë, më 26-27 tetor 2023).
- *Konferencë shkencore në 75-vjetorin e arkeologjisë shqiptare* (komisioni i historisë dhe arkeologjisë).

III. Disa të dhëna statistikore

- U organizuan 12 konferenca në nivel të ASHSH (9 ndërkombëtare dhe 3 kombëtare);

- U organizuan 9 konferenca në nivel të SSHSH (2 ndërkombëtare dhe 7 kombëtare);
- U bënë 14 promovime botimesh shkencore (pa ato të panairove të përvitshme në Tiranë, Prishtinë, Ulqin e Tuz);
- U organizua panairi i dytë i librit shkencor dhe akademik në Prishtinë (24-26 prill 2023);
- U mbajtën 4 ligjërata të hapura (Roberto Tottoli, A. Paci, Maria Todorova, B. Kabashi);
- U përgatitën procedurat dhe u bënë certifikimet dokumentuese për zgjedhjen si anëtarë të jashtëm të 3 studiuesve nga Kosova (M. Kraja, S. Hamiti, F. Krasniqi); për zgjedhjen si anëtar nderi të 2 studiuesve të huaj (G. Haug, J. Wang dhe Ke Jing), si dhe për dhënien e titullit *Nderi i Akademisë J. Xoxës* (pas vdekjes);
- U organizua dhe realizua me sukses konkursi për çmimet e veçanta “Shuteriqi”;
- Nga anëtarët e SSHSHA janë botuar 22 monografi e 65 artikuj shkencorë dhe janë paraqitur 107 kumtesa apo referime në konferenca të niveleve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare (pa raportimet vjetore vetjake).

IV. Konferenca të tjera të bashkorganizuara:

- *Veçori të luftës antifashiste në krahinën e Skraparit* (ASHSH - bashkia e Skraparit, 20 janar 2023);
- *Asdreni - në 150-vjetorin e lindjes* (ASHSH - Universiteti i Korçës Fan S. Noli, 26 janar 2023);
- Konferenca IV Muzeut të Bankës së Shqipërisë *Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar* (ASHSH, bashkorganizatore, 8 shkurt 2023);
- *Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit rezilient të territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare* (Universiteti Polis dhe ASHSH, 13-14 tetor 2023);
- *Shqipëria dhe Turqia, ngritja e një partneriteti strategjik - 100 vjet marrëdhënie diplomatike*;
- Konferencë shkencore ndëruniversitare *Arbëreshi shkodran Leonardo de Martino* (Nj.K-S.A.A.A, ASHSH, Universiteti i Shkodrës, 15.12.2023).
- *Stefanaq Pollo, akademiku, historiani, drejtuesi, njeriu* (ASHSH, 14 dhjetor 2023).

V. Disa nga tryezat shkencore, forumet, debatet:

- *Skënder Drini, individualitet i spikatur në letërsinë shqipe* (3 korrik 2023);
- *Nga rilevimi morfometrik tek projekti i restaurimit, me objekt specifik ndërtesën e Akademisë së Shkencave* (bashkëpunim me Universitetin e Firences dhe Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë", 30 qershor 2023);
- *Vehbi Bala në 100-vjetorin e lindjes, SSHSHA dhe komisioni i gjuhës dhe i letërsisë*.

VI. Disa nga përrurimet më të rëndësishme:

- *Ditari i tranzicionit*, me 8 vëllime, nga akademik Anastas Angjeli (12 prill 2023);

- *Fjalor serbisht-shqip me 80 mijë fjalë i Rexhep Zllatkut (6 qershor 2023), komisioni i gjuhës dhe i letërsisë;*
- *Fjalor i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe (15 nëntor 2023, komisioni i gjuhës dhe i letërsisë);*
- *Antologjia e kompozitorëve të rinj kosovarë; komisioni i përhershëm i artit dhe trashëgimisë kulturore.*

I. Kongrese, kuvende, konferenca shkencore

Nr.	Titulli i veprimtarisë	Organizues	Institucione partnere	Referues gjithsej	Institucione të tjera në bashkëpunim
1.	<i>Shqiptarët dhe hebrenjtë në Luftën e Dytë Botërore</i>	ASHSH	2	14	13
2.	<i>Areali i gjuhës shqipe dhe rrethinave të saj gjatë Antikitetit deri në Mesjetë të Lartë</i>	Dega e Albanologjisë në LMU, ASHSH	2	25	17
3.	<i>Probleme të reja të albanologjisë në kohën e sotme</i>	ASHSH, USH	2	39	14
4.	<i>Jakov Xoxa, shkrimtar dhe studiues</i>	ASHSH	14	23	12
5.	<i>Nga “Shteti i Árbërit” tek Arbëria në shekujt e humanizimit evropian</i>	ASHSH, bashkia e Mirditës, KPMK	2	34	17
6.	<i>Letërsitë kombëtare në sistemin universitar</i>	ASHSH, UK Fan S. Noli	2	38	27
7.	<i>Dita arbëreshe, Kongresi III i Diasporës</i>	KM, ASHSH	7	32	8
8.	<i>Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë e rajon</i>	ASHSH, ASHAK	2	14	6
9.	<i>Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës dhe të Shqipërisë në kuadër të integrimeve europiane</i>	ASHSH, ASHAK	2	14	5
10.	<i>Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore</i>	ASHAK, ASHSH	2	45	6
11.	<i>Arkeologjia shqiptare në 75-vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva</i>	ASHSH, ASHAK	4	34	6
12.	<i>Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar</i>	BSH, ASHSH	1	9	4
13.	<i>Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit rezilient të territorit: drejt</i>	ASHSH, Universiteti Polis	2	26	7

	<i>një qasjeje euro-mesdhetare</i>				
14.	<i>Shqipëria dhe Turqia, ngritja e një partneriteti strategjik</i>	ASHSH, AIIS	3	11	5

II. Veprimtari të tjera shkencore

Nr.	Titulli i veprimtarisë	Organizues	Institucione partnere	Referues gjithsej	Institucione të tjera në bashkëpunim
1.	<i>Veçori të luftës antifashiste në krahinën e Skraparit</i>	ASHSH, bashkia e Skraparit	2	8	
2	<i>Asdreni në 150-vjetorin e lindjes</i>	ASHSH, UK	2	24	1
3.	<i>Arbëreshi shkodran Leonardo de Martino</i>	USH, Nj.K-S.A.A.A., ASHSH	7	30	10
4.	<i>Stefanaq Pollo, akademiku, historiani, drejtuesi, njeriu</i>	ASHSH, SSHSHA	-	10	-
5.	<i>Skënder Drini, individualiteti i spikatur në letërsinë shqipe</i>	ASHSH, SHFI	2	11	
6.	<i>Nga rilevimi morfometrik te projekti i restaurimit; me objekt ndërtesën e ASHSH</i>	ASHSH	2	4	2
7.	<i>Vehbi Bala në 100-vjetorin e lindjes</i>	ASHSH		5	3
8.	<i>Selim Islami - një jetë për arkeologjinë</i>	Komisioni i historisë dhe arkeologjisë			
9.	<i>Pierre Cabanes - një humbje e pazëvendësueshme për albanologjinë</i>	Komisioni i historisë dhe arkeologjisë			
10.	<i>Turizmi 2030: sfida të turizmit për në edukim cilësor dhe digjitalizim</i>	Komisioni E-S-J			
11.	<i>Antologji e kompozitorëve kosovarë</i>	Art e trashëgimi			
12.	<i>Trajektore të ndërthuruna: leksion i hapur</i>	Art e trashëgimi			
13.	<i>Eno Koço, dirigjenti dhe muzikologu ynë</i>	Art e trashëgimi			
14.	<i>Kërkimet gjeofizike dhe fotogramike në Bylis: ekspedita e vitit 2022</i>	Komis. i historisë dhe arkeologjisë			
15.	<i>120-vjetori i Odhise</i>	Art e trashëgimi			

	<i>Paskalit</i>				
16.	<i>Digjitalizimi dhe elementet në industrinë 4.0 në tregun shqiptar</i>	Komisioni E-S-J			

III. Projekte

Nr.	Titulli i projektit	Ndërko- mbëtare	Me ASHAK- un	Me AKKSHI- n	ASHSH	Institucione të tjera bashkëpunuese	Numri i kërkuesve gjithsej
1.	<i>Historia e shqiptarëve</i>	+	+		+		28
2.	<i>FMGJSH</i>	+	+		+		28
3.	<i>Enciklopedia shqiptare</i>	+	+		+		119
4.	<i>Vlerësimi ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror i zonave ligatinore (rast studimor liqeni i Shkodrës)</i>	-	-	+	Drejtues projekti akad. A. Civici	UMSH, USH, UT	8
5.	<i>Kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeofizike në Bylis</i>		+		ArkeoBylis		7

Konferencat, simpoziumet, forumet, tryezat shkencore të SSHSHA:

I. Konferenca ndërkademike ndërkombëtare:

1. Konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri;
2. *The Albanian language area and its surroundings during Antiquity to the High Middle Ages;*
3. *Probleme të reja të albanologjisë në kohën e sotme;*
4. *Nga "Shteti i Arbërit" tek Arbëria në shekujt e humanizmit europian;*
5. *Letërsitë kombëtare në sistemin universitar;*
6. *Samiti III i Diasporës - Dita arbëreshe;*
7. *Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë dhe në rajon;*
8. *Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës dhe të Shqipërisë në kuadër të integriteteve europiane;*
9. *Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore;*
10. *Konferencë shkencore në 75-vjetorin e arkeologjisë shqiptare;*
11. *Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar;*
12. *Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit rezilient të territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare;*
13. *Shqipëria dhe Turqia, ngritja e një partneriteti strategjik - 100 vjet marrëdhënie diplomatike;*
14. *Arbëreshi shkodran Leonardo de Martino.*

II. Ligjërata të hapura / lectio magistralis:

1. Roberto Tottoli, *Il Corano, scrittura Santa dell'Islam, e l'Islam in Europa (Kur'an-i, Shkrimi i Shenjtë i Islamit dhe Islami në Europë;*
2. Maria Todorova, *Studimet ballkanike: historia, debatet dhe vendi i Shqipërisë;*
3. Maria Todorova, *Ballkani imagjinar 25 vjet më pas;*
4. Besim Kabashi, *Korpusi i etiketuar i shqipes;*
5. Adrian Paci, *Trajektore të ndërthurura;*
6. Shaban Sinani, *Letërsia shqipe si letërsi europiane;*
7. Shaban Sinani, *Romantizmi shqiptar si romantizëm gjuhësor: Voskopoja në shekullin XVIII;*
8. Adrian Civici, *Vlerësimi ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror i zonave ligatinore.*

III. Tryeza shkencore, forume:

1. *Veçori të luftës antifashiste në krahinën e Skraparit;*
2. *Asdreni - në 150-vjetorin e lindjes;*
3. *Stefanaq Pollo, akademiku, historiani, drejtuesi, njeriu;*
4. *Skënder Drini, individualitet i spikatur në letërsinë shqipe;*
5. *Nga rilevimi morfometrik tek projekti i restaurimit, me objekt specifik ndërtesën e Akademisë së Shkencave;*
6. *Vehbi Bala në 100-vjetorin e lindjes;*

7. *Pierre Cabanes - një humbje e pazëvendësueshme për albanologjinë (in memoriam);*
8. *Selim Islami – një jetë për arkeologjinë;*
9. *Vështrim mbi veprat e muzikës së dhomës së Felice Latuadës;*
10. *Turizmi 2030: sfida për një edukim cilësor dhe digjitalizim;*
11. *Odhise Paskali në 120-vjetorin e lindjes;*
12. *Kërkimet gjeofizike dhe fotogrametrike në Bylis.*
13. *Eno Koço - në 80-vjetorin e lindjes;*
14. *Veprimtari kushtuar Odhise Paskalit, anëtar i ASHSH;*

IV. Veprimtari përuruese:

1. *Përrurime në kuadër të Panairit të dytë të librit akademik dhe shkencor në Prishtinë;*
2. *Ditari i tranzicionit, në 8 vëllime (Akad. Anastas Angjeli);*
3. *Fjalor serbisht-shqip me 80 mijë fjalë (Rexhep Zllatku);*
4. *Përrurime të tre botimeve të ISHTMK;*
5. *Fjalor i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe;*
6. *Antologjia e kompozitorëve të rinj kosovarë;*
7. *Thesar kombëtar, nr. 12-13, botim i shoqatës së shkrimtarëve dhe studiuesve shqiptarë që jetojnë në diasporë (me qendër në Suedi);*
8. *Pikëtakime historike, kulturore dhe identitare (autor D. Koçi).*

V. Veprimtari të tjera:

1. *Kontribut për pranime të reja në Asamblenë e ASHSH;*
2. *Kontribut për përgatitjen e akteve vijuese ligjore e nënligjore për fazën e dytë të reformës në ASHSH dhe në rrjetin kombëtar të kërkimit shkencor;*
3. *Kontribut për përgatitjen e Samitit VII të akademive të vendeve anëtare të Procesit të Berlinit;*
4. *Kontribut për vlerësimin dhe promovimin si anëtarë nderi të ASHSH të disa personaliteteve shkencore europiane e amerikane (Gerald Haug, Joseph Wang, Ke Jing);*
5. *Kontribut për nderimin e Maria Torodovës me titullin *doctor honoris causa*;*
6. *Kontribut për dhënie të mirënjohjes Nderi i Akademisë disa personaliteteve shqiptare dhe të huaja (Jakov Xoxa, Konstantin Novoselov, Panajot Boga, Yaakov Yagoel);*
7. *Themelimi i çmimit të veçantë Shuteriqi, organizimi i konkursit dhe shpallja e fituesve;*
8. *Kontribut për pranime të reja si anëtarë të jashtëm të ASHSH nga radhët e ASHAK;*
9. *Kontribut për mundësimin e projekteve shkencore të njësisë për arbëreshët.*

II. Për veprimtarinë shkencore të SSHNT

I. Të dhëna themelore:

Konferenca me pjesëmarrje ndërkombëtare	22
Projekte të Akademisë	13
Projekte kombëtare nga AKKSHI	12
Projekte në bashkëpunim me ASHAK	4
Projekte ndërkombëtare / europiane / bilateral	8
Veprimtari shkencore të SSHNT-së (+ njësitë, komisionet)	41
Pjesëmarrje individuale në projekte	48
Pjesëmarrje individuale në konferenca jashtë vendit	77
Pjesëmarrje individuale në konferenca brenda vendit	61
Monografi dhe tekste universitare	11
Artikuj dhe tekste universitare jashtë vendit	67
Artikuj dhe tekste universitare brenda vendit	9
Artikuj dhe intervista shkencore në media	
Pjesëmarrje individuale të ndryshme	73
Akademikë në mësimdhënie - lëndë mësimore	21
Udhëheqje doktorate / master dhe pjesëmarrje në juri	20

II. Veprimtari botuese: monografi

Gjithsej	Jashtë vendit	Brenda vendit	Në gjuhë të huaj
11	4	7	4

II.2. Periodiku AJNTS

Numra të publikuar	Artikuj gjithsej	Autorë dhe bashkautorë
2023/1	14	31
2023/2	14	43
2023/3 (nr. special)	12	41
Gjithsej	40	115

III. Kongrese, konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare

Veprimtari gjithsej	Institucione pjesëmarrëse	Referues	Veprimtar i ndërko-mbëtare	Veprimtari kombëtare		
40	34	690	22	18		
IV. Veprimtari në bashkëpunim me ASHAK-un (sipas protokollit)						
Projekte shkencore ndërkademi me ASHAK-un				4		
Veprimtari shkencore në Prishtinë				3		
Veprimtari shkencore në Tiranë				14		
Kërkues pjesëmarrës				27		
V. Konferenca, simpoziume, seminare, forume shkencore të SSHNT me komisionet dhe njësitë						
Gjithsej	Konferenca ndërkombëtare	Konferenca kombëtare	Forume	Simpoziume	Seminare	Workshop
40	10	1	13	3	7	6
VI. Disa nga veprimtaritë më të rëndësishme të komisioneve të përhershme, instituteve virtuale dhe njërive						
Nr.	Komisioni/njësia	Veprimtaria				
1.	Komisioni i biologjisë dhe bioteknologjisë	Ruajtja e gjermoplazmës frutore autoktone shqiptare nëpërmjet teknologjisë së farave sintetike dhe konservimi i avancuar në temperatura ultra të ulëta (kriokonservimi -196°C): programi i bashkëpunimit midis MS dhe Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë, 2023-2025				
2.	Komisioni i biologjisë dhe bioteknologjisë	Përdorimi i metodave bioteknologjike in vitro dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjellës të kategorisë “bazë” të kultivarëve autoktonë, në funksion të zbatimit të skemave të miratuara të certifikimit, ASHSH dhe AKKSHI;				
3.	Njësia e bioteknologjisë	Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerëzore shqiptare sipas markerëve gjenetikë të ADN-së, ASHSH dhe AKKSHI				
4.	Njësia për energjitë e ripërtëritshme	Një platformë e përbashkët për energjinë elektrike në sistemin elektroenergjetik të Shqipërisë dhe Kosovës (PPEE-SESHK), ASHSH dhe ASHAK.				
5.	Njësia NanoAlb	Drejt krijimit të njësisë së biosensorëve pranë grupit të bioteknologjive molekulare NanoAlb: përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar (BiosensToxic), ASHSH.				

VII. Projektet kryesore:

Gjithsej	Ndërkombëtare	ASHAK	AKKSHI	ASHSH
37	8	4	12	13
Projekte ndërkombëtare				8
Projekte të programit european COST				4
Projekte bilaterale				4
Projekte me ASHAK				4
Projekte nga AKKSHI				12
Projekte të mbështetura me buxhetin e Akademisë				13

		Institucione pjesëmarrëse	34
		Referues	690
		Ndërkombëtare	22
		Kombëtare	19
		Gjithsej	41
Nr.	Veprimtari të organizuara nga SSHNT (komisionet, njësitë)		Institucione pjesëmarrëse
1.	Festivali i shkencës		Innovative Center, EDU ACT Albania
	I. Komisioni i biologjisë		
2.	Conference 2 nd water environmental protection & sustainable development - WEPSPD-2023 (Konferenca e dytë ndërkombëtare WEPSPD / Mbrojtja e mjedisit ujor dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij		Universiteti i Tiranës, Eurobiotech, Epicatch, Universiteti Negev (Israel), Universiteti i Janinës, UBT
3.	International conference of agriculture and life science (ICOALS4), 1-3 November, / Konferenca ndërkombëtare e bujqësisë dhe shkencave të jetës		UBT, Ministria e Bujqësisë, GIZ, RISI Albania, SDS, KIT, BOKU, Universiteti Qirjazi, Universiteti i Foggia-s, Universiteti i Tuscia-s
4.	Teknika bashkëkohore në kërkimin shkencor në gjenetikën humane, 25.5.2023		
5.	Roli i biosigurisë në parandalimin e sëmundjeve endemike dhe atyre emergjente me rëndësi për kafshët dhe shëndetin publik, qershor 2023		UBT, BETTER, COST CA 20103
6.	Karakterizimi dhe konservimi i resurseve gjenetike të ruminantëve të vegjël, situata dhe perspektiva, seminar, 30 maj 2023		UBT, AKKSHI

7.	<i>Gjendja aktuale dhe sfidat e integritit në BE për certifikimin e fidaneve të drufrutorëve autoktone në Shqipëri, workshop, 26 qershor 2023</i>	Universiteti i Tiranës, QTTB Vlorë, CNR-IBE, CIHEAM, UBT, Ministria e Bujqësisë, Këshilli i Agrobiznesit, CIHEAM, APICE PIANTE, AKKSHI
8.	<i>Characterization of freshwater species with the main focus on Salmo letnica as endemic species of Ohrid lake of great economic and scientific importance, workshop, 23 November 2023 Përvijimi morfo gjenetik i specieve të ujërave të ëmbla me fokus kryesor koranin “Salmo letnica” si një specie endemike e liqenit të Ohrit me vlera shkencore dhe ekonomik</i>	UBT, RASP, GEF
9.	Forum: Sustainable agriculture in Albania and Lithuania	
10.	Workshop: Menaxhimi i ujërave	
11.	Mbi sistemet e sigurisë ushqimore dhe të menaxhimit të cilësisë, 2.11.2023	UBT, Min Bujqësisë, RISI Albania
12.	Webinar: Testet laboratorike në diagnostikim e kontroll	UBT, Universiteti i Selanikut
II. Komisioni i inxhinierisë		
13.	Sfidat e Ballkanit Perëndimor: infrastruktura dhe zhvillimi në rajon	Epoka
14.	Kodet e projektimit të digave dhe siguria sizmike e tyre	FIN, KKDM
15.	Pompat e nxehtësisë: sfidat e ngrohjes së ndërtesave të banimit në zhvillimin e qendrueshëm	
16.	Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit rezilient të territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare	Universiteti Polis, CO-Plan, OMB
17.	Integrimi i Ballkanit Perëndimor në EU: sustainable regional development in the Western Balkans	
III. Komisioni i matematikë-informatikës		
18.	<i>The 2nd international conference on information technologies and educational engineering - ICITEE23.FTI.UPT / Konferenca e 2-të ndërkombëtare për teknologjitë e informacionit dhe inxhinierinë arsimore</i>	UPT

IV. Komisioni i Mjekësisë		
19.	Konferencë ndërkombëtare: Mbi zhvillimet në shëndetin mjedisor dhe profesional Occupational and environmental health advances	U. George Mason, B. Ramazinus
V. Njësia e inteligjencës artificiale		
20.	Forumi i parë i inteligjencës artificiale, 27 mars 2023	
VI. Njësia e energjive të ripërtëritshme		
21.	Edukimi inxhinierik për energjinë, tendencat dhe sfidat	OST, UPT, ERE, AREA, Universiteti i Prishtinës, OSHEE, Universiteti i Durrësit
22.	Workshop për energjitë e rinovueshme: Strategjia për përshtatjen e energjisë së rinovueshme në Shqipëri	

	VII. Njësia e gjeoshkencave	
23.	Forum për gjeotermikë në Elbasan: Kapacitetet gjeotermike dhe parametrat e sizmitetit të zonës së Elbasanit, evidentimi dhe qasja me politikat e energjisë së gjelbër sipas BE	AKKSHI
24.	Simpozium për Divjakën: Monitorimi gjeodezik i dinamikës së vijës bregdetare si faktor thelbësor në modelimin e këtij fenomeni, me impakt të rëndësishëm në aktivitetin shkencor dhe ekonomiko-shoqëror të vendit: zona e studimit - gjiri i Divjakës	
	VIII. Njësia NanoAlb	
25.	Kongresi NanoBalkan-2023	AKKSHI
26.	NanoAlb meeting: albanian women in nanotechnology	
27.	Shkolla “Nanobiosensorët” (projekti SUSNANO)	UT
28.	Workshop për cilësinë e mjaltit (& AKKSHI)	UT, UBT, NANOALB, AKKSHI, Min Bujqësisë, FKBSH
29.	Forumi për projektet (AKKSHI + projektet)	AKKSHI
30.	Forumi QUARTZ-1	
31.	Workshop vjetor NanoAlb (NanoAlb-2023 annual workshop)	
32.	Forumi QUARTZ-2	
	Instituti Kombëtar i Fizikës	
33.	Konferenca e dytë ndërkombëtare e fizikës	
34.	Forum: Fizika në arsimin parauniversitar	
35.	Përdorimet paqësore të energjisë bërthamore	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
36.	Fenomeni i fluoreshencës së molekulave me interes biologjik	
37.	The fragmentation of quarks	Universiteti i Triestes & INFN Trieste, Itali
38.	Space week seminar	Institut d’Astrophysique de Paris, Sorbonne Universite, The University of Sheffield, UK; në bashkëpunim me CosmoVerse
39.	Konkursi ndërkombëtar Younivers, Korçë	Rrjeti i Aleancave Franceze
40.	Java e shkencës	FSHN, UT
	Instituti Kombëtar i Matematikës	
41.	Konferenca e parë kombëtare e matematikës	

Raportimi vjetor i instituteve të albanologjisë për vitin 2023¹

1.	Instituti i Arkeologjisë	19
2.	Instituti i Historisë	23
3.	Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë	42
4.	Instituti i Antropologjisë	60

¹ Pa raportimet individuale.

I. Instituti i Arkeologjisë

Viti 2023 shënoi një vit të rëndësishëm për aktivitetin e Institutit të Arkeologjisë, pavarësisht situatës së paqartë nga ana administrative, e krijuar pas miratimit të VKM-së 338, dt. 31.05.2023: realizimi i projekteve kërkimore-shkencore në terren, me mbi 35 projekteve arkeologjike, pjesa më e madhe e të cilave realizohet në bashkëpunim me universitete dhe institucione homologe evropiane dhe amerikane, krahas projekteve kombëtare sidhe vijimi i punës në rreth 20 projekte studimore; aktiviteti botues në revista kombëtare e ndërkombëtare; pjesëmarrja e studiuesve tanë në konferenca shkencore veprimtari të shumta shkencore kombëtare e ndërkombëtare si platformat e duhura për rrahjen e mendimit shkencor, përkatësisht **52 pjesëmarrje** në konferenca prej të cilave **29** janë në veprimtari shkencore ndërkombëtare dhe **23** në ato kombëtare; organizimi i **2 workshop**-eve ndërkombëtarë; arkeologjia publike.

AKTIVITET BOTUES

Aktiviteti botues i stafit akademik të Institutit të Arkeologjisë konsiston me botimin e **57 artikujve** shkencorë, prej të cilëve **25** janë në revista shkencore jashtë vendit dhe **32** revista shkencore brenda vendit. Paralelisht kanë parë dritën e botimit 5 studime monografike (2 jashtë vendit dhe 3 brenda vendit) si dhe janë në proces botimi 10 studime të tjera monografike.

Njëkohësisht është botuar numri i radhës i revistës periodike *Iliria* (nr. XLVI, 2022) i cili përmbledh kontribute të ndryshme me tematika nga fushat e prehistorisë, antikitetit, antikitetit të vonë dhe mesjetës. Përmbajtja organizohet në dy rublika: *Artikuj studimorë* dhe *In memoriam*, kushtuar punës dhe veprës së kolegëve që u ndanë nga jeta gjatë vitit të shkuar. Artikujt studimorë trajtojnë çështje që prekin studime rreth kulteve në antikitet, kategori të caktuara të materialit arkeologjik nga antikiteti në mesjetë dhe struktura të ndryshme arkeologjike.

Gjithashtu, është në proces numri i radhës i revistës *Candavia* 10, i cili përmbledh raportet e gërmimeve arkeologjike të kryera gjatë vitit 2022, në kuadër të projekteve që realizon Instituti i Arkeologjisë, vetëm a në bashkëpunim.

BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Ndër bashkëpunimet ndërkombëtare veçohen bashkëpunimet strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar siç janë bashkëpunimet me Shkollat franceze të Athinës e të Romës, në Apoloninë e Ilirisë, në pellgun e Korçës, Dyrrahun antik, Koman - Sardë; me Universitetin e Bolonjës në Kaoninë Antike; Universitetin e Maceratës në luginën e Drinosit, Universitetin e Gjenevës në Orik, Notre Dame ShBA në Forumin e Butrintit, Universitetin e Bernës për kërkime nënujore, Universitetin e Varshavës në zonën e Shkodrës e në Bushat, Universitetin e Vjenës Departamenti i Gjenetikës dhe Evolucionit, dhe Departamentin i Gjenetikës në Harvard për analiza të ndryshme, përfshirë edhe mbështetjen në kuadër të

arkeologjisë mortore, Universitetin e Oxford në Dobër/Vagalat, Universitetin Sapienza-Romë në Çukën e Aitoit, etj. Ndërkohë bashkëpunime shumë të frytshme i kemi me Universitetet Këln e Humboldt në Gjermani, Buffalo në ShBA; Ecole Normale Supérieure, Universiteti Lyon 2 - Lumière, Lille, Aix en Provence, Montpellier 3 - Paul Valéry në Francë; Chietti e Catania në Itali; Shkolla e Konservimit e Restaurimit, Pontevedra - Spanjë.

PROJEKTE ME FINANCIME EU

Instituti i Arkeologjisë realizon **2 projekte me financime të rëndësishme evropiane**: Akademia e Studimeve Albanologjike, nëpërmjet Institutit të Arkeologjisë është pjesë e një konsorciumi të përbërë nga 5 institucione shqiptare, 3 italiane dhe 1 spanjolle: Universiteti i Arteve, Universiteti Politeknik, Universiteti *Luigj Gurakuqi* i Shkodrës, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë; Universiteti i Bolonjës, Urbino Carlo Bo, Fondacioni *Flaminia*; Shkolla e Konservimit dhe Restaurimit të trashëgimisë kulturore, Galisia-Spanjë. *REACH* - Improving Research capacities of Albanian higher education in conservation and restoration of Cultural Heritage. Projekti REACH është një projekt Erasmus + Capacity Building, në fushën e Arsimit të Lartë dhe synon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve në kërkime shumëdisiplinare dhe të aftësive teknike në fushën e konservimit dhe restaurimit të Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri.

Projekti tjetër *Interreg Adrion*, i financuar nga EU Transfer: Modele të integruara menaxhimi për parqet arkeologjike (Integrated models for Archeological parks), konsiston në krijimin e një modeli menaxhimi për parqet arkeologjike në Mesdhe, duke patur si busull orientimi rëndësinë e madhe që ka trashëgimia kulturore, burimet njerëzore dhe ekonomike, si një mjet për forcimin e kohezionit ekonomik dhe territorial në rajon. Projekti promovon bashkëpunimin ndërmjet gjashtë vendeve: Shqipëri, Kroaci, Greqi, Itali, Serbi dhe Slloveni.

Gjithashtu, falë bashkëpunimit me grupin kërkimor *Persée*, të Universitetit Lyon 2 - Lumière (Francë), realizohet projekti i digjitalizimit të revistës *Iliria*, e cila tashmë është e konsultueshme në tërësinë e saj. Ky projekt do të shtrihet edhe në digjitalizimin e koleksioneve të tjera.

ANËTARËSI NË RRJETE KËRKIMORE NDËRKOMBËTARE

Arkeologjia shqiptare është pjesë e një rrjeti kërkimor të rëndësishëm ndërkombëtar, i pari i llojit të tij, **HAEMUS** - i inaguruar në qershor të vitit 2021, dhe që ka për objektiv të bëjë bashkë studiues të arkeologjisë dhe historisë antike që punojnë në Ballkan dhe territoret përreth gjatë periudhave romake të vona dhe bizantine të hershme. Për herë të parë, një rrjet i tillë mbulon një fushë të gjerë studimi dhe bashkon tërësinë e vendeve të Ballkanit, nga lindja në perëndim dhe nga veriu në jug: 11 vendet e Ballkanit (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Rumania, Serbi dhe Sllovenia), si dhe Hungari e Turqi. Nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe praktikave në terren, të studiuesve e studentëve, qëllimi kryesor është të inkurajohen qasjeve ndërdisiplinore dhe hartimi i projekteve të përbashkëta euro dhe transballkanike.

EKSPOZITA NDËRKOMBËTARE

Objekte arkeologjike nga fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe koleksioni i Muzeut Arkeologjik në Tiranë, do të jenë pjesë përbërëse e ekspozitës lëvizëse ndërkombëtare të titulluar "*First Kings of Europe*", me organizues kryesor Field Museum of Natural History, në

Chicago-ShBA fillimisht, në Kanada më pas. Në këtë ekspozitë marrin pjesë 25 institucione nga 11 vende të ndryshme nga Europa Juglindore. Ekspozita ka si temë kryesore periudhën e formimit të elitave gjatë prehistorisë së vonë, nga komunitetet bujqësore të Neolitit, tek elitat e konsoliduara të periudhës së Hekurit në Ballkan. Objektet e ekspozuara tregojnë historinë se si disa individë fuqizuan pushtetin dhe influencën e tyre, duke zotëruar burime natyrore, duke kontrolluar rrugët e tregtisë, ritualet, ceremonitë dhe luftërat.

ARKEOLOGJIA PUBLIKE

Gjatë vitit 2022, u realizua një marrëveshje me Bashkinë e Tiranës dhe DMO Albania, në bashkërendim me Drejtorinë e përgjithshme të Promovimit të qytetit dhe me Drejtorinë e përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, e cila nëpërmjet një serie seminarësh që mbuluan tematika që lidhen me trashëgiminë kulturore arkeologjike të Tiranës, synoi sensibilizimin e brezave të rinj ndaj trashëgimisë kulturore dhe rëndësisë së saj. Kemi të bëjmë me një program me përfitim të madh edukativ dhe njohës për nxënësit e shkollave të mesme, i cili në 8 muaj u realizua nga studiues të Institutit të Arkeologjisë dhe kontriboi në formimin e qytetarëve të denjë, me ndjeshmëri të lartë për trashëgiminë kulturore të qytetit.

Punonjësit e Institutit të Arkeologjisë dhanë ndihmesën e tyre të vyer në procesin e mësimdhënies, si titullarë të disa lëndëve në nivelet Bachelor dhe Master në dy Universitete shqiptare dhe në një universitet jashtë Shqipërisë, sidhe kanë drejtuar studime master dhe doktoraturë.

AKTIVITETI I DETAJUAR KËRKIMOR-SHKENCOR SIPAS DEPARTAMENTEVE DHE TEMATIKAVE KRYESORE

DEPARTAMENTI I PREHISTORISË

Departamenti i Prehistorisë mbulon një hark të gjatë kohor, që nga fillesat e aktivitetit njerëzor në territorin e Shqipërisë, në periudhën e Paleolitit, deri në fundin e periudhës së Hekurit. Por, në anën tjetër, ai ka numrin më të ulët të punonjësve shkencorë në Institutin e Arkeologjisë, të cilët nuk mund të mbulojnë këtë hark kohor, apo tematikat e shumta që përmbart secila prej periudhave. Kjo problematikë (e ngritur nga unë që në vitin e parë e zgjedhur si drejtuese e departamentit) ka çuar në një numër më të ulët projektesh në terren, ndaj, kërkohet një refleksion serioz institucional. Aktualisht, departamenti ka gjithsej 7 anëtarë, nga të cilët 5 janë kërkues shkencorë (3 me gradën doktor dhe 2 në proces), ndërsa 2 janë punonjës me statusin teknik ndihmës-shkencor. Duhet theksuar po ashtu, se 2 nga punonjësit me status kërkues shkencor, janë të profilit interdisiplinor si psh. antropologji fizike apo arkeologji nënujore. Ndërkohë që punonjësit e profilit interdisiplinor janë tepër të rëndësishëm në vijueshmërinë e punës së institucionit tonë, dhe po ashtu edhe për Departamentin e Prehistorisë (tashmë të angazhuar në projekte të departamentit), në anën tjetër departamentit i ngelet një numër shumë i kufizuar i kërkuesve shkencorë me specialitet të ngushtë në prehistori dhe që zhvillojnë aktivitetin kërkimor mbi periudha apo tematika të caktuara lidhur me këto periudha. Aktualisht departamenti ka vetëm tre kërkues të specializuar për periudha që mbulojnë një hark kohor shumë të gjërë (Paleolit-Mezolit; Neolit; Bronz-Hekur).

Pavarësisht kësaj problematike dhe vështirësive që u paraqitën këtë vit me vonesën e dhënies së lejeve të gërmimit, gjatë vitit 2023 anëtarët e departamentit të Prehistorisë kanë vijuar zhvillimin e punës në terren, sipas projekteve kërkimore-shkencore përkatëse; projektet e ndryshme studimore; si dhe kanë realizuar një sërë botimesh dhe pjesëmarrje në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë këtij viti janë realizuar 5

projekte në terren (gërmim dhe vëzhgim arkeologjik); botime brenda dhe jashtë vendit: **10 artikuj dhe raporte** (të botuar ose në proces); **20 kumtesa, prezantime me poster apo pjesëmarrje në panele**, në konferenca ose workshope: kombëtare (8) dhe ndërkombëtare (12); **1 kapitull monografie** është dorëzuar dhe **3 janë në proces**; **1 monografi** (e gërmimeve të vjetra të misionit shqiptaro-francez në Sovjan-botim i Shkollës Franceze të Athinës); **2 monografi** në proces (tema doktorature të mbrojtura).

Edhe gjatë vitit 2023, Departamenti i Prehistorisë e vazhdoi aktivitetin e tij në marrëdhënie me një sërë institucionesh të huaja kërkimore si: Shkolla Franceze e Athinës; Universiteti i Montpellier; CNRS-Francë; CNR-Itali; Universiteti i Bern (Zvicër); Universiteti i Milanos; Universiteti i Këlnit (Gjermani); Departamenti i Antropologjisë Evolucioniste-Universiteti i Vjenës (Austri); Laboratori David Reich i ADN-së së vjetër, në Boston Medical School, Harvard (SHBA); etj. Në sajë të këtyre bashkëpunimeve, shumë prej projekteve të departamentit shquhen për karakterin bashkëkohor dhe ndërdisiplinor, me anë të aplikimit të: analizave dendrokronologjike, paleogjenetike, paleomjedisore, arkeozoologjike, datime absolute me metodën e karbonit 14, analiza kimike, etj. të cilat janë të një rëndësi të veçantë për hulumtimin e periudhave prehistorike.

Një lajm i mirë për këtë vit është botimi nga Shkolla Franceze e Athinës i vëllimit të parë të gërmimeve të kryera në vendbanimin liqenor të Sovjanit nga misioni shqiptaro-francez i pellgut të Korçës (1993-2005), në drejtimin e P. Lera dhe G. Touchais, i cili do dalë nga shtypi brenda muajit dhjetor 2023. Rezultatet e Sovjanit do jenë referencë bazë për kronologjinë absolute të prehistorisë së vonë të Shqipërisë, pasi ai përbën të vetmin vendbanim të shtresëzuar të gërmuar me metoda bashkëkohore, shoqëruar me analiza nga disiplina të shumta, të cilat ofrojnë një tablo më të plotë të jetesës së komuniteteve prehistorike dhe marrëdhënies së tyre me mjedisin përreth. Në dy vitet në vijim priten të dalin dhe 3 monografi të tjera për Sovjanin, si dhe një monografi për vendbanimin e Kallamasit. Ky hap pozitiv për botimet e gërmimeve të shkuara, është si rrjedhojë e një qasjeje që ka patur Instituti i Arkeologjisë gjatë viteve të fundit, përkrahjes së institucioneve partnere të huaja, si dhe angazhimit të drejtuesve aktualë të projekteve përkatës në vazhdim.

Eshtë për t'u theksuar dhe puna e kolegëve të departamentit në drejtim të promovimit të trashëgimisë sonë kulturore lidhur me periudhat prehistorike. Dallojmë këtu ekspozitën lëvizëse në Amerikën Veriore (New York-Chicago-Toronto) me titull 'First Kings of Europe', ku Shqipëria përfaqësohet me 17 objekte të Muzeut Arkeologjik dhe Fondeve të Institutit të Arkeologjisë, krahas 10 vëndeve të tjera të Evropës Juglindore. Pas qëndrimit të ekspozitës për 6 muaj në New York, në datat 28-31 Mars 2023 u zhvillua ceremonia e hajpes së ekspozitës në një prej muzeve më të mëdha në Amerikë, *Field Museum* në Chicago, ku mori pjesë dhe Ministria e Kulturës Znj. Elva Margariti. Kjo ekspozitë përbën një mundësi të shkëlqyer për promovimin e trashëgimisë sonë kulturore lidhur me prehistorinë e vonë të Shqipërisë, të koleksionit të pasur të IA dhe të kërkimeve në vendin tonë.

Falë bashkëpunimeve me institucione të huaja, të dhënat nga Shqipëria po bëhen përherë e më tepër pjesë integrale e projekteve të gjera në rang rajonal, evropian dhe botëror, duke e rritur vizibilitetin e trashëgimisë së pasur arkeologjike nga prehistoria e Shqipërisë dhe duke e bërë atë pjesë të debatit ndërkombëtar shkencor, gjë që rrit ndjeshëm nivelin e kërkimeve në prehistori.

DEPARTAMENTI I ANTIKITETIT

Departamenti i Antikitetit ka në përbërjen e tij 10 anëtarë të profilit shkencor me grada nga Master shkencor në kategorinë e profesorit, gjeëgësisht me titullin shkencor profesor të asociuar. Veprimtaria e tij është e përqëndruar në kërkime në fushën e antikitetit nga shekulli VI p.e.s - IV e.s., me fokus qytetin ilir, kolonitë helene dhe prapatokën, si dheurvejim intensiv të territorit. Anëtarë të departamentit të antikitetit janë të angazhuar dhe në dy projekte ndërkombëtare me fonde të EU. Për vitit 2023 anëtarët e Departamentit të Antikitetit kanë realizuar:

- **20 kontribute** në konferenca, **9** në ato ndërkombëtare dhe **11** në konferenca kombëtare;

- **24 artikuj** nga të cilët **11** kontribute brenda vendit botim dhe proces botimi; **13** artikuj në botime jashtë vendit (botime dhe në proces botimi);

- **2 monografi** në proces botimi; **6 monografi** në proces ;

- 17 projekte** ne terren, 13 projekte IA në bashkëpunim me universitete të huaja, 4 projekte me fonde të IA ;

- **2 projekte me fonde EU** ;

- **6 projekte studimore** (4 projekte në bashkëpunim me universitete të huaja, 2 projekte me fonde IA).

-Tre anëtarë të departamentit kanë marrë pjesë në mësimdhënie si titullar lënde pranë Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (FHF). 1 anëtar i Departamentit pranë Universitetit të Sporteve dhe 1 tjetër në në kuadër të programit për Çertifikimin e udhërrëfyesve turistikë kombëtarë, organizuar nga Tirana Training Center. Dy anëtarë të departamentit kanë dhënë leksione në Universitetin e Barit, Itali dhe École Pratique des Hautes Études, Paris, Francë.

-Anëtarët e departamentit kanë qenë të ngarkuar me punë editoriale në revistat *Candavia* dhe *Iliria* si dhe me përgjegjësi administrative.

DEPARTAMENTI I ANTIKITETIT TË VONË DHE MESJETËS

Aktiviteti shkencor i DAVM gjatë vitit 2023 ka shënoar ecuri pozitive, me se shumti ne drejtim te kerkimit shkencor dhe plotesuar me tej edhe me aktivitete promovuese dhe mediatike. Angazhimi me projektet kerkimore ne terren (13), duke qene aktiviteti kryesor, krijoi mundësinë e përfutimit të të dhënave të reja si edhe avancimin e proceseve studimore respektive në drejtim të aktiviteteve botuese. Progres është arritur në këtë drejtim, përfshirë, kryesisht permes artikujve shkencore brenda (9) dhe jashte vendit (9), studime monografike te perfunduara (1) dhe ne proces (4). Tematika të ndryshme të lidhura me trajtesa urbanistike, arkitektonike, qeramologjike, kulte e rite apo zbulime të reja shtrojnë për diskutim shkencor mjaft argumente të reja dhe hedhin dritë mbi çështje të debatuar të periudhave nga Antikiteti i Vonë, deri në Mesjetën e Vonë.

Per t'u shënuar janë edhe angazhimet në shpërndarjen e rezultateve të punës, përmes informacioneve mediatike, leksioneve të hapura si pjesë e programit ndërkombëtar REACH, apo prezantimit *Mbi arkeologjine e Dyrrachium* për shoqatën anglo-shqiptare, organizuar nga Ambasada Shqiptare në Londër.

I. PROJEKTE ME AKTIVITET NË TERREN

PREHISTORIA

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 5 (pesë) projekte me aktivitet në terren, të gjithë projekte në vazhdim dhe të pëqendruar kryesisht në zonën juglindore. **Projektet kanë zhvilluar gërmime arkeologjike, ndonëse shumica janë gërmime të një shkalle të vogël ose sondazhe; ndërsa 2 prej projekteve përfshijnë dhe vëzhgime arkeologjike sipërfaqësore dhe nënujore.** Projektet trajtojnë tematika e periudha të ndryshme të prehistorisë: gërmime në vendbanime të periudhës së Neolitit si Lin 3, Dunavec, Podgorie (Luadisht), nga të cilët dy të fundit janë sondazhe në vendbanime neolitike të gërmuara edhe më parë, aktivitete që synojnë një kuptim më të mirë të shtrirjes apo organizimit të vendbanimit, apo marrjen e kampioneve për datime absolute; gërmime në vendbanime kodrinore të periudhës së Hekurit, siç është ai i kryer në Barç; apo gërmimi për herë të parë në strehën shkëmbore të Lepenicës, ku synohet marrja e të dhënave arkeologjike shtesë për një kuptim më të mirë të datimit të artit shkëmbor dhe përdorimit të strehës.

Të gjitha projektet, duke aplikuar metoda bashkëkohore të gërmimit stratigrafik si dhe analiza të ndryshme (radiokarbonike dhe dendrokronologjike), janë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për kronologjinë absolute të prehistorisë shqiptare. Duhet dalluar këtu projekti shqiptaro-zviceran në vendbanimin neolitik të Lin 3, në bregun perëndimor të liqenit të Ohrit. Thuajse të gjitha projektet zhvillohen në bashkëpunime me institucione të huaja, të cilët mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve, ndërsa financimi i IA mbulon fuqinë punëtore ose një pjesë të saj. Një risi pozitive e këtij viti ishte mbulimi i dietave nga Akademia e Studimeve Albanologjike, për të gjithë anëtarët që kryen aktivitet jashtë Tiranës, dhe për gjithë kohën e qëndrimit të tyre.

1. LIN 3 (sondazhe nënujore dhe në tokë): Instituti i Arkeologjisë (I. Gjipali, A. Anastasi bashkëdrejtues) dhe Instituti i Shkencave Arkeologjike, Universiteti i Bern, Zvicër (A. Hafner). Gjatë periudhës qershor-gusht 2023. Gjatë këtij sezoni vazhdoi gërmimi i sondazheve në tokë, dhe ujë, me qëllim përcaktimin e shtrirjes së vendbanimit dhe marrjen e kampioneve të tjerë për datime dendrokronologjike. Rezultatet e datimeve me metodën radiokarbonike treguan datimin e fazës më të hershme të vendbanimit në 5280 p.e.s., që sipas autorëve e rendisin LIN 3 si vendbanimin e tipit palafit më të vjetër në Evropë.

2. Kontekstualizimi i Neolitit në fushën e Korçës (vëzhgim sipërfaqësor; sondazh arkeologjik): Instituti i Arkeologjisë (Edlira Andoni); Universiteti i Këlnit, Gjermani (Dr. Jana Anvari); dhe Universiteti i Bafalos, SHBA (Dr. Patrick Willett); korrik-gusht 2023. U kryen disa sondazhe arkeologjike në vendbanimin e Neolitit të mesëm në Luadisht (Podgorie/Korçë) si dhe vëzhgim sistematik sipërfaqësor i pjesës malore që lidh fushën e Korçës me atë të Devollit dhe i pjesës malore që lidh fushën e Korçës me Liqenin e Ohrit.

3. Misioni shqiptaro-francez i Pellgut të Korçës: vendbanimi kodrinor i Barçit (gërmim arkeologjik): Instituti i Arkeologjisë (R. Kurti) dhe Shkolla Franceze e Athinës, CNRS-Paris, Universiteti i Montpellier (A. Gardesin). Në periudhën maj-qershor 2023; u zhvillua sezoni i dytë i gërmimit në vendbanimin kodrinor të Barçit, i njohur me toponimin “Kalaja e Barçit”. Gërmimi po sjell të dhëna të rëndësishme mbi përdorimin e lartësive kodrinore gjatë periudhës së prehistorisë së vonë, ç’ka do kontribuojë në një kuptim më të mirë të dinamikës së vendbanimit në periudhën e Hekurit në pellgun e Korçës, e cila njihet shumë pak.

4. Lepenica: dokumentimi dhe vëzhgimi arkeologjik në një strehë me art shkëmbor parahistorik (Shpella e Shkruar, Lepenica); (sondazh arkeologjik); projekt i

përbashkët i shqiptaro-spanjoll, midis Institutit të Arkeologjisë (drejtues R. Ruka); dhe Escuela Superior de Conservación y Restauración de Bienes Culturales de Galicia- Shkollës së Lartë të Konservimit dhe Restaurimit të Pasurive Kulturore në Galicia, Spanjë, e përfaqësuar nga Fernando Carrera; krahas dokumentimit me metoda bashkëkohore të artit shkëmbor në strehën shkëmbore në Lepenicë të Vlorës (2019), ky projekt ka punuar dhe për kontekstualizimin më të mirë të artit shkëmbor, ç'ka do krijonte mundësi edhe për të marrë të dhëna shtesë mbi datimin e tij. Kjo punë ka konsistuar në kryerjen e një vëzhgimi arkeologjik në zonën përreth, ndërsa në vitin 2023 për herë të parë u krye gërmimi i një sondazhi arkeologjik në strehën shkëmbore. Projekti ka parashikuar dhe restaurimin e artit shkëmbor ndërsa është dorëzuar në Ministrinë e Kulturës (që para 3 vitesh) dosja për shpalljen e strehës shkëmbore Monument Kulture, ndonëse ende nuk është bërë gjë në këtë drejtim.

5. Vëzhgime arkeologjike nënujore-Gjiu i Vlorës, Durrësit, Liqeni i Ohrit, lumi i Dunavecit; Instituti i Arkeologjisë (A. Anastasi); vëzhgime dhe testime të kryera gjatë në periudha të ndryshme të vitit; në kuadër të studimeve doktorale të A. Anastasi “*Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar. Paralele dhe veçanti*”, e cila nuk është përfunduar ende.

5/1. Në kuadër të këtij projekti është kryer edhe një sondazh në vendbanimin neolitik të Dunavecit, nga A. Anastasi, nën kujdesin e I. Gjipalit dhe me ndihmën e ofruar nga specialistët e ekipit të projektit “Lin 3”. Marrja e kampionëve për datime absolute do ofrojë një kontribut të rëndësishëm në rivlerësimin e kronologjisë së vendbanimit.

ANTIKITETI

Departamenti organizon 17 projekte në terren nga të cilat 4 me fonde të IA dhe 13 projekte në bashkëpunim me universitete të huaja: italiane, franceze, angleze, polake etj, si edhe projekte ndërdepartamentale në bashkëpunim me Departamentin e Antikitetit. Anëtarët e departamentit janë të përfshirë në një sërë projektesh studimore që kanë lidhje me fushat e studimit të tyre. Gjithashtu kanë patur një pjesëmarrje të gjerë në konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare, si edhe një sërë botimesh brenda dhe jashtë vendit.

6. Arkeologji e peizazhit në Tepelene-Memaliaj. Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë, Universitetit Aldo Moro, Bari, Itali, Universiteti Sëet Briar College, USA. (E. Shehi, S. Veseli, C. Fiorello, E. Pitt)

7. Studimi gjeofizik Triport-Vlorë. Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit Hamburg, Gjermani. (E. Shehi, M. Siefert)

8. Kështjella e Beratit - dokumentimi grafik digjital dhe evolucioni historic. Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit Politeknik të Barit, (E. Shehi, P. Perfido)

9. Topografia e Epidamne-Dyrrachion. Bashkëpunim i IA, Universitetit Lumiere Lyon 2, France. (E. Shehi, C. Abadie-Reynal)

10. Kaonia bregdetare: Kërkime arkeologjike në Phoinike dhe Butrint. Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Bologna-s. (B. Muka, B. Leppore, E. Giorgi)

11. Peizazhe të fortifikimeve të periudhës antike në Shqipërinë Lindore (FLEAP): survey dhe studimi i zonës midis prefekturave të Elbasanit dhe Korçës (Shqipëri). Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Cataniës. (A. Skënderaj, L. Calio)

12. **Apolonia e Ilirisë.** Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe UMR 8546-AOrOc Paris, Francë, Shkolla franceze e Athinës (EfA), Shkolla franceze e Romës (EfR). Gusht 2022. (B. Muka, St. VERGER)

13. **Kërkime arkeologjike në zonën Vagalat/Dobra, fusha e Livadhjasë dhe lugina e mesme e Pavllës.** Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë me Universitetin Oxford (Britani e Madhe). (B. Muka, M. Melfi)

14. **Tempulli i Shtyllasit- Arkitektura dhe rivlerësimi arkeologjik.** Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit Humboldt, Berlin. (B. Lahi, M. Fiedler)

15. **Projekti shqiptaro-polak në Bushat.** Bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Varshavës. (S. Shpuza, P. Dycezk).

16. **Nymphaion-i i Apolonisë.** Bashkëpunim shqiptaro-francez i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit Aix en Provence (S. Shpuza, F. Quantin)

17. **Çuka e Ajtoit.** Bashkëpunim shqiptaro-italian i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit La Sapienza, Rome, Itali. (A. Meta, J. Bogdani)

18. **Antigonea, Hadrianopoli dhe vendbanime të tjera në luginën e Drinosit.** Bashkëpunim shqiptaro-italian i Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Maceratës, Itali. (S. Veseli, R. Perna)

19. **Lugina e Shushicës, qyteza, tempuj, kisha.** Projekt i Institutit të Arkeologjisë (S. Veseli, S. Muçaj)

20. **Amantia.** Projekt i Institutit të Arkeologjisë (J. Buzo)

21. **Sistemi i Fortifikimeve antiko-mesjetare të Durrësit.** Projekt ndërdepartamental i Institutit të Arkeologjisë (E. Shehi, B. Shkodra)

22. **Bylis: përditësimi i dokumentacionit dhe rikonstruksioni 3D i monumenteve të gërmuara gjatë viteve 1978-1990.** Projekt i Institutit të Arkeologjisë me bashkëpunimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe të Urbanistikës. (O. Ceka).

ANTIKITETI I VONË DHE MESJETA

Departamenti i Antikitetit të Vonë dhe Mesjetë ka arritur të realizojë **17 projekte kërkimore, prej të cilëve 14 projekte realizohen në terren dhe 3 projekte janë studimore** ose janë punë për botimin e temave shumëvjeçare të autorëve, apo pjesë të projekteve në terren të perfunduara, ndërsa njëri është projekt ndërkombetar menaxhimi. Detaje lidhur me ecurinë e procesit të realizimit të këtyre projekteve, gjenden në raportet individuale të punës së anëtarëve të DAVM. **L. Përzhit**a, projekt në terren, Forumi i Butrintit.

23. **L. Përzhit**a, projekt në terren, Vazhdimi i gërmimeve në kalanë e Grazhdanit, varreza dhe kisha në zonën e portës jug-lindore.

24. Danubit dhe Detit Adriatik, monografi 2015-2022.

25. **B. Shkodra**, projekt në terren, “Dyrrachium ne antikitetin e vone”

26. **B. Shkodra**, projekt në terren “Sistemi fortifikues antiko-mesjetar i Durrësit”

27. **B. Shkodra**, projekt studimor, “Importe të qeramikës afrikane në Dyrrachium”

28. **E. Hobdari** projekt në terren, Elbasan, bazilika paleokristiane jashtë mureve

29. **E. Hobdari** projekt në terren, Kërkime në bazilikën e Ballshit
30. **E. Metalla**, projekt në terren (bashkautore) “Zgërdheshi: Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës“
31. **E. Metalla**, projekt në terren (bashkautore) “Amfiteatri i Durrësit“
32. **E. Metalla**, Projekt në teren (bashkautore): “Lugina e poshtme e Drinit në mesjetë”
33. **P. Pushimaj**, projekt në terren, “Drivastum - Drishti nga Antikiteti në mesjetë”.
34. **P. Pushimaj**, projekt në terren, “Sappa”
35. **N. Molla**, Topografia Urbane e Butrintit gjatë Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës.

II. PROJEKTE STUDIMORE

PREHISTORIA

Ka vijuar puna studimore e anëtarëve të departamentit, e cila në disa raste përfshin projekte të mirëfillta studimore, pra pa aktivitet në terren; përgatitjen për botim të doktoraturave të mbrojtura; apo drejt mbylljes së doktoraturave në proces.

1. Paleogjenetika e Evropianëve Juglindorë. Përzierje, seleksionim dhe transformime: rasti i Shqipërisë ; projekt studimor në bashkëpunim midis Institutit të Arkeologjisë (ASA) dhe Departamentit të Antropologjisë Evolucioniste në Universitetin e Vienës (Austri), bashkëdrejtuar nga Dr. Roven Kurti dhe Dr. Ron Pinhasi; në bashkëpunim me gjenetistin David Reich, i Departamentit të Gjenetikës në Harvard Medical School (USA). Me rezultatet e para të analizave janë botuar gjatë vitit 2022 tre artikuj me bashkëautorë në revistën prestigjioze *Science*, të cilat përbëjnë dhe të dhënat e para paleogjenetike dhe ADN-së arkeologjike nga Shqipëria të botuara; ndërsa gjatë vitit 2023 është marrë grupi i dytë i kampioneve për analiza. Krahas artikujve të shumtë që janë parashikuar, në fund do realizohet edhe një botim dedikuar vetëm të dhënave paleogjenetike nga Shqipëria.

2. Qëndrueshmëria e Bujqësisë neolitike në Evropë ; projekt studimor midis Institutit të Arkeologjisë, Tiranë, Institutit të Vjenës për Shkenca Arkeologjike dhe Universitetit të Bristolit. Për palën shqiptare projekti drejtohet nga Dr. Edlira Andoni dhe atë austriake nga prof. asoc. Maria Ivanova-Bieg. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të zbulojë ndërlidhjen e faktorëve mjedisorë, biologjikë dhe socio-kulturorë në fazën fillestare të shpërndarjes së bujqve dhe bimëve e kafshëve të tyre të domestikuara në Evropën Juglindore. Metodologjia e këtij hulumtimi konsiston në analizën e mbetjeve organike të absorbuara në qeramikë. Gjatë vitit 2022 u përzgjedhën kampionet e qeramikës nga vendbanime të Neolitit të Hershëm: Vashtëmi (Korçë), Podgorie (Korçë) dhe Pogradec, ndërsa gjatë vitit 2023 u krye përgatitja e dokumentacionit përkatës dhe një studim paraprak i materialit për studim.

3. R. Ruka, “The Palaeolithic and Mesolithic of Albania”, temë e doktoraturës pranë Universitetit të Këlnit, në Gjermani, nën drejtimin e Prof. J. Richter, i regjistruar në vitin 2016. Mbrojtja e temës është shtyrë për pjesën e dytë të vitit 2024.

4. A. Anastasi “Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar. Paralele dhe veçanti”. Temë e doktoraturës e cila kryhet pranë ASA.

ANTIKITETI

Bazuar në profilizimin e anëtarëve të departamentit të antikitetit dhe të tematikave, të cilat janë diskutuar dhe miratuar në departament, ka vijuar puna për disa projekte studimore.

5. **Studimi i qeramikës së Artemisionit të Epidame-Dyrrahut (Durrës).** (E. Shehi)

6. **Studimi në kuadër të projektit mbi pikturën murale të periudhës romake në Durrës.** (E. Shehi)

7. **Nymphaioni i Apolonisë dhe bitumi në Mesdheun qendror dhe perëndimor.** (S. Shpuza)

8. **Monedha midis popujve grekë dhe jo-grekë: rasti i Ilirëve krahasuar me Trakët dhe Keltët.** IRAMAT-CEB, CNRS, Orléans. (A. Meta)

9. Projekt studimor “**Varret shkëmbore të Matit**”, projekt i Institutit të Arkeologjisë, i realizuar gjatë vitit 2023. (J. Buzo)

10. **“Identifikimi dhe inventarizimi i objekteve të shpërndara (ripërdorur ose të shpërndara) në fshatin Klos pranë qytetit antik.”** (L. Jaupaj)

ANTIKITETI I VONË DHE MESJETA

11. **L. Përzhi**, projekt studimor, Via Lisussus - Naissus, roli i saj në rajonin ndërmjet

12. **L. Përzhi**, projekt studimor, Trasversalja ndërmjet via Lissus - Naissus dhe via Egnatia.

13. **E. Metalla**, bashkëpunëtore në studim: projektin PASHA në kuadër të misionit shqiptaro-francez të Korçës.

III. BOTIME

Kapitull monografie

1. R. Ruka, “**The Balkan coastal Mesolithic: hunters and collectors along the Adriatic fringe**”, në *Oxford Handbook of Balkan Prehistory*, me editorë Michael Galaty, William Parkinson dhe Attila Guycha. Dorëzuar.

Monografi

1. G. Touchais, P. Lera, C. Oberweiler, ***Sovjan, village préhistorique lacustre d’Albanie sud-orientale. Le site dans son environnement***, Recherches Archéologiques Franco-Albanaïses 5. Ecole Française d’Athènes. Ky botim përbën monografinë e parë të gërmimeve të kryera në vendbanimin liqenor të Sovjanit nga misioni shqiptaro-francez i pellgut të Korçës, në drejtimin e P. Lera dhe G. Touchais.

2. E. Shehi, ***Aspekte të prodhimit qeramik në Shqipëri nga antikiteti në mesjetë***. Dorëzuar për botim.

3. E. Shehi, ***Topografia e Durrësit mesjetar - Burimet Dokumentare***. Dorëzuar për botim dhe në proces botimi.

4. B. Muka, *Nga lindja në martesë. Bota femërore e paraqitur në skulpturën e vogël*, një botim përgjithësues mbi figurinat e baltës (prodhimi, funksioni dhe interpretimi). Dorëzuar për botim dhe në proces botimi.

5. L. Përzhita, *Fortesat e Drinit. Shekujt IV-VI*.

PUNË PËR BOTIMIN E STUDIMEVE MONOGRAFIKE

1. *Parure, costume et modes vestimentaires en Albanie à l'Âge du Bronze final et à l'Âge du Fer à travers la documentation funéraire* (monografi në proces botimi/punimi i doktoraturës), parashikuar të botohet nga shtëpia botuese Osanna Edizioni, në Itali, seria Archaeologia-Nuova Serie (ANS). (R. Kurti)

2. *Tipare kulturore dhe kronologjike të Neolitit të hershëm në Shqipëri: qeramika e pellgut juglindor: Vashtëmi, Podgori, Barç, Pogradec* (monografi në proces botimi/punimi i doktoraturës). (E. Andoni)

3. *Les terres cuites d'Apollonia d'Illyrie*, e parashikuar në serinë Apollonia, e cila do të botohet në bashkëpunim midis shkollave franceze të Athinës e Romës. (B. Muka)

4. *Apollonia - Le secteur G: la topographie générale et le grand collecteur de la Ville Basse*. Punë për botim të monografisë. (A. Skënderaj)

5. *Monumente të spektaklit në Ilirinë e Jugut dhe Epir*, proces editimi shkolla franceze e Athinës. (L. Jaupaj)

6. Shkrimi i një kapitulli mbi “*Banesat e periudhës së mesjetës së hershme në Orikum*”. Kapitulli do të botohet në monografinë dedikuar gjurmëve shqiptaro-zvicerane në këtë sit. (S. Shpuza)

7. Shkrimi i një kapitulli mbi “*Monedhat e zbuluara në Orikum*” në monografinë dedikuar gjurmëve shqiptaro-zvicerane në këtë sit. (A. Meta)

8. Shkrimi i një pjese të katalogut mbi monografinë *Enë bronzi nga periudha arkaike në atë romake të zbuluara në territorin shqiptar*. (S. Veseli)

9. *Via Lisussus - Naissus, roli i saj në rajonin ndërmjet Danubit dhe Detit Adriatik*, 2015-2022 (L. Përzhita)

10. *The Despotate of Epirus: the Archaeology of e Late Byzantine State* (N. Molla)

11. *Dyrrachium IV* (E. Metalla dhe grup autorësh)

12. *Komani* (E. Metalla dhe grup autorësh).

ARTIKUJ

PREHISTORIA

Gjatë vitit 2023 janë realizuar: **10 artikuj dhe raporte** (të botuar ose në proces); **1 kapitull monografie** (dorëzuar) dhe **3 kapituj** janë në proces; **1 monografi** (e gjurmëve të vjetra të misionit shqiptaro-francez në Sovjan-botim i Shkollës Franceze të Athinës); **2 monografi** në proces (tema doktrature të mbrojtura).

Nga 10 artikuj ose raporte gjithsej, 3 janë kontribute në revista kombëtare, kryesisht në revistat e IA si *Iliria* (1) dhe *Candavia* (2). Shtatë artikuj të tjerë janë dorëzuar në revista të huaja si *Bulletin archéologique des Écoles françaises à l'étranger* (BEFRA), *Archaeological and Anthropological Sciences*, apo akte konferencash.

1. **E. Andoni**, J. Anvari, P.T. Willet, “Kontekstualizimi i Neolitit në fushën e Korçës: Rezultatet paraprake të sezonit të parë të kërkimeve në terren”, *Candavia* 10 (dorëzuar).

2. **E. Andoni**, “The Early Neolithic site in Pogradec”, Aktet e Konferencës Ndërkombëtare *Common Cultural Heritage: Prehistory in the Balkans*, zhvilluar në nëntor 2022 në Ohër, Maqedoni e Veriut.

3. **R. Kurti**, A. Gardesein, me kontributin e J. Robert, L. Fadin, “Nouvelles recherches de la mission archéologique franco-albanaise du bassin de Korçë (MAFAK)” *Bulletin archéologique des Écoles françaises à l'étranger* [En ligne], Balkans.

4. **R. Kurti**, “A consideration of the ‘warrior identity’ during the Albanian late”, prehistory (Bronze and Early Iron Age), do botohet në monografinë “*First Kings of Europe: Leadership and Inequality in Prehistoric Southeast Europe*”, Akte të konferencës me të njëjtin titull, organizuar në datat 26-28 Prill, 2023, Budapest, Hungari. Artikulli dorëzohet në fund të muajit dhjetor 2023.

5. **R. Ruka**, M. Bassetti, S. Bertola, D. Delpiano, I. Gjipali, M. Peresani, “Istraishta, a Middle Palaeolithic site in the Korça Basin, Southeast Albania. Presentation of the Discoid lithic assemblage and its context”. Pjesa më kryesore e artikullit është përfunduar dhe synohet të dorëzohet për botim në revistën *Archaeological and Anthropological Sciences* brenda vitit 2023.

6. F. Badino, **R. Ruka**, M. Peresani, R. Pini, M. Frechen, V. Argante, D. Susini, D. Abu El Khair, R. Comolli, I. Mazzini, I. Gjipali, K. Çipa, D. Margaritora, “An exploratory paleoenvironmental study on a coastal site in Albania through an integrated approach”. I përfunduar, po diskutohet mes autorëve revista ku do botohet.

7. **U. Tota**, J. Buzo., “Studim antropologjik i mbetjeve eshtërore të dala gjatë gjurmimeve në nekropolin e qytetit antik të Amantias”, dorëzuar për botim në revistën *Iliria*.

8. K. Çipa, K. Lilo, **U. Tota**, “Gjurmime arkeologjike dhe ndërhyrje restauruese në Amantia”, *Candavia* 10. (dorëzuar).

9. K. Çipa, M. Meshini, **U. Tota**, “New evidence from the late prehistoric tumuli near Himara, southwestern Albania”, dorëzuar për botim si pjesë e përmbledhjes së akteve të konferencës me titull: *Perspectives on Balkan Archaeology: The mechanism of Power in Bronze and Iron Age in Southeastern Europe*, mbajtur në Ohër, Ohër, 25 - 28 maj 2022.

10. K. Çipa, M. Meshini, **U. Tota**, “Group of graves with simple and monumental architecture in the Northeastern necropolis of Amantia: Aspects of architecture, burial rites and inventory objects”, dorëzuar për botim pjesë e përmbledhjes së akteve të konferencës me titull: *Archaeology of the Balkans, from Prehistory to the end of Antiquity: Recent discoveries and new methods*, Prishtinë, 17 - 19 nëntor 2022.

ANTIKITETI

Gjatë vitit 2023, anëtarët e departamentit të Antikitetit **24 artikuj** nga të cilët: **11** kontribute brenda vendit botim dhe proces botimi; **13** artikuj në botime jashtë vendit (botime dhe në proces botimi).

11. **B. Muka**, E. Giorgi, “Butrinto sulla rotta di Enea”, në *Archeo* nr.462, Gusht 2023, proces botimi.

12. E. Giorgi, **B. Muka**, “Sulle orme di Enea. Pascoli, laghi e città d’Epiro: le vie d’accesso a Butrinto”, në S. Quilici, L. Quilici (edt.), *Entrando in Città, Atlante Tematico di Topografia Antica* 33 (2023), f. 239-257. **Phoinike VII. Rapporto preliminare sulle campagne di scavi e ricerche 2015-2022:**

13. - G. Lepore, **B. Muka**, “Una nuova statua di Iside?” ;

14. - **B. Muka**, “Nuovi dati dalla pianura meridionale: la necropoli e il poro di Phoinike”;

15. - **B. Muka**, “Conservazioni e memoria”;

16. - **B. Muka**, M. Benfatti, “Archeologia della guerra: la città dei militari” ;

17. - **B. Muka**, “La città ellenistica e la vita religiosa”

18. E. **Shehi**, “Zwei Löwenkopfspeier eines Brunnens in der illyrischen Stadt bei Zgerdhesh (Albanien)” Dorëzuar për botim dhe pranuar nga redaksia e *Archaeologische Anzeiger*, në bashkëpunim me Henner von Hesberg.

19. E. **Shehi**, “Probable representations of three southern Illyrian cities in Trajan’s Column” Dorëzuar për botim dhe pranuar nga redaksia e *Bonner Jahrbucher*.

20. **S. Shpuza**, “Pre roman sites and communities in the hinterland of Lissos”, proces botimi *Novensia* 32.

21. **S. Shpuza**, “Transformations of the Urban Network in Roman South Illyria”, proces botimi *Albanische Forschungen*.

22. **S. Veseli**, “Bronze Figurines of Mercury-Thoth from Albania”, në proces botimi në *Proceedings of the 21st International Congress on Ancient Bronzes, Dissertationes Archaeologicae*.

23. **A. Skënderaj**, “Paysages fortifiés au centre et au sud-est de l’Albanie: un projet de prospection et d’étude”, në aktet e konferencës ndërkombëtare *Archaeology of the Balkans. From Prehistory to the End of Antiquity, Recent Discoveries and New Methods* (Prishtinë 16-19 Nëntor 2022).

24. E. **Shehi**, “Tempujt arkaikë të Durrësit”, në proces botimi revista *Iliria*.

25. E. **Shehi**, “Aspekte të strukturës administrative të Durrësit si bashkësi qytetare dhe nën Topiajt”. Pranuar nga revista *Studime Historike* dhe në proces botimi.

26. **A. Skënderaj**, “Projekti FLEAP në Shqipëri 2022”, dorëzuar për botim në revistën *Candavia*.

27. **A. Meta**, “Hyjni dhe kulte në monedhat e qyteteve në Ilirinë e jugut”, në proces botimi në revistën *Iliria*.

28. **A. Buzo** “Amantia: Studim antropologjik i mbetjeve eshtrorë të dala gjatë gërmimeve në nekropolin e qytetit antik të Amantias”, në proces botimi në revistën *Iliria*.

29. **S. Veseli**, “Antigonea, Hadrianopoli dhe vendbanime të tjera në luginën e Drinosit”, në proces botimi në revistën *Candavia*.

30. **A. Meta**, “Kërkime arkeologjike në Çukën e Ajtoit (Konispol/Sarandë)” në proces botimi në revistën *Candavia*.

31. **B. Muka**, “Kaonia bregdetare: rezultatet e kërkimeve shqiptaro-italiane në Foinike dhe Butrint 2022”, në proces botimi në revistën *Candavia*.

32. **B. Muka**, “Kërkime arkeologjike të vitit 2022 në zonën Vagalat/Dobra, fusha e Livadhjasë dhe lugina e mesme e Pavllës”, në proces botimi në revistën *Candavia*

33. **O. Ceka**, “Bylis 2022: rezultatet e gërmimit në monumentet e agorasë, shek. III p.e.s - II e.s. dhe ndërhyrjet paraprake të restaurimit në cisternën e stadiumit” në proces botimi në revistën *Candavia*.

ANTIKITETI I VONË DHE MESJETA

Për t’u shënuar është botimi i një studimi monografik, ndërkohë që janë në proces botimi rezultatet e punës disa vjeçare mbi *Via Lisussus - Naissus, Amfiteatri i Durrësit, Lugina e Drinit* si edhe studimi postdoktoral mbi **Despotatin e Epirit**. Pjesa më e rëndësishme e kontributeve studimore vjen në formën e artikujve të botuar brenda dhe jashtë vendit.

ARTIKUJ TË BOTUAR BRENDË VENDIT

34. **B. Shkodra**, Dyrrachium në Antikitetin e vonë: Rezultatet e gërmimit të vitit 2022, *Candavia* 10.

35. **B. Shkodra, E. Shehi**: Sistemi fortifikues antiko mesjetar i Durrësit: Rezultate te sezoni 2022, *Candavia* 10.

36. **N. Molla**, *Rezultatet e Projektit Topografia Urbane e Butrintit në Antikitetin e Vonë dhe Mesjetë 2022*. Revista *Candavia* 10.

37. **E. Metalla et. al.**: Kërkime arkeologjike në Amfiteatrin e Durrësit: raporte të fushateve 2021 dhe 2022, *Candavia* 10.

38. **E. Hobdari**: Raport i punës arkeologjike në bazilikën paleokristiane jashtë mureve të Scampis (Elbasan), 2022, *Candavia* 10.

39. A. Cici, F. Qirinxhi, R. Papavasili, **E. Hobdari**, “Ndërhyrje konservuese e mirëmbajtëse në bazilikën paleokristiane të Scampis (Elbasan) 2022”, *Monumentet* 62, 2023.

40. **E. Hobdari**, J. Xhibo dhe V. Hoxhaj, “Gërmimi dhe konservimi i kishës dhe varrezës në Opterushë (Malishevë, Kosovë)”, *Monumentet se shpejti*.

41. **P. Pushimaj**, “Dëshmi të artit Paleokristian në kishën e Shën Mërisë të Drishtit - Relievi i Profetit Jonai”, revista *Iliria*.

42. **P. Pushimaj**, “Kisha e Shën Mërisë së Drishtit: Raport paraprak i gërmimeve të viteve 2019-2021”, *Candavia* 10.

ARTIKUJ TË BOTUAR JASHTË VENDIT

43. **B. Shkodra**: “Late antique Dyrrachium in the light of new archaeological evidences”, Për aktet e Konferencës ndërkombëtare *Archaeology of the Balkans. From prehistory to the end of antiquity*, Prishtine 2022.

44. Th. Maurer, **E. Metalla**, “Neue archäologische Forschungen in Zgërdhesh und die Suche nach Albanopolis“.

45. S. Antonelli, C. Casolino, **E. Metalla**, “Organizzazione e definizione di un quartiere urbano a Durrës tra la fine del Medioevo e l’età Moderna: alcuni dati dal settore meridionale dell’anfiteatro”, *Archeologia Post-medievale*.

46. C. Casolino, S. Antonelli, F. Falcone, **E. Metalla**, F. Stoppa, “Stonepaste ware in Durres: archaeometric analysis”, *Archaeometry*.

47. **E. Hobdari**, “From Early Christian to Modern: The story of the Marbles in the monastery of Saint John Vladimir (Elbasan, Albania)”, në *International Conference “Art Readings 2023” - Metamorphoses old Art Module*, Institute of Art Studies, Bulgarian Academy of Sciences, Sofia, April 20 - 22, 2023.

48. **E. Hobdari**, G. Atanasov dhe A. Milanova, në bashkëpunim me N. Beaudry dhe D. Moreau, “L’église tétraconque récemment découverte à Zaldapa (province de Scythie) au regard des autres tétraconques en Bulgarie actuelle”, *Les églises tétraconques dans l’Antiquité tardive*, PIAC, Città del Vaticano

49. **E. Hobdari**, S. Antolini dhe Y.A. Marano, “Un diaconus de provincia Anconitana a Scampis (Elbasan, Albania)”, në XII Congresso Nazionale di Archeologia Cristiana. *Archeologia cristiana in Italia. Ricerche, metodi e prospettive (1993-2022)*.

50. **N. Molla**, “The Middle Byzantine occupation of the Late Roman proteichisma at Butrint, southern Albania” për *Proceedings of the online international conference on Byzantine, Western and Post-Byzantine Towers (10th-16th centuries)*, 18 - 20 November 2022, Aristotle University, Thessalonica.

51. **N. Molla**, “Before the dawn of the 'Dark Ages'. Butrint’s fortifications in the late antique period” në *Proceedings of the Seventh Symposium of Albanian Studies, 20-22 April 2023*, Nuremberg, Germany. The Albanian language area and its surroundings during (Late) Antiquity to the High Middle Ages. Organizuar nga Ludwig-Maximilians Universität München Abteilung Albanologie Institut für Historisch-Vergleichende und Indogermanische Sprachwissenschaft sowie Albanologie.

IV. PJESËMARRJE NË KONFERENCA /ORGANIZIM KONFERENCASH

PREHISTORIA

Gjatë vitit 2023 anëtarët e departamentit janë paraqitur me **20 kumtesa, prezantime me poster apo pjesëmarrje në panele**, në konferenca ose workshope, nga të cilat 8 janë kombëtare, ndërsa ka një pjesëmarrje më të lartë në konferenca ndërkombëtare, 12 gjithsej. Anëtarët e departamentit kanë paraqitur punimet e tyre në konferenca të ndryshme në Evropë, në shtete si: Italia, Hungaria, Austria, Qipro, Kroacia, ndërsa në takimin e fundit të

European Association of Archeology, në Belfast, ka patur tre prezantime (kumtesa apo postera). Gjithsesi, duhet theksuar se shpenzimet për këto konferenca nuk mbulohen nga institucioni ynë (përveç ndonjë shpenzimi shumë minimalist), por ato mbulohen ose nga vetë kërkuesit ose nga institucionet partnere të huaja.

Në kuadër të një marrëveshje me Bashkinë e Tiranës dhe Institutit të Arkeologjisë për edukimin e brezit të ri rreth trashëgimisë kulturore dhe historike të Tiranës, anëtarë të departamentit kanë dhënë leksione për gjimnazistë nga Tirana.

1. **A. Anastasi**, A. Hafner, I. Gjipali, M. Hinz, M. Brunner, “Lin 3 - 2022”. Prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “*Viti Arkeologjik 2022*”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

2. **A. Anastasi**, “Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar - 2022”. Prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “*Viti Arkeologjik 2022*”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

3. M. Hinz, M. Brunner, **A. Anastasi**, K. Anastasi, A. Hafner, “Settlement dynamics at Lake Ohrid from a wetland perspective. Results of the excavations at Lin 3, Albania, 2022-23”. Session ID 338. Settling Waterscapes in Europe II: Prehistoric Submerged Sites in Lakes, Bogs and Rivers. 29th EAA Annual Meeting in Belfast, Northern Ireland, 30 August - 2 September 2023.

4. **A. Anastasi**, M. Brunner, “The Neolithic site of Dunavec in the focus of new research”. Session ID 338. Settling Waterscapes in Europe II: Prehistoric Submerged Sites in Lakes, Bogs and Rivers. 29th EAA Annual Meeting in Belfast, Northern Ireland, 30 August - 2 September 2023.

5. **E. Andoni**, U. Tota, G. Naumov, K. Penezic, “Gërmime arkeologjike në vendbanimin e Neolitit të Hershëm në Pogradec - raport i gërmimeve arkeologjike për vitin 2022”, prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “*Viti Arkeologjik 2022*”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

6. **E. Andoni**, J. Anvari, P. Willett, “Kontekstualizimi i Neolitit në fushën e Korçës: rezultatet paraprake të sezonit të parë të kërkimeve në terren”, prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “*Viti Arkeologjik 2022*”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

7. **E. Andoni**, “Lista e Kuqe: Një mjet i rëndësishëm për të luftuar kundër trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore”, paraqitur në konferencën Shkencore *Fuqia e muzeve*, e mbajtur në Tiranë më 18 maj 2023, organizuar nga ICOM Shqipëria (E. Andoni bashkëorganizatore).

8. J. Anvari, **E. Andoni**, P. T. Willet (poster) “Towards an understanding of the Neolithic landscape of the Korça plain, Albania”, i paraqitur në 29th EAA Annual Meeting in Belfast, Northern Ireland, 30 August - 2 September 2023.

9. P. Willett, **E. Andoni**, J. Anvari, “Contextualizing the Neolithic of the Korça Plain, Part II: Highland interfaces”, Workshop-i i 45-të Ndërkombëtar për Survejimet në Mesdhe: *Mediterranean Survey (IMS)*, mbajtur më 1-2 dhjetor 2023 në Vienë (Austri).

10. J. Anvari, **E. Andoni**, P. Willett, A. Holguin, V. Fries, T. Krapf, “Towards an understanding of the Neolithic Landscape of the Korça plain”; Konferenca e 9-të Ndërkombëtare: *Prehistoria në Ballkan*, që do të organizohet në Shkup më datën 13 dhjetor 2023.

11. **R. Kurti**, A. Gardesein, me kontributin e J. Robert, U. Tota, “Vendbanimi kodrinor i Barçit - rezultate të sezonit të parë të gërmimit (Misioni shqiptaro-francez i Pellgut të

Korçës, 2022)”, prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “Viti Arkeologjik 2022”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

12. **R. Kurti**, Pjesëmarrëse në panelin me titull “Epokat e shefave dhe luftëtarëve”, në konferencën ndërkombëtare “*First Kings of Europe: Leadership and Inequality in Prehistoric Southeast Europe*”, 26-28 Prill, 2023, Budapest, Hungari.

13. **R. Kurti**, “Refleksione mbi periudhën e hershme të Hekurit në Shqipërinë e Veriut: problematika dhe perspektiva”. Konferenca shkencore ndërkombëtare me titull, *Arkeologjia shqiptare në 75-vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave të Kosovës, Tiranë, 8-9 nëntor 2023.

14. **E. Kujtila**, “Sprovë për një tipologji dhe kronologji të fortikimeve prehistorike të luginës së Shkumbinit”. Konferenca shkencore ndërkombëtare me titull, *Arkeologjia shqiptare në 75-vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave të Kosovës, Tiranë, 8-9 nëntor 2023.

15. **R. Ruka**, F. Badino, “Kërkime për rindërtimin e dinamikave paleo-mjedisore të pleistocenit të vonë: Rasti i rripit bregdetar Triport-Portonov (Vlorë)”. Prezantuar në konferencën shkencore kombëtare “Viti Arkeologjik 2022”, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 17 mars 2023.

16. **R. Ruka**, “From the other side: A General Overview of the Albanian Caves”, X Convegno internazionale, *In Principio Era La Grotta*, Savalletri Di Fasano, 23 - 25 nëntor 2023.

17. F. Badino, **R. Ruka**, M. Peresani, R. Pini, M. Frechen, V. Argante, D. Susini, D. Abu El Khair, Roberto Comolli, Ilaria Mazzini, Ilir Gjipali, Kriledian Çipa, Davide Margaritora. Titulli i posterit: “An Exploratory Paleoenvironmental Study on a Coastal Palaeolithic Site in Albania through an Integrated Stratigraphic Approach (Dalani i Vogël, Vlora)”, 21st International Union for Quaternary Research Congress: Time for change, Roma, korrik 2023.

18. F. Badino, **R. Ruka**, M. Peresani, R. Pini, M. Frechen, V. Argante, D. Susini, *et al.* Titulli i posterit: “An Exploratory Paleoenvironmental Study on a Coastal Palaeolithic Site in Albania through an Integrated Stratigraphic Approach (Dalani i Vogël, Vlora)”, Konferenca *The 36th IAS Meeting of Sedimentology*, Dobrovnik, qershor 2023.

19. **U. Tota**, Titulli i kumtesës: “Quelque aspect des conditions de vies des populations du nord de l’Albanie pendant le Moyen Age (X - XIVE siecles)”, Atelje doktorale “*Vivre, prier et mourir dans un espace insulaire et côtier entre le IVe et le XIIe siècle*”, Zadar (Kroaci) në datat 17 - 21 prill 2023.

20. **U. Tota**, Titulli i kumtesës: “Life condition during Late Roman Period in the ancient city of Dyrrachium”, prezantuar në “*International Congress on Roman Bioarchaeology*”, 26 - 28 tetor 2023, Nikosia (Qipro).

ANTIKITETI

Gjatë vitit 2023, anëtarët e departamentit të Antikitetit kanë paraqitur **20 kontribute** në konferenca të ndryshme shkencore, prej të cilave **9** janë në ato ndërkombëtare dhe **11** janë në konferenca kombëtare.

21. **B. Muka**, *Future Skills for Cultural Heritage Program. Training and Competences fostering Cooperation and Internationalization*, Roma 14-16 Qershor 2023, në panelin *Fostering Cooperation and Internationalization. Needs and opportunities for cooperation in training. A Mediterranean perspective*, 14 qershor 2023.

22. **B. Muka**, *Pictura Parietum. Connessioni Mediterranee in età ellenistica e romana*, Agrigento 6-8 korrik 2023, me kumtesën *Old excavations, new researches: some considerations on the study of the wall paintings of roman period from Albania*.

23. G. Lepore, **B. Muka**, "Phoinike in Epiro: archeologia di una città ellenistica", VIII Convegno Internazionale di Studi Gli spazi della città. Istituzioni, Forme e Funzioni, Paestum, 19-21 tetor 2023.

24. **S. Shpuza**, *Urban and Rural Networks in Roman South Illyria. The Albanian Language Area and Its Surroundings during Antiquity to the High Middle Ages* që organizohet nga Universiteti i Mynihut në datat 21-22 Prill.

25. **S. Veseli**, "Arkeologjia e peizazhit urban në luginën e Drinosit", *Arkeologjia shqiptare në 75 vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, ASHA, ASHAK, IA, IK.

26. J. Bogdani, **A. Meta**, "Kestria, një qytet epirot: kërkime të reja arkeologjike në Çukën e Ajtoit", *Arkeologjia shqiptare në 75 vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, ASHA, ASHAK, IA, IK.

27. **E. Shehi**, B. Shkodra-Rrugia, "Një rivlerësim arkeologjiko-historik i Epidamnit dhe territorit të tij gjatë periudhave parakoloniale", *Arkeologjia shqiptare në 75 vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, ASHA, ASHAK, IA, IK.

28. **B. Muka**, "75-vjetori i arkeologjisë shqiptare dhe sfidat bashkëkohore të kërkimeve arkeologjike", *Arkeologjia shqiptare në 75 vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, ASHA, ASHAK, IA, IK.

29. **O. Ceka**, "Rikonstruksionet 3D në monumentet e agorasë së Bylisit: metoda dhe metodologjia", *Arkeologjia shqiptare në 75 vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva*, ASHA, ASHAK, IA, IK.

30. **A. Meta**, *Konferenca mbi monedhat mesjetare të mbajtur nga Banka e Shqipërisë*.

31. **A. Skënderaj**, "Projekti FLEAP (Peizazhe të fortifikuara në Shqipërinë Lindore): fushata e vitit 2022 në Qarkun e Kolonjës", në konferencën shkencore *Viti Arkeologjik 2022*, mbajtur në Tiranë, pranë Muzeut Arkeologjik Kombëtar, më 17 mars 2023.

32. **J. Buzo**, "Varret shkëmbore të Matit", në konferencën shkencore *Viti Arkeologjik 2022*, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë.

33. **B. Lahi**, "Tempulli i Shtyllasit. Arkitektura dhe rivlerësime arkeologjike: rezultatet e gërmimeve arkeologjike të vitit 2022" në konferencën *Viti arkeologjik 2022*, Instituti i Arkeologjisë, ASA, Tiranë, prill 2023.

34. **S. Veseli**, "Lugina e Drinosit gërmime dhe kërkime arkeologjike, 2021", në konferencën *Viti arkeologjik 2022*, Instituti i Arkeologjisë, ASA, Tiranë, prill 2023.

Në hapësirat e artikujve gjuhësorë trajtohet ndihmesa e drejtpërdrejtë e fjalorëve në nxënien e gjuhës (V. Memisha); nevoja e shqyrtimit të dukurive ligjërimore të shqipes së sotme përtej gjuhësisë së sistemit (T. Plangarica); kontributi i gjuhëtarit Mehmet Halimi në fushën e onomastikës (A. Lama); tonet intonacionore në varietetet e shqipes: një perspektivë tipologjike, - studimi afatgjatë i gjatësisë fonologjike tek fëmijët shqipfolës, - gjatësia kompensatore dhe shkurtimi polisilabik në gegërishte (E. Kapia); transferimi i strukturës semantike të foljeve tek mbiemrat foljorë në shqipe,-emrat e vepruesit dhe struktura e tyre argumentore në shqipe (A. Kanani); ngjashmëri midis gjuhëve ballkanike dhe ndikime të fushave kulturore (E. Shamku); ndërsa nga Departamenti i studimeve letrare është trajtuar historiku i veprave të letërsisë së vjetër shqipe, një premisë e rëndësishme në trajtimin analitik e njohës të tyre, botuar në revistën “Kosova”, n. 48, 2023, organ shkencor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë.

II. Gjatë këtij viti (29 qershor 2023), u zhvillua konferenca shkencore “Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi. Në seancat e kësaj konference 35 kumtuesit, përfaqësues të një areali të gjerë kërkimor, **sollën vështrime të reja** për termat “letërsia dhe qyteti (S. Çapaliku); për etosin diskursiv e diskursin letrar (T. Plangarica)”; diskursin epistolar (A. Leka), por edhe për historinë e letërsisë së shkruar shqipe (E. Paci); veçoritë e këngëve kreshnike shqiptare (Lab. Berisha); për receptimin e poezisë pas vitit '90 (Olimbi Velaj) etj. Si pjesë e rëndësishme e konferencës ishin edhe vështrimet filologjike, çështjet e studimit tekstor të veprave të letërsisë shqipe, përkimet e bashkëlidhjet mes traditash në lidhje me studimet letrare; çështjet e shtypit kulturor e atij letrar në revista të specializuara, ato të didaktikës së letërsisë e të receptimit të tekstit letrar në shkolla, mendimi filozofik i reflektuar në vepra të letërsisë shqipe etj.

Një objektiv i rëndësishëm i strategjisë sonë shkencore për vijimësinë e bashkëpunimeve mes institucioneve shkencore u sendërtua, më datën 15 maj 2023, në konferencën shkencore “Poliedriku Ernest Koliqi në 120-vjetorin e lindjes”, e organizuar nga Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për arbëreshët dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (ASA), në bashkëpunim me Fakultetin Histori-Filologji (UT) dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike (USH). Në këtë veprimtari shkencore sollën kontribute disa nga studiuesit tanë, si : për frymën e epikës popullore shqiptare në vëzhgimet e Ernest Koliqit-Evalda Paci; konceptet e shemblesat orientale e prendimore në mendimin e Ernest Koliqit”- Arian Leka; “Pikësime estetike, filozofike dhe etnologjike në prozën e shkurtër të Ernest Koliqit”- Virion Graçi; “Veçori gjuhësore në veprën e Ernest Koliqit”- Valbona Sinanaj; “Nostalgjia - Kthimet (Nòstoi) e Koliqit. Fantazitë e një kalese të lavdishme”- Rafaela Marteta.

Në kuadrin e Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe të shkëmbimeve akademike mes Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Universitetit të Napolit “L’Orientale”, punonjëset shkencore Evalda Paci, Juljana Kume dhe Enkelejda Shamku-Shkreli u ftuan nga prof. Alberto Manco për leksione me studentë të masterit, pranë këtij Universiteti, në periudhën 22-26 maj 2023. Leksionet me përmbajtje informative u përcollën në mënyrë ndëraktive me studentët. Lektoret e ftuara përcollën një larmi temash, të cilat u shoqëruan edhe me seminarin mbi përkthimin e teksteve të gjuhësisë: përkthimi i librit të Nicola Grandit.

-Në periudhën 1 -7 shtator 2023, në Pesaro të Italisë, Stefan Çapaliku realizoi drejtimin e një masterclassi për dramaturgët e rinj, organizuar nga Academia Mediterranea per gli Attori.

III. Arritjet në punën tonë shkencore lidhen e kanë fillesën në perceptimet bashkëkohore dhe planifikimin e punës sipas disa prioriteteve. Mbështetur edhe në detyrimet që përcaktohen në kontratat shkencore të secilit prej kërkuesve shkencorë në IGJL, prioriteti kryesor ka qenë puna me projekte.

Së pari, për **Fjalorin e madh të gjuhës shqipe** (vepër e përbashkët me ASHSH). Gjatë vitit 2023, referuar programit të punës së hartuar fillimisht (për jetësimin e këtij projekti të përbashkët ndërinstitucional- parashikuar sipas një procesi katërshkallësh), **punonjësit e Institutit** (Valter Memisha, Artur Lama, Tomorr Plangarica, Anila Omari, Anila Kanani, Julia Kume, Engjëllushe Karaj, Erjena Cenka-Lamaj) **kanë punuar** për të përmbyllur fazën e tretë - nxjerrjen / përzgjedhjen dhe verifikimin përfundimtar të fjalësit nga çdo hartues i përfshirë në hartimin e kësaj vepre (fjalësi përfundimtar tashmë i dorëzuar në redaksi); si dhe fillimin e

procesit të hartimit të lemave sipas kriterëve udhëzuese të hartuara nga redaksia e fjalorit, punë që është planifikuar të mbyllet vitin e ardhshëm 2024.

Idetë e ardhura nga disa shkolla e qendra kërkimore europiane janë bërë pjesë e qasjeve dhe e planifikimit të punës në këtë drejtim. Këshilli shkencor ka vlerësuar ndihmesën për kodimet leksikografike të gjuhëtares **Anila Omari** në fazën e dytë të projektit *Fjalor digjital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër* (shek. XV-XVIII); ka mbështetur e nxitur punën hulumtuese e studimore të punojës Enkelejda KAPIA në disa projekte ndërkombëtare në bashkëpunim me studiues të Institutit për fonetikën dhe përpunimin e të folurit pranë Universitetit të Mynihut; hulumtimet e studiueses Merita BRUCI sipas procedurës së **projektit** “Antologji e komentuar tekstesh letrare të autorëve të diasporës arbërore” (në bashkëpunim me prof. Italo Costante Fortino); **punën e mirëorganizuar** të morfologes A. Çerpja, drejtuese e projektit “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, IV (Përmbledhje me artikuj studimorë), 2022-2024; qasjen shkencore të studiueses E. Shkreli-Shamku në projektin ndërkombëtar - *Tipologjitë neostandardizuese në gjuhën shqipe*. Krahasim me gjuhët neolatine, si edhe me format dialektore të italishtes (me UniBo dhe UniTO), si edhe nismën e kërkueses shkencore Rafaela Marteta në kuadër të projektit “Erasmus”, e cila punon për *përkthimin në gjuhën shqipe dhe përshtatjen në kontekstin kulturor shqiptar* të versionit të kursit online MOOC (Massive Open Courses Online - Kurset e Hapura Masive Online) Check and Design (i disponueshëm prej muajit nëntor 2023). etj.

Një përvojë të veçantë e të vlerëshme në kuadrin e bashkëpunimit e të kërkimit shkencor me institucione jashtë IGJL-së, ka krijuar punonjësi, dr. Arian Leka. Gjatë këtij viti ai ka qenë: kordinator i projektit *Balkan “Translations Collider Project”*; bashkëorganizator dhe referent i jashtëm i studimit *Letërsia shqiptare, përkthyer në gjuhët e Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor*, (të dhëna, vëzhgime dhe analiza: 2015-2020)”, realizuar me mbështetjen e BE-së, (Balkan Translations Collider Project - Programi Creative Europe (European Union in Albania), si dhe pjesëmarrës në *Polip - International Literature Festival*, Prishtina - Mbi përkthimin e letërsisë shqiptare në gjuhët e fqinjëve.

IV. Për të zgjeruar hapësirat e komunikimit shkencor mes punonjësve shkencorë, Departamentet dhe Këshilli Shkencor i IGJL-së planifikuan ligjërata e diskutime të hapura me elemente të rëndësishme informative e udhëhapëse për studime bashkëkohore. Gjatë vitit 2023 mund të veçojmë:

1. **Ligjëratën** “Morfologjia e sistemit rasor në gjuhën shqipe” (rikonceptualizim i kundërvënieve sinkronike) e dr. Leonard Dauti, mbajtur datën 23 maj 2023. Kjo ligjëratë erdhi në vijim të studimeve të thelluara të autorit në morfologjinë e shqipes, të kryera në bazë të qasjeve bashkëkohore të gjuhësisë konjitive.

2. **Ligjëratën e dr. Zuzana Finger** “Roli i hermeneutikës në transformimin e përkthimit letrar” dhe atë të dr. Arian Lekës “Empatia hermeneutike në procesin e përkthimit” [15 shtator 2023]. Këto ligjërata kishin pikënisje qasjen hermeneutike dhe një sërë problematikash që lidhen me përballjen e përkthyesit me sfida jo të pakëta në proceset e përkthimit, si edhe me raste më të veçanta që shpien në reflektime mbi njohjen e duhur të konteksteve të caktuara në këto të fundit.

3. **Lektoriumin** e dr. Virion Graçi, në Seminarin e Prishtinës, për krijtimtarinë e Eqrem Bashës. Instituti ynë, në muajin nëntor 2023, përzgjedhi për promovim veprën e akad. Ethem

Likaj “Burimi dhe formimi i dëshirores së shqipes”. Në këtë veprimtari morën pjesë profesorë e studiues të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë (Tiranë), të Universitetit të Durrësit etj. Studiuesit që kumtuan, vlerësuan kontributin e gjerë shkencor të akad. Ethem Likajt në gjuhësinë shqiptare; theksuan se ky studim përbën një kontribut të rëndësishëm në fushën e gramatikës historike të gjuhës shqipe, e konkretisht në trajtimin e një prej kategorive më të veçanta e dalluese të shqipes në raport me gjuhët e tjera të familjes indoevropiane, të origjinës dhe rrugës nëpër të cilën ka kaluar mënyra dëshirore, qoftë në aspekt semantik, qoftë në atë formal.

Duke e vlerësuar librin si vektorin dominues të komunikimit shkencor, disa studiues të departamenteve kanë ndihmuar dukshëm për shpërfaqjen e vlerave të veprave të botuara nga studiuesit e IGJL-së si dhe të qendrave të tjera kërkimore, si: recensionet për Atlasin e mikrovariacionit (morfo-)sintaksor të shqipes (Çerpja); ato për veprat “Studime rreth shqipes së vjetër (shek. XV-XVIII)”, “Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe”, Konsensus dhe polemikë për emrat dhe mitet e letërsisë shqiptare, (E. Paci); për studimin e A. Riskës “Gjurmë të apofonisë” (Omari-Plangarica) e monografinë “Formimi gjuhësor dhe letrar në kurrikulën shkollore të gjuhës dhe letërsisë në gjimnaz” (Plangarica) etj.

V. Një tregues i rëndësishëm që flet për punën e institucionit tonë, është përgatitja për botim dhe paraqitja online e periodikut “Studime filologjike”, hartimi e 13 veprave shkencore (monografi, përmbledhje artikujsh, atlas i mikrovariacionit sitaksor).

-**Numrat 1-2** të vitit 2022 hapen me studimin e gjerë të albanologut danez Gunnar Svane, të ndarë në dy numra reviste. Nga IGJL kanë kontribuar me artikuj e recensione: Anila Omari, Leonard Dauti, Valter Memisha, Hajri Shehu, M. Priku e T. Osmani, Fatos Dibra, si edhe A. Çerpja dhe E. Paci. me prezantime të veprimtarive shkencore të vitit 2022.

-**Numrat 3-4** të vitit 2022 përmbajnë një grup artikujsh nga fusha e letërsisë, dy nga të cilët i kushtohen veprës letrare të dramaturgut Ethem Haxhiademi: Evalda Paci, Emin Emiri, por edhe ato të gjuhëtarëve Anila Omari, Tomorr Plangarica, Emil Lafi, Hajri Shehu, si dhe një paraqitje konferencave shkencore, lektoriumeve e aktiviteteve promovuese nga A. Omari, E. Paci, A. Çerpja.

-**Numrat e vitit 1-2 të vitit 2023** fillojnë me një artikull nga Oreste Parise dhe Merita Bruci kushtuar botimit të parë të poezisë “Kënkëz polithike” të Françesk Santorit, të botuar në dy numra. Ndjek një studim i vitit 1901 i Gjergj Pekmezit për të folmen e Elbasanit, botuar në shqip për herë të parë nga Leonard Dauti dhe vijnë me artikujt e recensionet e Anila Omarit, Tomorr Plangaricës, Evalda Pacit, Fikret Ramadanit Hajri Shehut; paraqiten dhe aktivitetet shkencore të zhvilluara në gjysmën e parë të vitit 2023 nga E. Paci dhe L. Dauti.

-**Numri 3-4 2023** përmban disa artikuj nga fusha e studimeve letrare, me autore Laura Smaqi, Klara Kodra, Alva Dani; ato nga fusha e gjuhësisë Emil Lafi, Rami Memushaj, Hajri Shehu, Zeqirja Ibrahim, Giuseppina Turano; recensionet e Ymer Çirakut për monografinë e Klara Kodrës për Santorin, recensionin dhe prezantimin i dy veprimtarive shkencore të IGJL-së nga Evalda Paci

Tradita e sërishë së botimit të printuar të periodikut tonë SF u shoqërua me hedhjen online të tij. Për ta bërë pjesë të regjistrimit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”, kemi nisur bashkëpunimin me shoqatën ACDA (Albanian Canadian Development Alternative -

Alternativa e Zhvillimit Shqiptar në Kanada), e cila na ka ndihmuar për paraqitjen cilësore online të disa numrave të revistës “Studime filologjike”

Me interesimin e vijueshëm të sekretares shkencore të revistës SF, Anila Omari si dhe falë punës së kujdesshme të disa punonjësve të shoqatës ACDA, janë hedhur në versionin elektronik në portalin albanica.al numrat e 5 viteve (2019 - 2023). Ato përmbajnë një numër artikujsh me interes nga fushat e gjuhësisë, filologjisë së teksteve, gramatikës së shqipes, leksikografisë etj.

Në saj të punës së kujdesshme të autorëve, redaktorëve shkencorë, korrektorëve letrarë-sidomos të punonjësës E. Karaj, u përgatitën për botim dhe **janë në procesin e shtypjes:**

1. *Atlasi “Mikrovariacioni sintaksor i shqipes” me autorë Enkeleida Kapijan, Stefano Coretën, Anila Omarin, Ludmilla Buxhelin.* Ky atlas me vjelje digjitale përbën dokumentimin e parë sistematik të një shumësie tiparesh të mikrovariacionit sintaksor brenda një hapësire të pandërprerë shqipfolëse, duke rritur ndjeshëm njohuritë tona për larminë dialektore të formave gjuhësore në shekullin e 21-të. Ndryshe nga studimet klasike në dialektologjinë tradicionale, të cilat kanë pasur në themel të punës së tyre identifikimin në nivel makro të tipareve dalluese të dialekteve, ky punim, duke u mbështetur në zhvillime të reja në gjuhësi teorike dhe sociolinguistikë, sjell para lexuesit variacionin brenda varieteteve të shqipes në nivel mikro, pra, tipare të cilat nuk janë domosdoshmërisht dalluese mes dy dialekteve të mëdha, por shënojnë herë-herë edhe të folme më të vogla brenda tyre.

2. **Monografite** e studiuesve Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e qytetit të Lezhës* ; Emine Teichmann, *Magjia e poezisë transcendentale*, Spiro GJONI, *Udhëtimi letrar i Sazan Golikut*; **Fjalori i të folmeve çame** me autor Fatmir Muçaj, përgatitur për botim nga Engjëllushe Karaj e V. Memisha.

3. Përmbledhjet me artikuj e studime të gjuhëtarëve Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe* 8 ; Hajri Shehu, *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe*, II Idriz Metani, *Gjurmime për semantikën leksikore në gjuhën shqipe*, III ; vepra Henrik Lacaj, *Sapere aude* (kontribute filologjike); Bibliografia e revistës “Gjuha jonë” përgatitur për botim nga Emil Lafe, Erjena Cenka-Lamaj etj; Vepra XI, XII me artikuj e studime *Për veprën e veprimtarinë e akademik Jani Thomait etj.*

4. Aktet e konferencave:

a. **Një komb, një gjuhë.** veprimtari shkencore e tri qendrave kryesore albanologjike, që përkoi me dy përvjetorë të rëndësishëm për kombin shqiptar: me 110-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë dhe me 50-vjetorinë mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, e cila u organizua në tri sesione: Materialet sesioni i tretë u përgatitën për botim nën kujdesin e punonjësës shkencore, A. Çerpja.

b. “Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi”, e mbajtur në Tiranë në qershor të vitit 2022. Materialet u përgatitën për botim nën kujdesin e punonjësës shkencore Evalda Paci. Në këtë vëllim përmbahen një sërë kontributesh që reflektojnë angazhimin e studiuesve që me kumtesa e qasje bashkëkohore. Ato shtrihen në një larmi fushash e vështirësish.

c. “Studime për leksiko-semantikën dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe (*Mbi kontributet e gjuhëtarëve A. Kostallari, E. Hysa, H. Shehu*)” e cila u zhvillua në Tiranë, më 12 korrik 2022. Materialet u përgatitën për botim nën kujdesin e punonjësit shkencor, T. Plangarica. Përmbledhja e akteve të konferencës, krahas vlerësimit të personaliteteve jubilarë dhe

prurjeve të tyre shkencore, nxit edhe nevojën e shqyrtimeve të mëtejshme të problematikës në fjalë në etapën e tanishme, si edhe besimin se ekzistojnë forcat shkencore që mund të angazhohen në realizimin e *projektit të Semantikës*, në këtë fushë të dijes që kërkon qasje të shumëfishtë, në shumë aspekte edhe ndërdisiplinare.

d. “Kontributi i prof. Seit Mansakut në gjuhësinë shqiptare “, e mbajtur në Tiranë më 27 maj 2022 në bashkëpunim me Universitetin “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës. Materialet u përgatitën për botim nën kujdesin e punonjësës shkencore, Anila Omari. Botimi i materialeve të kësaj konference ndriçon më në thellësi aspektet e ndryshme të veprimtarisë shkencore të prof. Seit Mansakut si edhe çështje të veçanta nga fushat e lëvuara nga prof. Mansaku, dhe plotëson vëllimet me studime që IGJL/ASA i ka botuar vitet e fundit.

VI. Për realizimin e prioriteteve që kemi përcaktuar për periudhën 2024-2025 është e nevojshme të përmirësojmë punën në këto drejtime:

1. Gjatë analizave vjetore të departamenteve në muajin dhjetor 2023, u kërkuar një organizimin më mirë i punës për realizimin e objektivave të dy projekteve “Mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e semantikës gjuhësore (2023-2025), “Fjalor i termave të gjuhësisë, letërsisë dhe retorikës (2022-2025); u ngritën edhe probleme për nevojën e një baze materiale për mirëmbajtjen e materialeve të Kartotekës, të Arkivit etj., për të cilat autoritetet drejtuese të Institutit (së pari drejtori) mbajnë përgjegjësitë e veta institucionale. Në përgjigje të kritikave dashamirëse, në të ardhmen, shtrohet detyra për një angazhim më serioz e cilësor për të përmirësuar punën për shmangien e këtyre mangësive.

2. Edhe pse kemi tregues të vlershëm për realizimin e objektivave sipas strategjisë shkencore të ASA-s dhe të IGJL-së, në të ardhmen nevojitet që punën tonë shkencore ta lidhim koncretisht me dobinë që ajo sjell në tregun social, duke e vlerësuar lexuesin shkencor si konsumator të dijes. Për këtë do të punojmë për rritjen e aftësive në zotërimin e metodologjive të reja në fushat dhe nënfushat tona të kërkimit; për njohjen dhe shkodimin e literaturës bashkëkohore etj.

3. Për të shtuar burimet njerëzore cilësore, do mbështetim kualifikimin e studiuesve në qendra kërkimore, pjesëmarrjen e tyre në projekte evropiane, në lektoriume, tryeza dhe veprimtari shkencore ndërkombëtare.

4. VKM nr. 338, datë 31 maj 2023 “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj” pranë Akademisë së Shkencave solli një situatë që vijon të kërkojë qartësime për: mekanizmat që do garantojnë lirinë akademike të kërkimit; autonominë dhe demokracinë institucionale në lidhje me buxhetin, strukturimin, organizimin dhe zgjedhjen e drejtuesve në gjitha nivelet; statusin e kërkuesit shkencor dhe avancimin e tyre akademik; statusin dhe rolin e punonjësve ndihmës akademikë etj. Sipas këtyre shqetësime, me statusin e drejtorit dhe drejtuesit të KSH jam bashkuar me vendimet e Senatit. Për një mirëorganizim të punës sonë shkencore, krahas garantimit të elementeve e shkencorë të sipërpërmendur, në kuadrin e studimeve ndërdisiplinore, mbështetur edhe në strukturat e organikës së departamenteve, në objektivat e planifikuara për të ardhmen, janë të nevojshme: ristrukturimi i institucionit në departamente a njësi kërkimore sipas përvojës studimore, interesave dhe kualifikimit shkencor dhe shtimi i organikës me punonjës të rinj, fillimisht me kontratë të përkohshme.

5. Sipas traditës së viteve të fundit, duhet të pasurojmë përvojën e fituar në zhvillimin e leksioneve të hapura, të tryezave shkencore. Ato së pari të duhet të na shërbejnë për njohjen e trajtimeve, të koncepteve apo tezave të reja që kanë sjellë anëtarët e departamentit në kumtimet, artikujt e tyre studimorë.

6. Për të pasqyruar diskursin teorik dhe arritjet e studiuesve shqiptarë në studimin e aspekteve të gjuhës në përdorim, është e nevojshme që krahas materialeve që botohen në periodikun “Studime filologjike”, të rinisë puna për botimin e revistës “Gjuha jonë”.

Punën kërkimore-shkencore e mësimore të IGJL-së gjatë vitit 2023, po e paraqesim më gjerë, **sipas rubrikave të mëposhtme:**

I. PROJEKTE TË RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE, KOMBËTARE DHE TË INSTITUTIT

I. a. Fjalori i madh i gjuhës shqipe (vepër e përbashkët me ASHSh)

Gjatë këtij viti 2023 referuar programit të punës së hartuar fillimisht (për jetësimin e këtij projekti të përbashkët ndërinstitucional- parashikuar sipas njëprocesi katërshkallësh), anëtarët e departamentit të aktivizuar në të, kanë punuar për të përmbyllur fazën e tretë, pra, nxjerrjen / përzgjedhjen dhe verifikimin përfundimtar të fjalësit nga çdo hartues i përfshirë në hartimin e kësaj vepre (fjalësi përfundimtar tashmë i dorëzuar në redaksi); si dhe fillimi i procesit të hartimit të lemave sipas kritereve udhëzuese të hartuara nga redaksia e fjalorit, punë që është planifikuar të mbyllet vitin e ardhshëm 2024.

Për veprën kanë punuar konkretisht:

1. Valter Memisha (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar). Drejtuesi i këtij projekti ka mbyllur me sukses sipas planit vjetor:

a. Hartimin e fjalësit të shkronjës P në dorë të parë **27. 000 njësi** dhe përzgjedhjen e redaktimit përfundimtar të fjalësit të kësaj shkronje gjithsej **14. 700 njësi** nga rreth 4. 000 njësi që ka Fjalori i 1980-s. (3.6 herë më shumë ose një fjalës sa 12,5 % e gjithë fjalësit të veprës).

b. Ka filluar procesin hartues dhe deri tani ka ripunuar nga FGJSSH (1980) dhe hartuar nga e para 2. 500 njësi leksikore.

c. Ka përzgjedhur 3590 vargje sinonimike me rreth 18. 700 njësi.

d. Ka përzgjedhur dhe dorëzuar: fjalë të reja dhe togfjalësha të qëndrueshëm (514).

e. Si drejtues i grupit të punës në fjalor, ka redaktuar fjalësin e shkronjave I, Y, X, Xh të hartueses M. Zaçellari.

ë. Paralelisht, ka qenë bashkëpunëtor në hartimin e **Parathënies së Fjalorit**, të shënimeve për përdoruesin, të Pasqyrave Gramatikore, të Shkurtesave (emërtimeve të shkurtuara);

f. Njëkohësisht, akad. prof. dr. Memisha ka punuar si bashkëdrejtues, si zëvendëskryeredaktor dhe si sekretar shkencor i Fjalorit, duke për gatitur dhjetëra materiale referuese dhe informuese për Redaksinë dhe për QBAE-n dhe për kryesinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

2. Artur Lama (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) ka punuar për:

a. hartimin e fjalësit të shkronjës C, si dhe përzgjedhjen e redaktimit përfundimtar të fjalësit të kësaj shkronje sipas korpusit dhe lëndës leksikore të dërguar nga redaksia e veprës “*Fjalori i madh i gjuhës shqipe*”(vepër e përbashkët me ASHSH). Njëkohësisht, ka filluar procesin e hartimit (shpjegim paradigmatic + ilustrim të lemës) të shkronjës C.

b. vjeljen e lëndës leksikore nga vepra I, II e Ernest Koliqit, Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2003.

3. Tomorr Plangarica (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) ka punuar për:

hartimin e fjalësit të shkronjës Ë, si dhe ka mbyllur procesin e përzgjedhjes dhe redaktimit përfundimtar të fjalësit të kësaj shkronje sipas korpusit dhe lëndës leksikore të dërguar nga redaksia e veprës “*Fjalori i madh i gjuhës shqipe*”(vepër e përbashkët me ASHSH). Njëkohësisht, ka filluar procesin e hartimit të shkronjës Ë sipas udhëzimit të përcjellë nga redaksia e fjalorit.

4. Juljana Kume (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) ka punuar për:

hartimin e fjalësit të shkronjës H, si dhe ka mbyllur procesin e përzgjedhjes dhe redaktimit përfundimtar të fjalësit të kësaj shkronje sipas korpusit dhe lëndës leksikore të dërguar nga redaksia e veprës “*Fjalori i madh i gjuhës shqipe*”(vepër e përbashkët me ASHSH). Njëkohësisht, ka filluar procesin e hartimit (shpjegim paradigmatic + ilustrim të lemës) së shkronjës H (200 lema dhe 1500 të pajisura me varg sinonimik).

5. Anila Omari (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

Punë hartuese në kuadrin e projektit të Akademisë së Shkencave *Fjalor i madh i gjuhës shqipe*, ku ka detyrë hartimin e shkronjës R. Ka përfunduar në variantin e parë hartimi i shkronjës R, 1158 njësi, 84 f. A4.

6. Anila Kananaj (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

-Ka vijuar punën si hartuese dhe koordinatore për veprën *Fjalor i madh normativ i gjuhës shqipe* (2024). Duke filluar nga 1 shtator 2023 është propozuar dhe miratuar nga kryesia e ASH-së si redaktore shkencore, duke iu caktuar edhe një grup prej tre hartuesish, të cilët i drejton dhe është përgjegjëse për redaktimin shkencor të shkronjave që po hartohen prej tyre.

-Po në kuadër të projektit të *Fjalorit*, ka kryer funksionin e drejtimit të grupit të forcave ndihmëse, duke dhënë një kontribut përcaktues në ngritjen e kartotekës së posaçme përmes skanimeve dhe kompjuterizimit të materialeve, duke krijuar një bazë të dhënash me rreth një miliard njësi.

-Ka vazhduar rolin e sekretares teknike të gjithë *Fjalorit* dhe ka ruajtur kontakte pune imediate me hartuesit në Shqipëri, në Kosovë dhe me kolegët që punojnë në Itali për leksikun arbëresh.

I. b. projekte të tjera (kolektive dhe individuale - në proces pune)

1. Enkelejda Kapia (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

a. *Strukturat sintaksore dhe prozodike të shqipes* në bashkëpunim me Institute for Phonetics and Speech Processing Ludwig Maximilian Universität, München.

b. *Gjuha e folur dhe evolucioni i saj*. drejtuese për sektorin e shqipes në bashkëpunim me prof. Jonathan Harrington dhe ekipin e tij në Institut for Phonetics and Speech Processing LMU, München fondi nga European Research Council

c. *Rrudhja e tipareve sintaksore dhe fonetike tek e folmja e emigrantëve shqip dhe anglisht folës* me prof. Esther de Leuë Université de Lausanne, Zvicër

d. *Tiparet gjuhësore të fëmijëve shqipfolës* në bashkëpunim Prof. Shanley Allen Kaiserslautern Universitat në Gjermani

2. Rafaela Marteta (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) në kuadër të projektit Erasmus+ ka punuar:

për përkthimin në gjuhën shqipe dhe përshtatjen në kontekstin kulturor shqiptar të versionit të kursit online MOOC (Massive Open Courses Online - Kurset e Hapura Masive Online) Check and Design (i disponueshëm prej muajit nëntor 2023). Kursi është prodhim i Qendrës kërkimore CREMIT (Qendra Kërkimore për Edukimin Mediatik) pranë Universitetit Katolik, Sacro Cuore, Milano, Itali.

3. Anila Omari (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

Vijon punën për projektin *Fjalor digjital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër* (shek. XV-XVIII), projekt i ndërmarrë nga Universiteti Ludwig-Maximilian i Mynihut, Katedra e Gjuhësisë Historike dhe Indogjermane. U miratua faza e dytë e projektit, nëntor 2022- nëntor 2025. Në këtë fazë të punës do të vazhdojë me hartimin e zërave të latinizmave dhe më tej të greqizmave të shqipes së vjetër. Deri tani janë hartuar 133 lema me 82 f.

4. Adelina Çerpja (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

Studime për leksikun dhe për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe IV, 2022-2024

Në emër të grupit të punës ka komunikuar rregullisht me aplikuesit dhe ka grumbulluar kontributet e tyre - 18 të tilla (në pjesën e parë të vitit të ardhshëm nga grupi i punës do të kryhen proceset e tjera, që nga diskutimi e redaktimi i tyre shkencor deri te faqosja e dorëzimi për shtyp).

5. Leonard Dauti (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

Për projektin “Gramatikë e gjuhës shqipe, Morfologji” ka përgatitur dhe paraqitur në vitin 2022, ka punuar dhe përgatitur për kapitullin përkatës të foljes 25 faqe. Objekti: Modaliteti dhe mënyra në gjuhën shqipe. Është një mënyrë e re e paraqitjes së modalitetit dhe raportit mënyrë-modalitet, bazuar në arritjet bashkëkohore të studimeve në këtë fushë.

6. Enkelejda Shkreli (Departamenti i gramatikës dhe historisë së gjuhës)

a. Ka vijuar puna përgatitore për projektin e paraqitur “Krijimi i arkivit elektronik të toponomastikës (digjitalizimi i skedave të toponomastikës, të cilat sot ndodhen në gjendje thuajse të papërdorshme në arkivin e IGJL-së)

-Puna vetjake përgatitore ka konsistuar në:

-Përcaktimin final sasior e përmbajtësor të krejt Arkivit (numër e tipologji skedash).

-Përcaktimin e metodologjisë për krijimin dhe rijetësimin e skedarëve në përgjithësi e sidomos atyre toponomastikë e mikrotoponomastikë në veçanti. Ndërtimin e llojit digjital të skedës përfaqësuese.

-Hartimin e pyetësorit për verifikimin e gjurmës zanore. Ndërtimin empirik të kampioneve sipas parametrave sociolinguistike dhe etnografike.

-Shkrimin e një studimi hyrës (shkrim ende në proces, deri më tani kam shkruar 52 fq.) mbi historikun e Toponomastikës shqiptare, përfshirë edhe Kosovën, kontributet e studiuesve, referencat, rëndësinë dhe kriteret.

b-Projekt ndërkombëtar - *Tipologjitë neostandardizuese në gjuhën shqipe*. Krahësim me gjuhët neolatine, si edhe me format dialektore të italishtes (me UniBo dhe UniTO)

7. Merita Bruci (Departamenti i Studimeve Letrare)

Vazhdon hulumtimet pranë arkivave, qendrave studimore dhe bibliotekave lidhur me gjetjen e këngëve apo letërsi të kultivuar në arbërishte apo arvanitishte, në kuadër të projektit të miratuar në Departamentin e Studimeve Letrare “*Vështrim historiko - letrar mbi diasporën arbërore (shek XVI-XIX)*”, si dhe mbledhjen dhe shqyrtimin e materialeve e të botimeve që lidhen me argumentin e kushteve historike që ndikuan në lëvizjet, shtegtimet dhe zhvendosjet e popullsisë arbërore në territoret jashtë kufijve aktuale të Shqipërisë së sotme politike.

8. E. Paci, S. Çapaliku (Departamenti i Studimeve Letrare)

Në kuadër të Projektit madhor për enciklopedinë shqiptare, të ndërmarrë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, si anëtarë të redaksisë për letërsinë, janë angazhuar në përpilimin e fjalësit përkatës, boca e parë e të cilit do të duhet të dorëzohet pranë redaksisë qendrore dhe asaj vendore deri më datën 31 dhjetor 2023.

II. MONOGRAFI, PËRMBLEDHJE ME STUDIME, FJALORË

A. [të botuar (a) a dorëzuar (a) për botim

a. Monografi (bibliografi)

1. Stefan Çapaliku, - Henrik Lacaj, *Sapere aude* (kontribute filologjike), 181 f.

2. Enkeleida Kapia, Stefano Coreta, Anila Omari, Ludmila Buxheli, *Mikrovariacion sintaksor i shqipes: atlas me vjelje digjitale*, 350 f.

3. Emil Lafe, Erjena Lamaj, Bibliografia e revistës *Gjuha jonë*, 261 f.

4. Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e qytetit të Lezhës* (monografi), 252 f.

5. **Stefan Çapaliku**, monografia “Letërsia dhe qyteti”, 200 faqe. Sh. B. Bardbooks, Prishtinë, 2023 (dërguar për botim)

b. Përmbledhje me artikuj studimorë a tematikë

1. *Studime filologjike*, 1-2/2021, 175 f.
2. *Studime filologjike*, 3-4/2021, 171 f.
3. **Valter MEMISHA**, *Studime për fjalën shqipe* 8 (përmbledhje artikujsh), 324 f.
4. *Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi* (aktet e konferencës) 361 f.
5. *Studime semantike në fushën e leksikut dhe të fjalëformimit në gjuhën shqipe* (Kontribute të personaliteteve gjuhësore A. Kostallari, E. Hysa, H. Shehu) (aktet e konferencës), 295 f.
6. *Kontributi i prof. Seit Mansakut në gjuhësinë shqiptare* (aktet e konferencës), 227 f.
7. *Një komb - një gjuhë* (aktet e konferencës), 529 f.
8. **Hajri SHEHU**, *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe* (përmbledhje artikujsh), 332 f.
9. **Idriz METANI**, *Gjurmime për semantikën leksikore në gjuhën shqipe*, III (përmbledhje artikujsh), 380 f.
10. **Stefan Çapaliku**, “Post scriptum”. Akademia e Shkencave, përmbledhje artikujsh Tiranë, 2023 (përgatitur për botim)

c. Fjalorë

1. **Fatmir Muçaj**, *Fjalor i të folmeve çame*. U përgatit për botim nga Valter Memisha, Engjëllushe Karaj

B. MONOGRAFI, PËRMBLEDHJE ME STUDIME, FJALORË

(në proces pune) [2023]

1. **Artur Lama, E. Karaj** (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

a. kanë lematizuar 20 faqe nga publicistika e Rexhep Qosjes, vepra *Tronditja e shekullit I*, II në kuadrin e projektit “Fjalë me përdorim socio-politik në publicistikën e Rexhep Qosjes “ (**vijon puna**)

b. kanë lematizuar 20 faqe romani *Lulet e kripës* I, II, faqe në kuadrin e përgatitjes së veprës “Fjalë popullore nga Myzeqeja në prozën e Jakov Xoxës” (**vijon puna**).

2. **Tomorr Plangarica** (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) **vijon punën për:**

a. monografinë *Analiza diskursive/tekstore - sfidë teorike e mundësi për interpretim*, filluar në shtator 2017 (materialet e përgatitura në këtë ndërkohë janë depozituar pranë departamentit (110 faqe A4).

b. monografinë *Mësimdhënia e shqipes për të huajt në INALCO, Paris - përvojë e traditë e vyer, Studim*, filluar në shtator 2017 (materialet e përgatitura në këtë ndërkohë janë depozituar pranë departamentit (120 faqe A4)).

c. përgatitjen për botim të përmbledhjes me studime *Parafjalë për vepra dhe autorë*, 2 (deri tani 120 faqe A4 - nuk ka përfunduar puna edhe për dy studimet e fundit që do t'i bashkëngjiten përmbledhjes).

3. Juljana Kume (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

a. Ka vijuar punën për përmbylljen e fazës së ripërpunimit, redaktimit të artikujve shkencorë për realizimin e botimit me *përmbledhje tematike studimesh*, e cila mendohet të përcillet për shqyrtim dhe miratim brenda vitit 2024.

b. Vijon punën për hartimin e fjalorit terminologjik trigjuhësh (shqip - anglisht - italisht) me përkufizim dhe ilustrues *Mjekësia ligjore dhe shkencat e ndërlidhura*. (Gjatë këtij viti është punuar për asocimin e fjalësit-termi shqip me atë korrespondues në gjuhë të huaj, përkatësisht anglisht dhe italisht, si dhe janë hartuar me shpjegimet përkatëse në gjuhën shqipe 200 lema-terma nga fusha e mjekësisë ligjore dhe disiplina të tjera me të cilat ajo bashkëpunon).

4. Rafaela Marteta (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar) vijon punën për monografinë *Nga pedagogjia socialiste e “shkollës së re” te pedagogjitë e reja*: analizë kritike e shkollës së traditës, propozime për një shkollë bashkëkohore.

5. Adelina Çerpja (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

Monografia “Proceset fjalëformuese në gjuhën shqipe - kreativiteti dhe produktiviteti”. Vijim i punës me literaturën shkencore të huaj për këto procese, si dhe me vjelje sporadike të shembujve të përdorur në letërsinë artistike të shkruar apo të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe në median digjitale.

6. Anila Kananaj (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

Në kuadër të punës për monografinë në lidhje me kundrinorët në gjuhën shqipe, ka përfunduar vjelja për plotësat në dhanore për foljet e shqipes nga germa A - N të FGJSH (1980). Ka vazhduar vjelja për plotësat në dhanore të foljeve në pjesën e dytë të fjalorit FGJSH (1980), germa M-ZH. Është shkruar një draft i kapitullit përkatës për këtë tematikë.

7. Valbona Sinanaj (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

Në kuadër të punës për monografinë “Vendi i së folmes së Roskovecit në toskërishten veriore. Analizë e sistemit fonetik” është mbyllur kapitulli hyrës i punimit, si dhe janë realizuar intervistat gjatë verës dhe vjeshtës 2023.

8. Enkelejda Shkreli (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

– “*L’Albanese dai mille volti*” - vepër e miratuar për botim nga Università di Bologna. Plotësuar me të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet e *peer review*. Dërguar në shtyp. Pritet të shtypet në tremujorin e parë 2024.

– *Tipare të Neostandardit të Shqipes. Tipet universale rishtruktuese* - Titull provizor i një monografie të nisur si projekt bashkëpunimi me Università di Bologna.

9. Ilirian Martiri (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

Për sa i takon monografisë “Çështje të sinonimisë sintaksore mes sintagmave emërore me emra veprimi me prapashtesën *-im* dhe sintagmave foljore prej të cilave ato e kanë prejardhjen” ka vijuar puna duke pasur si objektiv përfundimin e kësaj baze alternative, me një vëllim të konsiderueshëm trajtesash në planin teorik të një spektri të gjerë problematikash që lidhen:

10. Stefan Çapaliku (Departamenti i Studimeve Letrare)

Vijon punën për veprën e madhe monografike “Poezia moderne shqiptare”.

11. Merita Bruci (Departamenti i Studimeve Letrare)

Ka vijuar punën me monografinë me titull “F. A. Santori - krijues i romanit të parë në letërsinë shqipe.”

III. ARTIKUJ STUDIMORË TË BOTUAR NË GJUHË TË HUAJ; ARTIKUJ NË REVISTA E PERIODIKË TË INSTITUTIT OSE NË REVISTA TË TJERA SHKENCORE

Gjithsej 64: brenda vendit 33, jashtë vendit 31 artikuj [2023]

Informacion i hollësishëm për botimet e çdo punonjësi shkencor të Institutit jepet në pjesën e dytë të raportit dhe në tabelën përmbledhëse.

1. **Departamenti i Leksikologjisë, i terminologjisë dhe i gjuhësisë së zbatuar 31 artikuj** (botuar dhe dorëzuar për botim), 15 brenda vendit dhe 16 jashtë vendit. Konkretisht, V. Memisha 10 (6 jashtë vendit), T. Plangarica 7 (2 jashtë vendit), E. Kapia 6 (6 jashtë vendit), A. Lama 3 (1 jashtë vendit), J. Kume 4 (1 jashtë vendit), E. Lamaj 1. [2023]

2. **Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës** (botuar e dorëzuar për botim) 15 **artikuj**: 9 brenda vendit, 6 jashtë vendit + 2 përkthime + 2 recensione. Konkretisht, A. Omari 5 (1 jashtë vendit) +2 recensione + 1 përkthim, A. Çerpja 3 (1 jashtë vendit), A. Kananaj 3 (2 jashtë vendit), L. Dauti 1+1 përkthim me fjalë hyrëse; V. Sinanaj 1 (1 jashtë vendit), E. Shkreli 1 (1 jashtë vendit), I. Martiri 1 [2023]

3. **Departamenti i Studimeve Letrare** (botuar dhe dorëzuar për botim): 18 **artikuj** shkencorë (+ 2 recensione + 12 artikuj divulgativë), 9 brenda vendit dhe 9 jashtë vendit. Konkretisht, E. Paci 4 (1 jashtë vendit)+2 recensione, S. Çapaliku 1 (në gjuhë të huaj), M. Bruci 1 (në dy numra të revistës), V. Graçi 1+10 artikuj divulgativë, A. Leka 3 +2 artikuj divulgativë, Roven Vata(punonjëse me kontratë) 8 (8 jashtë vendit) [2023]

IV. REFERATE OSE KUMTESA NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE, KOMBËTARE OSE NË INSTITUT

Gjithsej 80 **kumtime e referime**, nga të cilat 43 janë mbajtur brenda vendit dhe 37 jashtë vendit.

(Informacion i hollësishëm për pjesëmarrjen e çdo punonjësi shkencor jepet në pjesën e dytë të raportit dhe në tabelën përmbledhëse)

1. Departamenti i Leksikologjisë, i terminologjisë dhe i gjuhësisë së zbatuar: 16 kumtesa, nga të cilat 9 brenda vendit dhe 7 jashtë vendit. Konkretisht, V. Memisha 2 (2 jashtë vendit), T. Plangarica 4, A. Lama 3 (1 jashtë vendit), E. Kopia 4 (3 jashtë vendit), J. Kume 2 (1 jashtë vendit), R. Marteta 1 [2023]

2. Departamenti i Gramatikës dhe historisë së gjuhës: 13 kumtesa; 7 kumtesa brenda vendit dhe 6 jashtë vendit. A. Omari 3 (1 jashtë vendit), A. Çerpja 2, V. Sinanaj 3 (1 jashtë vendit), L. Dauti 1, E. Shkreli 4 (4 jashtë vendit) [2023]

Departamenti i Studimeve Letrare: 51 kumtime, 27 brenda vendit dhe 24 jashtë vendit (+2 lektoriume +3 (1 jashtë vendit) në ditët në vijim): E. Paci 18 (7 jashtë vendit), S. Çapaliku 3 (2 jashtë vendit), M. Bruci 1, V. Graçi 6 (1 jashtë vendit + 1 lektorium), A. Leka 6 (3 jashtë vendit) +1 lektorium, R. Vata (punonjëse me kontratë) 16 (11 jashtë vendit)+3 (1 jashtë vendit) në ditët në vijim, E. Karaj 1.

VI. ORGANIZIMI I NJË VEPRIMTARIE SHKENCORE (KONFERENCË, SIMPOZIUM, KOLOKIJUM) RAJONALE, KOMBËTARE OSE NDËRKOMBËTARE, ME TEMATIKË TË MIRATUAR NË KËSHILLIN SHKENCOR.

1. Artur Lama (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

-Bashkëdrejtues i komisionit organizues në Konferencën shkencore “*Studime letrare në proces,perspektiva e qasje të reja zhvillimi*”, ASA, IGJL, Tiranë, qershor 2023.

-Bashkëdrejtues i komisionit organizues në lektoriumin e Dr. Zuzana Finger: “*Hermeneutika, si metodë përkthimi*”, ASA, IGJL, shtator 2023.

2. Juljana KUME (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

Bashkëorganizatore dhe bashkëdrejtuesenë iniciativën ndërinstytucionale (ASA) të drejtuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në organizimin e Konferencës shkencore ndërkombëtare “*Terminologjia në fushat humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë*” në bashkëpunim me Universitetin e Sofies St. Kliment Ohridski dhe Universitetin “Fehmi Agani” të Gjakovës, 11 maj 2023.

3. Stefan Çapaliku (Departamenti i Studimeve Letrare)

30 tetor 2023 në Bibliotekën e Qytetit të Zagrebit, Kroaci. Konferencë për letërsinë e sotme shqipe.

4. Evalda Paci (Departamenti i Studimeve Letrare)

-Anëtare e komitetit organizativ të disa konferencave: *Probleme të reja të albanologjisë në kohën e sotme*, konferencë shkencore ndërkombëtare, organizuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë; *Çështje të gjuhës, letërsisë dhe*

përkthimit letrar, konferencë shkencore ndërkombëtare, organizuar nga Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore (përfshirë Akademinë e Studimeve Albanologjike); *Studime letrare në proces*, Departamenti i Studimeve Letrare, IGJL, 2023; *Letërsitë kombëtare në sistemin universitar*, konferencë shkencore ndërkademi dhe ndëruniversitare, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti i Korçës “Fan Noli”, nëntor 2023.

- **Organizatore** e veprimtarisë shkencore e lektoriumit të mbajtur më datën 15 shtator 2023 nga Z. Finger dhe A. Leka, me tematikë qendrore hermeneutikën e përkthimit, për të cilën kam përgatitur dhe një kronikë sintetike të përfshirë në numrat e fundit të revistës “Studime filologjike”.

5. Arian Leka (Departamenti i Studimeve Letrare)

-Pjesëmarrje në grupin e punës për organizimin e konferencës shkencore konferencën “Poliedriku Ernest Koliqi në 120-vjetorin e lindjes”; Maj 2023.

-Pjesëmarrje në grupin e punës për organizimin e konferencës shkencore “Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi”; Qershor, 2023.

VII. Përgatitje materiale, dokumentesh arkivore dhe librash për botim

1. Tomorr Plangarica (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

a. Përmbledhje e akteve të konferencës shkencore *Studime për leksiko-semantikën në gjuhën shqipe* (Mbi kontributet e gjuhëtarëve A. Kostallari, E. Hysa dhe H. Shehu), organizuar nga IGJL-ja dhe Departamenti i Gjuhësisë dhe Letërsisë të Universitetit të Korçës, Tiranë, 12 korrik 2022, u dorëzua në shtator 2023.

2. Juljana Kume (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

Përmbledhje e akteve të konferencës shkencore ndërkombëtare “Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë terminologjikë” (në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës (dalë nga shtypi: tetor 2023 ISBN 9789928470744).

3. Erjena Cenka-Lamaj (Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë dhe i Gj. së zbatuar)

-Bibliografi e revistës “Gjuha Jonë” **së bashku me prof. Emil Lefe** (dorëzuar për botim)

-Vepra *Sepere Aude* (kontribute filologjike) e Henrik Lacajt me akademik Stefan Çapalikun (dorëzuar për botim).

4. Adelina Çerpja (Departamenti i Gramatikës dhe i historisë së gjuhës)

Përgatitja e Akteve të konferencës shkencore mbarëkombëtare “Një komb - një gjuhë”, IGJL, ASA 529 f. (dorëzuar për shtyp).

5. Evalda Paci (Departamenti i Studimeve Letrare)

Studime letrare në proces, perspektiva dhe qasje të reja zhvillimi, Aktet e konferencës shkencore të mbajtur në 27 qershor 2022, dorëzuar për shtyp në vitin 2023.

6. Engjëllushe Karaj (Departamenti i Studimeve Letrare)

Studime filologjike, 1-2/2021, 175 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime filologjike*, 3-4/2021, 171 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime filologjike*, 1-2/2022, 180 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime filologjike*, 3-4/2022, 212 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime filologjike*, 1-2/2023, 182 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime filologjike*, 3-4/2023, 194 f. (redaktim letrar - faqosje); *Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi* (aktet e konferencës), 361 f. (faqosje); “*Studime semantike në fushën e leksikut dhe të fjalëformimit në gjuhën shqipe*” (Kontribute të personaliteteve gjuhësore A. Kostallari, E. Hysa, H. Shehu) (aktet e konferencës), 295 f. (redaktim letrar - faqosje); *Kontributi i prof. Seit Mansakut në gjuhësinë shqiptare* (aktet e konferencës), 227 f. (faqosje); *Një komb - një gjuhë* (aktet e konferencës), 529 f. (faqosje); Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e qytetit të Lezhës* (monografi), 252 f. (redaktim letrar - faqosje); Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe 8* (përmbledhje artikujsh), 324 f. (redaktim letrar - faqosje); Hajri Shehu, *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe* (përmbledhje artikujsh), 332 f. (faqosje); Henrik Lacaj, *Sapere aude* (kontribute filologjike), 181 f. (faqosje); Emil Lafe, Erjena Lamaj, *Bibliografia e revistës Gjuha jonë*, 261 f. (faqosje); Idriz Metani, *Gjurmime për semantikën leksikore në gjuhën shqipe*, III (përmbledhje artikujsh), 380 f. (redaktim letrar - faqosje)

IV. Instituti i Antropologjisë

I. Kongrese, kuvende, konferenca shkencore

Nr.	Titulli i veprimtarisë	Institucione pjesëmarrëse	Referues gjithsej	Ndërkombëtare	Kombëtare
1.	<i>E adhmja e antropologjisë në Shqipëri dhe Kosovë</i>	1. Universiteti i Prishtinës 2. Instituti Albanologjik	6	+	

II. Veprimtaria botuese

1.	Monografi gjithsej	Përmbledhje studimesh, botime aktesh	Përgatitje botimesh	Botime jubilarë-përuruese
	2	2		
2.	<i>Antropologji</i>	Numra të publikuar	Artikuj gjithsej	Autorë dhe bashkautorë
		1		

III. Projekte

Nr.	Projekte gjithsej	Ndërkombëtare	Me ASHAK-un	Me AKKSHI-n	Me ASHSH	Numri i kërkesve gjithsej
	5	1				

IV. Artikuj shkencorë

Artikuj gjithsej	Jashtë vendit	Brenda vendit	Në gjuhë të huaj
12	4	8	4

V. Pjesëmarrje në konferenca

Pjesëmarrje gjithsej	Ndërkombëtare jashtë vendit	Ndërkombëtare / kombëtare brenda vendit	Në gjuhë të huaj	Në gjuhën shqipe
27	16	11	8	19

Projekte të vitit 2023

(Të dhëna për realizimin dhe buxhetin)

I. Projektet madhore të albanologjisë, me financim nga ASHSH

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni / seksioni	Periodha	Status	Buxheti (lekë)
1.	<i>Enciklopedia e shqiptarëve</i>	Redaksia qendrore, redaksia vendore	QBAE/QBEA	2023-2028	Në proces	44.900.000 (për të tre projektet madhore)
2.	<i>Fjalori i madh i gjuhës shqipe</i>	J. Thomai, V. Memisha	QBAE/QBEA	2021-2024	Në përmbyllje	44.900.000 (për të tre projektet madhore)
3.	<i>Historia e shqiptarëve</i>	N. Ceka, P. Xhufi, P. Milo	QBAE/QBEA	2021-2024	Në përmbyllje	44.900.000 (për të tre projektet madhore)

II. Projekte me financim nga ASHSH gjatë 2023 (përfshirë projektet që vijnë nga viti 2022)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni / seksioni	Periodha	Status	Buxheti (lekë)
1.	<i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimin dhe mikrosiumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës -VITROCERT-1</i>	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2023	Vijon nga viti 2023 (faza II), në vitin 2022 - faza I	867.600 1.456.198
2.	<i>Ngritja e kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit</i>	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2024	Vijon në vitin 2024	1.232.280 për vitin 2023

	<i>gjenetik të specieve drufrutore autoktone në laboratorin e ri të Qendrës CRYOFRUIT</i>					(Parashikim i gjithsej 7.585.608)
3.	<i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësismit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt pilot në rrjet); VITROCERT-2</i>	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2024	Vijon në vitin 2024	1.456.198 për vitin 2023
4.	<i>Ngritja e një banke kombëtare të ADN në popullatën shqiptare për studime gjenetike në këtë popullatë dhe organizimi i një regjistri kombëtar dhuruesish të qelizave staminale për nevojat e transplantit të këtyre qelizave në Shqipëri - ADN CELLSTAM</i>	Genc Sulçebe Ilia Mikerezi	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2024	Vijon në vitin 2024	13.501.927 për vitin 2023
5.	<i>Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore PvaNANOMat</i>	Partizan Malkaj	Qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces, përfundon në maj 2024	1.393.090
6.	<i>Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për kontrollin e cilësisë së mjaltit: eksperimentim në gjetjen e modifikuesit dhe mënyrës së modifikimit - HMF-Sens</i>	Majlinda Vasjari	Qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces, përfundon në maj 2024	1.758.611
7.	<i>Studimi i bashkëveprimit të nano-bionanopjesëzave dhe nanomaterialeve të modifikuara me organizmat e gjallë dhe qelizat e tyre duke përdorur eksperimente in-vivo dhe modelet kompjuterike - NANOBIOTOX</i>	Ledia Vasjari	Qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces, përfundon në maj 2024	1.712.310
8.	<i>Nanosensor për certifikimin e verërave vendëse dhe të importuara bazuar në antioksidantët e tyre totalë - CERTWINE</i>	Kledi Xhaxhiu	Qendra kërkimore NanoAlb	2022-2024	Në proces, përfundon në maj 2024	2.086.320

9.	Drejt krijimit të njësisë së biosensorëve pranë grupit të bioteknologjive molekulare "NanoAlb" - përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar - BIOSENSTOXIC	Ariola Bacu	Qendra kërkimore NanoAlb	2022-2024	Në proces, përfundon në maj 2024	2.097.908
10.	Vlerësimi i shpërndarjes së Hg në sedimentet e Gjirit të Vlorës dhe përcaktimi i Hg në peshq, midhje dhe bimë - HgVlora	Besnik Baraj	Komisioni i fizikës dhe kimisë	2023-2024	Vijon në vitin 2024	591.790 për vitin 2023
11.	Një platformë e përbashkët për energjinë elektrike në sistemin elektroenergjetik të Shqipërisë dhe Kosovës - PPEE-SESHK	Rajmonda Buhaljoti	Komisioni i përhershëm i inxhinierisë	2023	Përfunduar	180.270
12.	Barleti i rigjetur / Barleti i rizbuluar; përkthimi nga origjinali e botimi italisht i dorëshkrimit të panjohur të autorit	Matteo Mandalà	Njësia për arbëreshët, arvanitët e arbëreshët	2023	Përfunduar	800.000
13.	Projekti për kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeofizike në Bylis / gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit - ArkeoBylis	Neritan Ceka	Njësia ArkeoBylis	2021-2023	Përfunduar 2023: faza III 2022: faza II 2021: faza I	957.000 912.614 951.820

III. Projekte me financim nga AKKSHI (2022-2023), në kuadër të thirrjes PKKZh ose asaj bilaterale

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni / seksioni	Periudha	Status	Buxheti miratuar nga AKKSHI (lekë)
1.	Vlerësimi zonal dhe kohor i parametrave fizike, fiziko-kimike dhe sizmike të rrjedhjes së nxehtësisë dhe modelimi i energjisë gjeotermale në zonën e Elbasanit	Rrapo Ormëni	Komisioni i përhershëm i inxhinierisë	2022-2023	Përfunduar, gusht 2023	947.572
2.	Përdorimi i metodave bioteknologjike "in vitro" dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjellës të kategorisë "bazë" të kultivarëve autoktonë të kumbullës	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2023	Përfunduar, gusht 2023	2.057.778

3.	Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerëzore shqiptare sipas markerëve gjenetikë të ADN-së	Ilia Mikerezi	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2023	Përfunduar, gusht 2023	639.335
4.	Zhvillimi i metodave alternative, inovative dhe ekonomike për kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore	Majlinda Vasjari	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2023	Përfunduar, gusht 2023	989.039
5.	Modifikimi i sensorëve të printuar me nanomateriale përpërcaktimin e antibiotikëve në ujëra, projekt bilateral për mobilitet në bashkëpunim me TUBITAK (Turqi)	Majlinda Vasjari	Qendra kërkimore NanoAlb	2022-2024 AKKSHI	Kontrata firmosur në qershor 2022	1.000.000 (për 2 vjet), në proces
6.	Ruajtja e gjermoplazmës frutore autoktone shqiptare nëpërmjet teknologjisë së farave sintetike dhe konservimi i avancuar në temperatura ultra të ulëta (kriokonservimi -196°C); projekt bilateral për mobilitet në bashkëpunim me CNR - Itali	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2025 nga AKKSHI	Kontrata firmosur në korrik 2023	625.000 Në proces

**IV. Projekte me financim nga AKKSHI 2023-2024 në kuadër të thirrjes PKKZH
(Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit / PKKZH
në zbatim nga viti 2023 dhe në vijim të 2024)**

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni / seksioni	Periudha	Status	Buxhet i parashikuar nga AKKSHI (lekë)	Buxhet nga ASHSH (lekë)
1.	Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga fusarium dhe për vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit (triticum aestivum L.)	Ariola Bacu	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	2.719.815	
2.	Roli i dheneve si portatore të "escherichia coli" ekskretuese të toksina "Shiga", bazuar në strategjinë "Një shëndet"	Xhelil Koleci	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	2.592.265	328.000
3.	Vlerësimi ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror i	Adrian Civici	Komisioni i shkencave ekonomike,	2023-2024	Miratuar	2.436.000	158.000

	zonave ligatinore (rast studimor liqeni i Shkodrës)		sociale dhe juridike				
4.	Vlerësimi inovativ i rolit të biomarkerëve dhe bioindikatorëve në cilësinë e produkteve ushqimore detare	Sonila Duka	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	2.975.500	
5.	Përcaktimi i cilësisë së verërave shqiptare në mënyrë të shpejtë dhe të lirë me metodën “ex situ”	Kledi Xhaxhiu	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	1.910.077	12.000
6.	Modelimi i sistemit të integruar të energjisë dhe transportit të energjisë: Roli i energjisë me gaz dhe hidrogjenit në skenarët afatgjatë për Shqipërinë drejt dekarbonizimit të thellë në 2030	Partizan Malkaj	Komisioni i inxhinierisë	2023-2024	Miratuar	2.710.040	75.000
7.	Studimi i incidencës së virusit “tomato brown rugose fruit virus”, sekuencimi i plotë i gjenomës së izolateve shqiptare duke përdorur nanoteknologjinë MinION në domatet e kultivuara në serra	Jordan Mërkuri	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	2.885.760	
8.	Përcaktimi i fosfateve të padeklaruara në ushqime me origjinë shtazore si një mjet i mundshëm drejt parandalimit të mashtrimit	Loreta Vallja	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2024	Miratuar	2.473.100	
9.	Studimi i rolit diagnostikues të autoantitropave specifike në sëmundjet e sistemit nervor me mekanizma imune	Genc Sulçebe	Komisioni i mjekësisë	2023-2024	Miratuar	2.854.000	
10.	Konferenca NanoBalkan	Besnik Baraj	Njësia NanoAlb	2023	Miratuar	1.188.500	

V. Projekte me financim nga AKKSHI 2023-2024 në kuadër të thirrjes bilaterale për Kosovën (PKKZH)

(Projekte bilaterale për aplikime të përbashkëta kërkimore e tekniko-shkencore për një periudhë dyvjeçare mes Shqipërisë dhe Kosovës, aplikuar gjatë muajit qershor 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni /seksioni	Periudha	Status	Buxheti i parashikuar (lekë)	Buxhet nga ASHSH (lekë)
1.	Pastrimi i ujërave të ndotur me fenole duke përdorur	Kledi Xhaxhiu	Njësia NanoAlb	2023-2024	Në pritje miratimi		0

	<i>nanomaterialet 2D të karbonit (grafeni dhe oksidi i grafitit) si adsorbentë - një studim eksperimental dhe teorik</i>						
2.	<i>Riparimi i strukturave të muraturës duke përdorur metodat e aplikimit të FRP (Repairing the Masonry Structures)</i>	Huseyin Bilgin	Njësia gjeoshkencë gjeoinxhinie ri	2023-2024	Në pritje miratimi	1.100.000	0
3.	<i>Vlerësimi i rrezikut sizmik të një sistemi thyerjesh tektonike aktive për një jetë më të sigurt</i>	Klodian Skrame	Njësia gjeoshkencë gjeoinxhinie ri	2023-2024	Në pritje miratimi	1.100.000	0

VI. Projekte me bashkëfinancim nga programi i BE-së *Interreg-Adrion* (2023-2026)

(Në raportet 85 për qind financim në kuadër të fondeve IPA dhe 15 për qind nga vetë institucioni partner-përfitues/ zbatues, aplikuar gjatë muajit qershor 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni /seksioni	Periudha	Status	Buxheti i parashikuar (Eur)	Buxhet nga ASHSH (Eur)
1.	<i>Mbështetja e rrugëve të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve bujqësore për të përsheptuar adoptimin e modelit të ekonomisë cikluese në makrorajonin adriatiko-jonian - AdrionAgroCirc</i>	Ilirjan Malollari	Njësia për energjitë e ripërtëritshme	2023-2026	Në pritje miratimi	124.740	19.000
2.	<i>Zgjidhje të bazuara në bio për mbrojtjen dhe zbutjen e ndikimit të specieve të reja ekzotike në rajonet e Adriatikut dhe Jonit - BioSPINEAIR</i>	Magdalena Cara	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë	2023-2026	Në pritje miratimi	187.403.5	28.110.5
3.	<i>Nxitja e specializimit të zgjuar dhe rritja e kapaciteteve inovative me teknologji të avancuar për krijimin e rajonit të qëndrueshëm blu dhe të gjelbër adriatiko-jonian - SUBER (si partner i asociuar)</i>	Klodiana Gorica	Komisioni i ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike	2023-2026	Në pritje miratimi		

Botime të Akademisë së Shkencave

për vitin 2023

I. Botime me miratuara me vendim të këshillit të botimeve

- Në proces shtypshkrimi:

1. Bardhyl Demiraj, Pjetër Budi, *Pasqyra e t' Rrëfyemit*;
2. Bardhyl Demiraj, *Shkrimet shqip me alfabet grek (shek. XV-XIX)*;
3. Gjovalin Kola, *Romani shqip 1913-1990: histori, tipologji, poetikë*;
4. Stefan Çapaliku, *Imago et Verbum*;
5. Vasil S. Tole, *Koncert për violinë dhe orkestër*;
6. Viola Isufaj, *Në poetikën e Zef Zorbës*;
7. Roland Zisi, *Studime në historinë e letërsisë*;
8. Zyri Bajrami, *Hyrje në evolucionin modular*;
9. Marenglen Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin XX (1900-1945), ribotim*;
10. Marenglen Verli, Arbër Hadri, Ibrahim Gashi, *Shqipëria në dokumentet amerikane (1945), vëll. I*;
11. Shaban Sinani, *Studime antropologjike në etnokulturë*.

- Përgatitur për shtyp:

1. Tefë Topalli, *Krestomaci e albanologjisë, vëll.1*;
2. Bledi Kreka, Manika Kreka, *Protokollet e trajtimit sistematik të kancerit*;
3. Rrapo Ormeni, *The earthquake of 26 November 2019 and what can we learn*;
4. Abaz Hado, *Veshjet tradicionale në artin pamor shqiptar*;
5. Neritan Ceka, *Me arkeologët në kështjellat ilire*;
6. Edmond Buhara, *Historiografia e artit të tingullit në territoret e shqiptarëve të sotëm, vëll. I*;
7. Fiqiri Islami, *Mendimi ekonomik i rilindësve*;
8. Grup autorësh, *Kompleksi ligatinor i Kune-Vainit (Lezhë, Shqipëri) – qasja ekologjike (anglisht)*;
9. Olgita Ceka, *Bylis*;
10. Dhorka Dharmo, *Piktura e kishave e shekujve V-XV në Shqipëri*.

- Botime promovuese në proces shtypshkrimi:

1. Aurela Anastasi, Shaban Sinani (përgatitës) *Akte të konferencës “Shteti i së drejtës në proceset integruuese të Shqipërisë” - vështrime të studiuesve të së drejtës në diasporë*;
2. Grup autorësh, *Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike (vëll. III)*;
3. Grup autorësh, *In memoriam - Luan Starova*;
4. Jaup Zenuni, Antonio Gramshi – biografi;
5. Vasil S. Tole, *Fjalë pa nota (shkrime)*;
6. Perikli Qiriazi, *Qendrat e banuara të Shqipërisë - gjendja dhe e ardhmja (akte të konferencës shkencore)*;
7. Kosta Bajraba, *Mbi zhvillimin e mirëqenien (akte forumesh e konferencash)*;

8. Francesco Altimari, Matteo Mandala, Vincenz Belmonte (përgatitës): *Francesk Anton Santori, Vepra teatrale*, vëll. I;

9. Francesco Altimari, Matteo Mandala, Vincenz Belmonte (përgatitës): *Francesk Anton Santori, Vepra fetare*, vëll. II.

- Botime me subjekte bashkëpunues:

1. *100-vjetori i luftës së Dibrës* (me Shoqatën e Intelektualëve Dibranë);

2. *Lufta antifashiste në Skrapar* (me bashkinë e Skraparit).

- Periodikët:

1. AJNTS 1-2023

2. AJNTS 2-2023

3. AJNTS 3-2023

4. *Studia Albanica* 1-2023

5. *Studia Albanica* 2-2023

- Botime në linjë (online):

1. Simpozium: *Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare*;

2. Simpozium shkencor: *Monitorimi gjeodezik i dinamikës së vijës bregdetare si faktor themelor në modelimin e këtij fenomeni, me impakt të rëndësishëm në aktivitetin shkencor dhe ekonomiko-shoqëror të vendit*;

3. Forum kombëtar: *Sfida e synime për energjinë e rinovueshme: kontribut për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit*.

Gjithsej tituj: 40

Mbi ecurinë e projekteve madhore të albanologjisë gjatë vitit 2023

1. Historia e shqiptarëve

Viti 2023 ishte vit pune intensive për hartimin e tekstit *Historia e shqiptarëve*. Gjatë këtij viti puna u zhvillua me ritme të kënaqshme, pavarësisht disa problemeve të dala, me karakter objektiv, që janë zgjidhur gjatë rrugës. U morën masa për zgjidhjen e kërkesave të ndryshme të ardhura nga autorët e tekstit, që konsistojnë në sigurimin e literaturës dhe burimeve arkivore të nevojshme për shkrimin e historisë sipas periudhave përkatëse apo edhe çështje të tjera për rindarjen e tematikëve që do të trajtohen, qofshin ato në pikëpamje të periudhave historike / vëllimeve të tekstit apo mes autorëve pjesëmarrës në projekt.


Vepra e plotë do të jetë rreth 2250 faqe. Gjatë vitit 2023 nga autorët e gjithë projektit janë përgatitur dhe dorëzuar pranë QBEA-së 576 faqe, nga të cilat 238 faqe në vëllimin e parë, 175 në vëllimin e dytë dhe 163 në vëllimin e katërt.

Sa më sipër, vlen të theksohet se prof. N. Ceka, redaktor përgjegjës i vëllimit të parë të kësaj vepre, ka filluar punën për redaktimin shkencor të saj, me qëllim përgatitjen për botim sa më shpejt të këtij vëllimi. Po vazhdon puna për hartimin e plotë të veprës.

Numri i përgjithshëm i autorëve që marrin pjesë në projekt:

Nr.	Titulli akademik	
1.	Akademikë	7
2.	Profesorë / profesorë të asociuar	22
3.	Doktorë të shkencave	1
Gjithsej		30

Autorët (të plotësuar e sipas periudhave) në projektin *Histori e shqiptarëve* janë si më poshtë:



Vlera e plotë e honorareve për autorët e veprës (në total ~2250 faqe me 2500 karaktere për faqe) shkon 16.875.000 lekë. Nga kjo shumë, deri tani janë paguar 10.728.000 lekë.

Nr.	Periudhat historike	Faqe	Vlera e plotë e honorarëve të autorëve	Paguar 2021-2023
1.	Vëllimi I	~ 500	3.750.000	2.749.500
2.	Vëllimi II	500-550	4.125.000	3.334.500
3.	Vëllimi III	~ 500	3.750.000	1.692.000
4.	Vëllimi IV	~ 700	5.250.000	2.952.000
	Totali	~2250	16.875.000	10.728.000

2. Fjalori i madh i gjuhës shqipe

(Me rreth 100.000 fjalë dhe 10.000 njësi frazeologjike)

Realizimi i projektit për hartimin e *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe* gjatë vitit 2023 ka ecur me ritme të kënaqshme.

Edhe gjatë vitit 2023 vazhdoi puna për plotësimin e kartotekës së posaçme digjitale të kësaj vepre. Ky proces do të vijojë edhe në vitin 2024. Materialet e përzgjedhura nga

redaksia e projektit janë përpunuar për shfrytëzimin e kartotekës digjitale me programe leksikografike bashkëkohore. Kjo mundësoi shfrytëzimin e tyre nëpërmjet një programi të personalizuar kërkimi për këtë korpus digjital, të integruar në platformën e posaçme të uebit që u ndërtua me kërkesën e redaksisë për hartuesit e *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*. Ky bashkëpunim midis redaksisë, drejtuesve të projektit dhe gjithë grupit të logistikës, rezultoi mjaft i frytshëm në pasurimin e faqes së posaçme të ueb-it të *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*, ku janë hedhur në baza të veçantë të dhënash të gjithë fjalorët shpjegues të Akademisë së Shkencave deri më sot, të cilët janë lehtësisht të shfrytëzueshëm për hartuesit duke kursyer shumë kohë dhe hapësirë (*Fjalori 1954, Fjalori 1980, Fjalori 2006, Fjalori 2020, Studime etimologjike (E. Çabej), Fjalori sinonimik, Fjalori etimologjik (K. Topalli), Fjalori frazeologjik, po ashtu “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” për referencë*).

Si rezultat i bashkëpunimit intensiv dhe punës së madhe e të pakursyer të grupin mbështetës teknik të QBEA-së, në platformën e posaçme për hartuesit janë hedhur mbi 160 vepra të gjinive e llojeve të ndryshme në gjuhën shqipe që po përdoret për të gjetur në kontekst fjalët, përdorimet e tyre, shpeshtësinë e përdorimit etj. Paralelisht, hartuesit vazhdojnë të përdorin programin leksikografik të Oksfordit (*Word SmithTools*). Të gjitha materialet janë ruajtur edhe në bazë të dhënash të veçanta, po ashtu në një version të bashkuar duke u krijuar mundësinë hartuesve edhe të kërkojnë në të gjitha materialet njëherësh, jo vetëm duke u shkurtuar kështu kohën e kërkimit duke u dhënë mundësinë të kenë për konsultim në të njëjtin vend fjalorët shpjegues të shqipes të një periudhe 70-vjeçare.

Gjatë vitit 2023 u dorëzuan pranë QBEA-së *Korpusi frazeologjik me rreth 9 000 njësi frazeologjike*, 754 faqe (Jani Thomai e Ali Jashari) dhe korpusi me *Shprehje të huaja të paasimiluara*, 84 faqe. Po ashtu, ka përfunduar hartimi i hyrjes së *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*, i listës me shkurtesa dhe i tabelave gramatikore të tij.

Një pjesë e konsiderueshme e autorëve e ka përfunduar hartimin në dorë të parë të shkronjës apo shkronjave të tyre dhe ia kanë dorëzuar redaktorit shkencor për redaktim. Pjesa tjetër e hartuesve, kryesisht ata që kanë shkronja të gjata apo numër të madh shkronjash për hartim, po vijnë punën dhe parashikohet që deri në fund të vitit 2024 të ketë përfunduar hartimi në dorë të parë i të gjitha shkronjave të fjalorit.

Më tej, është marrë kontakt me grupin e studiuesve në Itali që do të merren me përzgjedhjen dhe hartimin e leksikut arbëresh. Ata janë vënë në dijeni për arritjen e deritanishme të projektit, udhëzuesin për hartimin e FMGJSH dhe u është shpjeguar me hollësi çdo paqartësi në lidhje me vendimet e redaksisë sonë për kriteret e hartimit të fjalorit. Në këtë mënyrë ka hyrë në rrugë të mbarë puna për hartimin e leksikut arbëresh në kuadër të hartimit të *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*. Hartimi i leksikut arbëresh pritet të përfundojë brenda vitit 2024.

Pas përgatitjes së platformës për publikimin online të FMGJSH-së, është punuar për krijimin e disa programeve për hedhjen automatike të fjalëve në bazën e të dhënave pa nevojën e stafit shtesë (që mund të përshtatet dhe të përdoret edhe për projektin e *Enciklopedisë shqiptare*). Edhe shkrimi i këtyre programeve është bërë në të njëjtën frymë me

platformën për FMGJSH-në që është përgatitur duke pasur parasysh jo vetëm përdoruesit e faqes, por edhe vetë platformën në periudhë afatgjatë, përditësimin e lehtë të saj dhe përshtatjen lehtësisht në bazë të çdo ndryshimi. Ndryshimet po pasqyrojnë çdo vendim të redaksisë në mbledhjet periodike.

Studiuesit që marrin pjesë në projekt:

Nr	Drejtuesit & grupet	Emër, mbiemër, pozicioni	shkronjat	(2006, bruto)
1.	Drejtues projekti	1. Akad. Jani Thomai 2. Prof. dr. Valter Memisha, sekretar shkencor		
2.	Kryerredaktor	Akad. Jani Thomai		
3.	Zëvendëskryerredaktorë	1. Prof. dr. Valter Memisha 2. Prof. dr. Shezai Rrokaj		
4.	Grupi I	1. Akad. J. Thomai, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Ali Jashari (hartues)	Frazeologji B,D	11.000 njësi 98 f.
5.	Grupi II	1. Prof. dr. Miço Samara, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Artur Lamaj (hartues) 3. Prof. dr. Tomorr Planganica (hartues) 4. Prof. as. dr. Juliana Kume (hartues) 5. Prof. as. dr. Teuta Toska (hartues)	K C E, Ë H Ç,DH	70 f. 14 f. 18 f. 22 f. 25 f.
6.	Grupi III	1. Prof. dr. Valter Memisha, redaktor / (hartues) 2. Dr. Manjola Zaçellari (hartues) 3. Ma. Engjellushe Karaj (hartues) 4. Prof. dr. Qemal Murati (hartues)	P I,X, Y, XH,O N,NJ Lek. dialektor	110 f. 29 f. 45 F 6. 300 njësi
7.	Grupi IV	1. Akad. Gjovalin Shkurtaj, redaktor / (hartues) 2. Prof. as. dr. Idriz Metani (hartues) 3. Prof. dr. Mimoza Prikur (hartues) 4. Prof. as. dr. Rezarta Draçini (hartues) 5. Ma. Petrit Zenelaj (hartues)	J Z,ZH SH S V	8 f. 31 f. 55 f. 42 f. 42 f.
8.	Grupi V	1. Prof. dr. Shefkije Islamaj, redaktor/e (hartues)e 2. Prof. as. dr. Naim Berisha (hartues) 3. Dr. Viktor Bakillari (hartues) 4. Prof. as. dr. Abdurrahim Maxhuni (hartues) 5. Dr. Sejdi Gashi (hartues)	A L T TH LL, O	33 f. 46 f. 38 f. 11 f. 14 f.
9.	Grupi VI	1. Prof. dr. Shezai Rrokaj, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Anila Omari (hartues) 3. Prof. as. dr. Anila Kananaj (hartues) 4. Prof. as. Dr. Rozana Rushiti (hartues) 5. Dr. Behar Hoxha (hartues) 6. Dr. Resul Telhaj (hartues)	F R M, Q,GJ RR G,U	40 f. 20 f. 51 f. 41 f. 23 f. 43 f.

Numri i përgjithshëm i autorëve që marrin pjesë në projekt:

Nr.	Titulli akademik	
1.	Akademikë	3
2.	Profesorë / profesorë të asociuar	16
3.	Doktorë të shkencave	5
4.	Master shkencash	2
	Gjithsej	26

Nga QBEA-ja gjatë vitit 2023 u morën disa masa organizative duke iu përshtatur nevojave e kërkesave të projektit. Kësisoj, u përgatit programi për hedhjen automatike të fjalëve në bazën e të dhënave. Duke pasur parasysh sfidat e këtij projekti, duke parashikuar dorëzim të fjalëve të hartuara në një afat të shkurtër kohor para publikimit u

morën masat e përballimit të këtij fluksi për hedhjen e të dhënave duke shkruar disa miniprograme të cilat bëjnë hedhjen automatike të materialeve nga Microsoft Word (që do të dorëzojnë autorët) në bazën e të dhënave MySQL. Këto programe zgjidhin problemin e kohës pas dorëzimit të materialeve nga hartuesit dhe bën të mundur që puna të kryhet edhe nga një person i vetëm, të cilit i mbetet detyra vetëm të bëjë procedurën hap pas hapi, të kontrollojë procesin e hedhjes automatike dhe të bëjë përditësimet e duhura në rastet e nevojshme.

Së fundmi, një punë tepër intensive është bërë nga grupi mbështetës teknik i QBAE-së për përgatitjen e një platforme korpusi online ku janë hedhur tashmë mbi 160 materiale në gjuhën shqipe që hartuesit i përdorin për të gjetur në kontekst fjalët, përdorimet e tyre, shpeshësinë e përdorimit etj. Ka dy versione të kërkimit. Për ata që nuk kanë shumë njohuri të gjuhësisë kompjuterike që mund të kërkojnë tekstualisht rastet që duan të shohin në korpus e të marrin shembujt, po ashtu kërkimi më i përparuar me anë të shprehjeve me simbole që ndihmojnë të kërkojnë njëherësh modele ndërtimesh dhe që, jo vetëm kursejnë tepër kohë në vend të kërkimit të çdo rasti të mundshëm një nga një, por edhe japin mundësinë e një pune më cilësore në përzgjedhjen e shembujve pasi nxjerrin më tepër shumëllojshmëri të ndërtimeve gjuhësore.

Puna e kryer gjatë vitit 2023 dhe e dorëzuar pranë QBEA-së arrin në 16.346.980 karaktere ose 6.538 faqe tipografike.

Shuma e paguar në vitin 2023 për autorët për këtë volum pune të dorëzuar ishte 12.520.000 lekë.

3. *Enciklopedia shqiptare*

Nëse projektet *Historia e shqiptarëve* dhe *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* janë tashmë drejt përfundimit, puna për hartimin e *Enciklopedisë shqiptare* është në fillimet e veta, duke marrë në konsideratë qoftë vështirësitë që ka hartimi i një vepre me të tilla përmasa në pikëpamje të metodologjisë shkencore, financimit të saj dhe, mbi të gjitha, koordinimin e punës me ASHAK-un për hartimin e një vepre të përbashkët.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e këtij projekti madhor u hartua menjëherë rregullorja *Për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të "Enciklopedisë shqiptare"*, me qëllim përcaktimin e statusit të redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të atyre të fushave; raportet midis tyre; kompetencat që ushtrojnë, ndarjen e detyrave dhe rregullat e përbashkëta për drejtimin dhe organizimin e punës për zbatimin e projektit.

Në vazhdim u zgjodhën anëtarët e redaksisë qendrore të *Enciklopedisë shqiptare* dhënë 1.3.2023 Ministria e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës miratuan edhe *Protokollin e përbashkët për administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për projektin madhor në albanologji "Enciklopedia shqiptare"*, ku u shprehën në terma administrativë dhe në kushte ekzekutive për financimin e projektit.

Gjatë vitit 2023 redaksia qendrore hartoi dhe miratoi aktet themelore për organizimin e punës si edhe miratoi rregulloret dhe udhëzimet bazë të punës, si: rregullore *Për organizimin e redaksisë qendrore të “Enciklopedisë shqiptare”*; rregullore *Për caktimin e kriterëve bazë për ndarjen e punës midis dy redaksive vendore, si dhe të fushës së veprimit të tyre*; vendim i redaksisë qendrore të ESH-së *Për miratimin e listës dhe emërtimet e redaksive të fushave*; *Përshkrimi i objektit të punës të redaksive të fushave, miratuar nga redaksia qendrore (rekomandime)*; *Kriteret shkencore për t’u zbatuar nga redaksitë dhe autorët në procesin e hartimit të “Enciklopedisë shqiptare”*; *Udhëzues praktik për hartimin e “Enciklopedisë shqiptare” dhe modelet e tyre (ESH)*.

Në vazhdim të organizimit të punës, gjatë këtij viti u ngritën dy redaksitë vendore dhe 28 redaksitë e fushave në Shqipëri e po aq në Kosovë. Me vendimin nr. 5 datë 19.1.2023 *Për caktimin e fushave kryesore të redaksisë vendore të “Enciklopedisë shqiptare”, anëtarëve të redaksisë vendore dhe drejtuesin e redaksisë*, u formua redaksia vendore (Tiranë), e cila përbëhet nga nëntë anëtarë. Në vazhdim të misionit të saj redaksia vendore me vendimin nr. 1, datë 07.9.2023 *Për përbërjen dhe redaktorët përgjegjës të redaksive të fushave* (për pjesën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) vendosi ngritjen e 28 redaksive të fushave, me 111 anëtarë. Ndër këto redaksi është edhe redaksia e posaçme e Maqedonisë së Veriut.

Në fillim të muajit dhjetor 2023 në Vërmicë të Kosovës u zhvillua një takim i rëndësishëm pune ndërmjet redaksisë qendrore, dy redaksive vendore si edhe gjithë redaktorëve përgjegjës të fushave (Tiranë dhe Prishtinë). Ky takim ishte shumë i rëndësishëm për organizimin e mëtejshëm të punës dhe shënoi njëherazi mbylljen e fazës përgatitore të punës më se njëvjeçare të redaksisë qendrore, e cila u prezantoi redaksive vartëse paketën e plotë të akteve ligjore e nënligjore, rregulloreve e udhëzimeve për autorët, të përgatitura prej saj. Deri në 31 dhjetor 2023, redaksitë e fushave punuan për përgatitjen e listës paraprake të zërave enciklopedikë për fushën e tyre, për zgjedhjen e autorëve të mundshëm të artikujve enciklopedikë të fushës së tyre, si edhe për propozimin e volumeve të artikujve të fushës së tyre. Ky proces pune është duke vazhduar edhe gjatë këtij fillimviti.

Gjatë vitit 2023 për *Enciklopedinë shqiptare* u realizua fondi prej 17.870 mijë lekë, kryesisht për pagesën e anëtarëve të redaksive.

Buxheti i realizuar gjatë vitit 2023:

Për vitin 2023 buxheti i QBEA-së është realizuar në vlerën 42.685 mijë lekë. Detajet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Zërat e shpenzimeve	Realizimi për vitin 2023			
	Pagesat sipas VKA 54 & 70	B/p shkencorë	Pagesa autorët sipas VKA 31 dt. 15.04.21	Totali
Projektet albanologjike	29,875		15,086	44,961
Nga te cilat: Stafi	7,994		-	7,994
Historia e shqiptarëve	2,755		2,592	5,347
FMGJSH	1,856	188	11,894	13,938
ESH	17,270		600	17,870
Totali	29,875		15,086	44,961
Tatim në burim			tatim	-2276
Totali i rakorduar me financën				42,685

Parashikimi për vitin 2024:

Veprimtaria kryesore e QBEA-së për vitin 2024 do të jetë përsëri e përqendruar në zhvillimin dhe përfundimin e tri projekteve madhore albanologjike *Historia e shqiptarëve*, *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* dhe *Enciklopedia shqiptare*. Brenda vitit 2024 do të përgatiten për botim dy vëllimet e para të *Historisë së shqiptarëve*, në të cilat bazuar mbi kërkimet më të fundme arkeologjike e burime arkivore për periudhën e antikitetit dhe të mesjetës shqiptare prezantohen përfundimet më të fundme shkencore për këto dy periudha të rëndësishme të identitetit shqiptar. Brenda këtij viti, do të mbyllet gjithashtu puna përgatitore për dy vëllimet e tjera të historisë, sundimi osman dhe shteti i ri shqiptar.

Po ashtu, deri në fund të vitit 2024 do të realizohet edhe përgatitja për botim online e *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*. Paralelisht me procesin e hartimit do të vijojë edhe procesi i redaktimit shkencor dhe hartuesit do të reflektojnë vërejtjet dhe sugjerimet e redaktorit shkencor në punën e tyre. Materiali do të përcillet pastaj në grupin e korrektorëve gjuhësorë. Pas përfundimit të korrektimit gjuhësor të një shkronje, ajo do të dorëzohet pranë QBEA-së dhe do të publikohet në faqen e ueb-it të hartuesve për përdorim të brendshëm. Kjo do të shërbejë për verifikime dhe unifikime të punës nga hartuesit e tjerë, proces final i domosdoshëm para shtypjes në letër të fjalorit. Sa më sipër, puna ka hyrë në fazën e saj përfundimtare dhe publikimi online i këtij fjalori përbën një risi në botimin e veprave të kësaj natyre nga Akademia e Shkencave.

Puna për hartimin e *Enciklopedisë shqiptare* ka hyrë në fazën e saj më të vrullshme. Brenda këtij viti do të hartohet fjalësi enciklopedik, duke përfshirë kategorizimin e artikujve enciklopedikë sipas rëndësisë e madhësisë së tyre, duke u përzgjedhur njëherazi edhe autorët e artikujve. Synimi është që puna për hartimin e artikujve enciklopedikë të fillojë brenda vitit 2024. Nisur nga përmasat dhe rëndësia e këtij projekti kombëtar albanologjik, i cili po realizohet në bashkëpunim me ASHAK, ai do të jetë edhe angazhimi kryesor i stafit të QBEA-së për këtë vit.

Parashikimi financiar për vitin 2024:

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Parashikimi për vitin 2024			
		Pagesa sipas VKA 54 & 70 etj.)	Pagesa sipas VKA 31 datë 15.4.2021	Pagesa për autorë	Totali
1.	Stafi QBEA	820	-		820
2.	<i>Historia e shqiptarëve</i>	3.005		6.147	9.152
3.	<i>Fjalori i madh i gjuhës shqipe</i>	1.998	-	5.928	7.926
4.	<i>Enciklopedia shqiptare</i>	40.227	-		40.227
Totali		46.050	-	13.950	58.125

Relacion për marrëdhëniet me jashtë

I. Samiti VII i akademive të vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të nismës rajonale të Procesit të Berlinit (Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të akademive të këtyre vendeve)

Ka vazhduar pjesëmarrja aktive e ASHSH në organizatat europiane e ndërkombëtare, kryesisht në formën online: ALLEA, ICS, IPA, SAPEA. Në kuadër të këtyre organizatave janë promovuar anëtarë të ASHSH për grupe ekspertize, përfaqësime shkencore, vlerësues projektsh dhe çmime (Merkoçi, Gruda, Mezini etj.).

ASHSH ka mbështetur dhe është anëtare bashkëthemeluese e ALLEA-s së Re me qendër në Berlin.

Në kuadër të organizatave ndërkombëtare ngjarja më e rëndësishme është Samiti VII i akademive të vendeve anëtare të *Procesit të Berlinit*, i organizuar për herë të parë në Ballkan (jashtë BE-së), si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave të Gjermanisë *Leopoldina* dhe ASHSH. Ky samit u zhvillua në Tiranë, me mikpritëse dhe bashkorganizatore ASHSH, në prag të samitit të nivelit të lartë të *Procesit të Berlinit* po në Tiranë. Samiti u inkadrua në temën bosht *Partneritet per Excellence – Partneritet për Europën* (Tiranë, 18-20 shtator 2023) dhe u qendërzua në tre prioritete:

- Vlerësimi i progresit të komuniteteve të arsimit të lartë, kërkimit dhe inovacionit në Ballkan dhe Europën Juglindore drejt integritimit në kornizat e Bashkimit Europian;
- Krijimi i përsosmërisë në Ballkan nëpërmjet instrumenteve dhe aleancave të mençura;
- Zhvillimi i skemave të personalizuarra të lëvizshmërisë për studentët, studiuesit dhe profesionistët, duke përfshirë (ri-)lidhjen e diasporave akademike me vendet e tyre të origjinës.

Konferenca u bashkëdrejtua nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i ASHSH, dhe akad. Gerald Haug, kryetar i Akademisë *Leopoldina*. Përveç drejtuesve të akademive të vendeve të Ballkanit Perëndimor morën pjesë kryetarë të akademive dhe përfaqësues të rëndësishëm të vendeve europiane, si Austria, Italia, Franca, Bullgaria etj.

Samiti VII i akademive të vendeve anëtare të nismës gjeopolitike të *Procesit të Berlinit* është ngjarja më e rëndësishme rajonale dhe europiane që zhvillohet në Tiranë nën përgjegjësinë e ASHSH.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor në kontekstin aktual të pasigurisë gjeopolitike dhe luftës në tokën evropiane; rëndësinë e forcimit të lidhjeve, transportit, tregtisë, energjisë dhe lidhjeve dixhitale në Ballkanin Perëndimor, si dhe midis rajonit dhe BE-së. U theksua rëndësia që ka rritja e GDP për kërkimin shkencor dhe ngritjen e qendrave elitare rajonale, duke e konsideruar nivelin 1 për qind një minimum jetik për shkencën. Objektivi për 2 për qind të GDP-së për shkencën u rikonfirmua në rezolutën e samitit të nivelit të lartë tri javë më pas. Pjesëmarrësit bënë

gjithashtu një pasqyrë të progresit, sfidave të vazhdueshme e perspektivave për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor si një hap drejt integritit gradual të rajonit në politikat, mekanizmat dhe instrumentet e BE-së.

Dokumenti përfundimtar i samitit, i pranuar në fund të tij, në variantin e qarkulluar në rrjetin ndërkademiq europian, u miratua paraprakisht nga ASHSH dhe *Leopoldina*.


II. Marrëveshje të nënshkruara gjatë vitit 2023 (Memorandume, protokolle)	
1. Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (protokoll)	
2. Me Akademinë e Shkencave të Austrisë	
3. Me Akademinë e Shkencave të Rumanisë	
4. Me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë	
5. Me Akademinë e Shkencave të Lituanisë	
6. Me Akademinë e Shkencave të Malit të Zi	
7. Me Universitetin <i>L'Orientale</i> të Napolit	
8. Me Universitetin <i>Ben Gurion</i> të Izraelit	
9. Me IZUM-in	
II. Marrëveshje të pranuar prej palëve (Në pritje të nënshkrimit):	
1. Me Akademinë e Shkencave të Çekisë	
2. Me Akademinë e Shkencave të Turqisë	
III. Marrëveshje në proces negociimi	
1. Me Akademinë e Shkencave të Hungarisë	
2. Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut	
3. Me Akademinë e Shkencave të Sllovenisë	
4. Me Akademinë e Shkencave të Kroacisë	
5. Me Universitetin e Palermos	
IV. Vizita të realizuara gjatë vitit:	
- Në Akademinë e Shkencave të Rumanisë; - Në Akademinë e Shkencave të Austrisë; - Në Akademinë e Shkencave të Bullgarisë; - Në Akademinë e Shkencave të Malit të Zi; - Në Akademinë e Shkencave të Lituanisë.	

Veprimtaria vjetore e bibliotekës shkencore

Zgjerimi i sistemit të informacionit për veprimtaritë kërkimore të kërkuesve shkencorë në platformën ECRIS.AL

ASHSH menaxhon sistemin informues për veprimtarinë kërkimore në Shqipëri (ECRIS.AL), që është i lidhur me sistemin e integruar bibliotekar të informacionit COBISS.AL (*sistem dhe shërbime të përbashkëta bibliografike online*). Në këtë mënyrë ky sistem mundëson qasje të drejtpërdrejtë në bibliografitë e kërkuesve shkencorë dhe institucioneve kërkimore.

Baza rezulton gjithsej 860 kërkues shkencorë. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 20 kërkues të rinj në bazën ECRIS.AL për hartimin e bibliografive online nga universitetet në Shqipërisë e bibliotekat publike.



Bibliografi në linjë (online) të kërkuesve shkencorë

Biblioteka e Akademisë së Shkencave (BASH) për vitin 2023, ka hartuar 4 bibliografi të reja të kërkuesve shkencorë si më poshtë:

- Hamit Beqja <https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/00809493> regjistrime bibliografike;
- Stefanaq Pollo <https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/0081071> regjistrime bibliografike.
- Androkli Kostallari <https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/00811>

252 regjistrime bibliografike

- Bedri Dedja <https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/00812>

358 regjistrime bibliografike

Regjistrime bibliografike të bibliotekës së ASH-së;

- Regjistrimet e bibliotekës së akademisë BASH në sistemin COBISS.AL për vitin 2023: 3755 regjistrime të reja);

- Regjistrimet në total të bibliotekës së Akademisë së Shkencave në sistemin COBISS.AL: Gjithsej - 24 222 regjistrime bibliografike

Digjitalizimi i botimeve shkencore të ASHSH përmes aplikacionit
(Repository digital COBISS)

Biblioteka e ASHSH-së gjatë vitit 2023 ka digjitalizuar titujt se mëposhtëm:

- *Albanologu i arvanitëve: atje kam u shpirtin tim...* / përgatiti për botim Shaban Sinani, Francesco Altimari, Matteo Mandalà; redaktore Bruna Prifti. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2022. - 663 f.; 23 cm

Libër kushtim për 80-vjetorin e lindjes së anëtarit të nderit të ASHSH Titos Jochalas
<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/335901696>

- *Këngë popullore nga Çamëria* / Fatos Mero Rrapaj; [përgatitën botimin e dytë Hajredin Isufi, Shaban Sinani]; redaktor shkencor Shaban Sinani]. - Bot. 2. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2019. - 738 f.; 23 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/2049168432>

- *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan: konferencë shkencore ndërkombëtare* / [redaktore Brikena Liko]. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2018. - 498 f.: me il.; 20 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/1538557424>

- *Karta e gjelbër: Shqipëria 2025: rimodelimi i zhvillimit ekonomik në kontekstet lokale* / [drejtues Kosta Barjaba]; [redaktore Brikena Liko]. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2017. - 142 f.: me il.; 20 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/1538271472>

- *Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike. Vol. 1, Arkeologji dhe histori* / Përgatiti Shaban Sinani, Pëllumb Xhufi; redaktore Bruna Prifti. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2022. - 625 f.; 23 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/335929344>

- *Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike. Vol. 2, Gjuhësi dhe antropologji* / përgatiti Shaban Sinani, Pëllumb Xhufi; redaktore Bruna Prifti. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2022. - 790 f.; 23 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/335929600>

- *Dhimitër S. Shuteriqi: bibliografi personale për periudhën 1933-2019* / [përgatiti Sabina Prifti; redaktore Brikena Liko]. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2019. - 188 f.; 21 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/333877760>

- *Luan Omari: bibliografi personale për periudhën 1958-2017* / [përgatitën Mirlona Buzo, Sabina Vaqarri; redaktore Bruna Prifti]. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2021. - 52 f.; 23 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/334642688>

- *Shaban Demiraj: bibliografi personale për periudhën 1944-2019* / [përgatitën Mirlona Buzo, Sabina Prifti; redaktore Bruna Prifti]. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2021. - 110 f.; 23 cm

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/bash/334643456>

Përmbajtja e monografive është e indeksuar. Përdoruesit mund të gjejnë të gjitha elementet e kërkimit në botim dhe mund të shkarkojnë tekstin e plotë.

Zgjerimi i rrjetit të qendrave të informacionit në sistemin COBISS.AL

Gjatë vitit 2023 ka patur kërkesa nga biblioteka të ndryshme (5 biblioteka të institucionve shtetërore dhe 3 biblioteka të universiteteve private) në Shqipëri për përfshirjen e tyre në sistemin e përbashkët COBISS.AL. Përfshirja e tyre në rrjet është planifikuar për vitin 2024 me krijimin e Qendrës (QKPISH).

Treguesit statistikorë për bibliotekat e përfshira në sistemin COBISS.AL

Regjistrimet bibliografike:


- Regjistrimet në COBIB.AL: 145.685 regjistrime bibliografike
- Regjistrimet e përgjithshme të bibliotekës së Akademisë së Shkencave (BASH) në sistemin COBISS.AL: 24.222 regjistrime bibliografike gjithësej (për vitin 2023 – 3755 regjistrime të reja)
- Doktoratura – 4 665
- Teza masteri – 2 901
- Punime diplomash – 232

Anëtarësia me karta digjitale në biblioteka


- Anëtarë në BASH: 192 anëtarë (për vitin 2023 – 25 anëtarë të rinj)
- Anëtare të pajisur në rrjetin COBISS.AL – 6000 anëtarë (për vitin 2020 – 2023)

	2020	2021	2022	2023
Numri i regjistrimeve në rrjetin COBISS.AL	125.422	128.849	135.602	145.685
Numri i regjistrimeve të bibliografive shkencore	1.019	1050	3042	5891

Tab. 1. Tabela e regjistrimeve bibliografike ndër vite



Graf. 1 Numri i regjistrimeve në rrjetin COBISS.AL



Graf. 2 Numri i regjistrimeve të bibliografive shkencore

Burimet elektronike. Zgjerimi i burimeve elektronike me literaturë shkencore për bibliotekat shqiptare:

- Qasja në burime elektronike pa pagesë në bazën e të dhënave Unpaywall për të gjitha bibliotekat pjesëmarrëse në sistemin COBISS.AL.

<https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/unpaywall>

- Shërbimi Unpaywall nuk është i kufizuar në zonën IP të institucioneve.

Burime elektronike përmes EIFL – (*Electronic Information for Libraries*). Përmes pagesës së anëtarësisë vjetore në këtë konsorcium nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë përfitojnë rreth 40 biblioteka të vendit burime elektronike me tekst të plotë pa pagesë nga të gjitha fushat e shkencës.

Burimet elektronike të përftuara pa pagesë janë si më poshtë:

ASTM Compass Abstract

Edward Elgar Ebooks and Journals

IOPscience

MSP Journals

CoB Journals

Journal of Cell Science

Journal of Experimental Biology

Zhvillimet e reja të programit COBISS

Versionet e reja të programit COBISS janë prezantuar bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë përmes platformës ZOOM. Versioni i ri kalon nga COBISS3 në aplikacionin më të ri COBISS Cat dhe COBISS LIB duke ofruar format më të reja të aksesit për regjistrimin e të dhënave që lehtëson punën e kataloguesit dhe përdoruesve të informacionit.

Ndihmë profesionale për bibliotekat pjesëmarrëse në sistemin COBISS.AL për: katalogimin e materialeve në bibliotekë; *përgatitjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë*; mbështetje në procesin e inventarizimit, të huazimit; unifikimin e termave të njësuar në programin COBISS3; ndihmë për përdorimin e aplikacionit mCOBISS.AL etj.

Pjesëmarrje e Akademisë së Shkencave në panaire/promovime

Sektori i botimeve shkencore për vitin 2023, organizoi pjesëmarrjen e Akademisë së Shkencave në 4 panaire brenda e jashtë vendit: Panairi II Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, Prishtinë prill 2023; Panairi vjetor i Librit, Prishtinë (qershor 2023); Panairi i Librit Ulqin, Mal i Zi, (korrik 2023); Panairi i librit, Tiranë (nëntor 2023).

- Panairi II Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor Prishtinë prill 2023, (bashkorganizim i panairit në bashkëpunim me ASHAK)

- Promovime/ekspozim në stendë; shitje

Në këtë panair u kryen 8 promovime të botimeve shkencore të Akademisë së Shkencave (si më poshtë) me pjesëmarrje të akademikëve, studiuesve, recensionuesve të botimeve dhe specialistë të fushave përkatëse:

Vasil S.Tole, <i>Çesk Zadeja - jeta dhe vepra</i> , Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2022, 725 f.
Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, vëll 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2022, 625 f.,: (Kolana), Vëll I, 625 f., Vëll. II 790 f.
Lasgush Poradeci, <i>Vjersha (këngë) popullore grarishte krahinash të ndryshme</i> , Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2022, Vëll I, 536 f. Vëll II, 391 f.
A.Onuzi, M.Tirta, K.,Ulqini, A.Bido, <i>Veshje popullore shqiptare (album)</i> , vëll IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2016,
Afërdita Onuzi, <i>Art Popullor në Kosovë</i> , 2022
Paskal Milo, <i>Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore - të pathënat dhe enigmat</i> , vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2021, 584 f.
Rexhepi A., Amidi A. (përgatit.), <i>Poezi shqipe me alfabet arab: nga dorëshkrimi i Bibliotekës Millet në Stamboll: koleksioni i Ali Emirit</i> , Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2022, 500 f.
A. Hado, <i>Portreti, 120 -vjet histori</i> , ASHSH 2020

Në Panairin e Librit Tiranë 2023, u kryen 4 promovime të botimeve të ASH-së:

1. <i>Studime gjuhësore të akad. Mahir Domit</i> , vëllimi V, përgatitës Enver Hysa
2. <i>Fjalori i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe</i> , autor Idriz Metani
3. <i>Fantastikja në letërsinë shqipe të shekullit XX</i> , autor Eris Rusi, botim i ASHSH, Tiranë 2022
4. <i>Dokumente austro-hungareze, viti 1913</i> , autor Marenglen Verli, Botim i ASHSH, Tiranë 2022

Dhurime të botimeve shkencore të ASHSH-së:

Për vitin 2023, në përputhje me rregulloren e veprimtarisë botuese të ASHSH-së dhe sipas kërkesave të institucioneve dhe bazuar në kalendarin e dhurimeve të miratuar nga Kryesia.

Është kryer përzgjedhja e koleksioneve me botime shkencore dhe përgatitja për dhurim bibliotekave e universiteteve e institucioneve të ndryshme.

Janë kryer dhurime të botimeve shkencore të Akademisë së Shkencave, rreth 22.781 libra, për rreth 30 institucione brenda e jashtë vendit: biblioteka speciale e publike, universitete, akademi e institute shkencore si më poshtë:

Emërtimi	Sasia	Vlera (lekë)
Kryeministri, 2 tituj	5	3060

Biblioteka e Teatrit të Operas dhe Baletit-205 tituj	631	284154
Biblioteka e Universitetit Mesdhetar 465- tituj	1426	498837
Biblioteka e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës- 465 tituj;	1426	498837
Dhurime të librave për Panairin II të Librit Shkencor, Prishtinë	60	48186
Agjencia e Zbatimit Dygjuhësisë Shkup-45 tituj	90	72109
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme-17 tituj	34	19340
Akademia e Forcave të Armatosura-110 tituj	244	151663
Delegacioni Italian -5 tituj	15	8340
Bibliotela Publike Lezhë-314 tituj	945	249689
Universiteti Polis - 465 tituj	1426	498837
Universiteti “Zonja e Këshillit të Mirë”-576 tituj	1748	666092
Fondacioni “Dora e Pajtimt” 578 tituj	1790	675965
Biblioteka Publike”Dritëro Agolli” Fier- 507 tituj	1549	565030
Presidenca Kosovë-507 tituj	1549	565030
Biblioteka Publike Roskovec-507 tituj	1549	565030
Universiteti Bujqësor i Tiranës-507 tituj	1549	565030
Biblioteka-Komuna Tuz-31 tituj	93	86285
Universiteti i Gjakovës-150 tituj	313	135550
ASHAK	6	1101320
Qendra Kulturore “Feniks”, Kuçovë 507 tituj	1548	592584
Biblioteka publike Laç-Kurbin, 507 tituj	1548	592584
Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, 507 tituj	1548	592584
Biblioteka e Muzeut të Pavarësisë 52-tituj	102	29,638.5
Biblioteka publike Dibër 507-tituj	1548	592584
Dhurime (revista shkencore <i>Studia Albanica</i> dhe <i>AJNTS</i>) për 23 Akademi të huaja Shkencave, me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi.	299	117.024
Akademia e Shkencave të Bullgarisë (te tjera) 2-tituj	4	4128
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, 5 tituj	6	5140
Kolegji Logos, 277 tituj		360320
Totali (përafërsisht)	22.781	104.117.22

Përditësime:

- Përditësimi i rubrikës së botimeve shkencore dhe bibliotekës në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave; përditësim i bibliografisë së botimeve shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Projekte të vitit 2023

(Të dhëna për realizimin dhe buxhetin)

I. Projektet madhore të albanologjisë, me financim nga ASHSH

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni / seksioni	Periudha	Status	Buxheti (lekë)
1.	<i>Enciklopedia e shqiptarëve</i>	Redaksia qendrore, redaksia vendore	QBAE/QBEA	2023-2028	Në proces	44.900.000 (për të tre projektet madhore)
2.	<i>Fjalori i madh i gjuhës shqipe</i>	J. Thomai, V. Memisha	QBAE/QBEA	2021-2024	Në përmbyllje	44.900.000 (për të tre projektet madhore)
3.	<i>Historia e shqiptarëve</i>	N. Ceka, P. Xhufi, P. Milo	QBAE/QBEA	2021-2024	Në përmbyllje	44.900.000 (për të tre projektet madhore)

II. Projekte me financim nga ASHSH gjatë 2023 (përfshirë projektet që vijojnë nga viti 2022)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtues i projektit	Njësia / komisioni/ seksioni	Periudha	Status	Buxheti (Lekë)
1.	<i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësismit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt pilot në rrjet) - VITROCERT</i>	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2024	Vijon viti 2022 - faza I viti 2023 - faza II	867.600 (viti 2022) 1.456.198 (viti 2023) 500,923 për vitin 2024
2.	<i>Ngritja e kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit gjenetik të specieve drufrutore autoktone në laboratorin e ri të Qendrës CRYOFRUIT</i>	Efigjeni Kongjika	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2024	Vijon në vitin 2024	1.232.280 (viti 2023) (Parashikimi gjithsej 7.585.608)
4.	<i>Ngritja e një banke kombëtare të ADN në popullatën shqiptare për studime gjenetike në këtë popullatë dhe organizimi i një regjistri kombëtar dhuruesish të qelizave staminale për nevojat e transplantit të këtyre qelizave në Shqipëri - ADN CELLSTAM</i>	Genc Sulçebe Ilia Mikerezi	Qendra e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2024	Vijon në vitin 2024	13.501.927 për vitin 2023
